

OPTIMIZMI DHE PESIMIZMI



Këto dy qëndrime shpirtërore dhe shumë ndikuese në jetë, janë të përhapura anekënd njerëzimit. Disa janë optimistë të mëdhenj aq të skajshëm saqë cilado përpjekje për t'ua shuar këtë optimizëm është e kotë, në anën tjetër gjejmë pesimistë – fatkeqësisht në numër më të madh – të mëdhenj, të cilët kanë humbur çdo shpresë se do të bëhet mirë, këta asnjëherë nuk shohin të bardhën.

Në besimin tonë këto dy qëndrime trajtohen me termet shpresë dhe frikë. Këto janë thelbi i çdo lëvizje dhe aktiviteti. Çdo gjë që njeriu vepron apo lë, atë e bën me shpresë për diçka apo nga frika prej diçka. A thua vallë, cilës duhet dhënë përparësi, shpresës apo frikës?

Një grup dijetarësh thonë se frikës duhet dhënë përparësi, sepse frika do ta pengojë nga rënia në gjynahe, e pastaj do të bëjë vepra të mira.

Të tjerë thonë se shpresa ka përparësi, sepse kjo e bën njeriun optimist ndërsa Pejgamberit, salallahu alejhi ue selem, i pëlqente optimizmi.

Një mendim shumë i bukur thotë: Kur bën mirë i jep përparësi shpresës, sepse Ai që ta mundësoi të bësh punë të mira, sigurisht nuk do ta asgjësojë mundin. Ndërsa kur bën keq i jep përparësi frikës, frikës nga dënimi i Allahut dhe nga të këqijat që pasojnë njëra pas tjetrës.

Mirëpo, qëndrimi më i drejtë është ajo që ka thënë Imam Ahmedi, me të cilin pajtohen shumica dërrmuese e dijetarëve, ai thotë: “Shpresa dhe frika që ka besimtari duhet të jetë në një shkallë, cilëso i dha përparësi, atëherë shkatërrohet”. Pra, shpresa dhe frika le të jenë si dy krahët për shpendin, i cili nëse nuk i ka krahët të barabartë do të bjerë përtokë.

Nga argumentet që na nxitë të kemi frikë është ajeti që i përshkruan besimtarët: **“Ata që japin atë që e japin** (sadaka, zeqatë) **ndërsa zemrat i kanë përplot frikë sepse do të kthehen te Zoti”**, këta kanë frikë nëse vepra e tyre do të pranohet apo jo. Ndërsa prej argumenteve që na nxitë të kemi shpresë është fjala e Allahut në hadithin kudsij: “Unë sillem ndaj robit Tim ashti siç ai supozon për Mua, kurse Unë jam me të kur ai më përmendë”. Ky hadith është ndër argumentet më shpresëdhënëse, shumë e lehtë: dëshiron të përjetosh çdo të mirë nga Mbreti i Qiejve dhe Tokës, atëherë mendo mirë për Allahun, mos kujto se Allahu do të lë pa mbrojtje, mos mendo se Allahu e do të keqen për ty, mos mendo se Allahu e dëshiron xhehenemin për Ty. Kur ta arrish këtë, atëherë do të kesh një shpirt të madh, të lidhur për Allahun, i cili do ta mundësojë të jesh i sinqertë dhe punëmirë.

Frika dhe shpresa nuk ndalojnë vetëm te mendjet dhe veprat tona, ato kanë vendin e tyre edhe në gjërat që na rrethojnë, në ndodhitë e mira dhe ato të liga. E gjithë bota Islame u gëzua me gjestin heroik të kryeministrit të Turqisë, Tajjib (arabisht: i mirë) Erdogan, i cili në Davos të Zvicrës qortoi hapur Shimon Perezin për masakrat në Palestinë dhe braktisi sallën. Ky gjest i tij na shton shpresën se ditët e pranverës po vijnë, por nëse shohim anën tjetër të medaljes, atëherë na paraqitet frika, çfarë bëjnë myslimanët tjerë, ku janë liderët e tyre, pse kanë kompleks nga identiteti i tyre mysliman?

Sidoqoftë, lajme të mira do të dëgjojmë edhe në të ardhmen, por edhe të këqija – shpresoj të jenë më pak – ndaj, të mos entuziazmohemi e as të emocionohemi, por t'i vendosim të gjitha ato midis shpresës dhe frikës, që të mos biem përtokë.

Në emër të redaksisë:
Omer BERISHA

AKTUALE

A ishte rezistenca palestineze fajtore për atë që ndodhi në Gaza? **3-6**
Obama u betua në bibël, a ka kush betohet në Kuran? **7-8**
Hebrenjtë e Stalinit **8-10**

KËNDI IM

A do t'i rikthehet Amerikës udhëheqja **10-13**
Sprova e Gazës dhe roli i dijetarëve **13-16**

AKIDE

A janë veprat kusht i domosdoshëm për imanin, apo janë vetëm kusht plotësues? **17-20**

FIKH

KRIZA BOTËRORE FINANCIARE
mësime dhe përvoja nga ekonomia kapitaliste pa moral **21-24**

AVANCIMI PERSONAL

Plani i përparimit personal **25-29**

LIBRI

2012 Fundi i Izraelit? **29-30**

FAMILJA

Fëmijët tanë dhe ëndrrat për fitoren e Gazës **34-36**
A jam i sjellshëm ndaj prindërve?! **37-39**

TEFSIR

Fitorja e sigurt është përkrahja e Allahut **40-44**

HADITH

Muslimanët, përçmimi dhe krenaria **44-48**

BOTA ISLAME

Palestina **49-52**
Gaza realiteti i hidhur **53**

FETVA DHE KONSULTIME

Fetva, këshilla dhe udhëzime rreth bidatit **54-56**

HISTORI

Trimat legjendarë dhe mashtrimi i umetit **57-60**

REDAKSIA

Omer BERISHA – kryeredaktor
Anëtarë të redaksisë:

Ahmed KALAJA, Bekir HALIMI, Agim BEKIRI, Driton LEKAJ, Ali SHABANI, Ismail BARDHOSHI,
Talha KURTISHI, Bledar HAXHIU, Sedat SHABANI, Agron TERZIQI, Lulzim SUSURI, Genc PLUMBI, Zeki ÇERKEZI,
Enver AZIZI, Bashkim BAJRAMI, Bilal TEQJA.
Bashkëpunëtorë: Ekrem AVDIU dhe ENIS RAMA
Roald HYSA – redaktor gjuhësor
Halil BERISHA – redaktor teknik
Sedat RAMADANI - shpërndarje dhe marketing

Boton: Albislam

Adresa: rr: 110 nr: 5 | Çarshia e vjetër | Shkup 1000
email: revista@albislam.com
sms: +389 75 436 718 | fax&tel: +389 2 3230 827
Revista është e regjistruar pranë Agjencisë për
Informata të Maqedonisë nr. 02-124/2
ISSN: 1409-6250
Tirazhi: 2000

ABONIMI NJË VJEÇAR
Për Maqedoni: 600 den, Jashtë vendit: 20 euro
(në çmim janë të përfshira edhe harxhimet postare)
e-mail: albislam.abonues@gmail.com
ALBISLAM DOOEL
Xhirollogaria: 300000002770453
Komerçijalna Banka A. D. – Skopje
Numri tatimor: 4030008038784
Abonimet me euro mund t'i bëni online nëpërmjet shërbimit
PAYPAL. Të dhënat mund t'i gjeni në www.albislam.com

A ISHTE REZISTENCA PALESTINEZE FAJTORE PËR ATË QË NDODHI NË GAZA?

Nëse nuk do të kishte qenë vullneti i pathyeshëm i kësaj rezistence, Palestina do të ishte bërë si Spanja, a i shkon ndërmend ndonjërit tani të çlirojë Madridin, apo të kërkojë t'i kthejnë Barcelonën?

ABDURRAHIM MAHMUD EL HAUALI

Nuk do ta kesh të vështirë të ndjesh solidarizimin dhe mbështetjen, që i jepet në nivel popullor rezistencës palestineze. Çështja nuk kërkon ndonjë studim apo statistikë për të kuptuar, se ata që janë të rezervuar karshi rezistencës, si opSION në botën arabe dhe islame janë një grup i vogël njerëzish, ata ndahen në dy grupe:

Të parët, janë ata që mbartin në shpirtat e tyre mendësi të devijuara ideologjike, mendësi të cila bëhen barrierë që edhe nëpër ta të rrjedhë shpirti i përkatësisë dhe i solidaritetit me umetin islam. Këto mendësi u kanë instaluar atyre në kokë një busull që në mënyrë të vetvetishme drejtohet në të kundërt të interesit fetar dhe këndvështrimit islam. Në shkrimin tim unë nuk do të merrem me këta njerëz, sepse pikat e takimit me ta janë të ndërprera. Është

interesant fakti se ata shfaqin dhimbje dhe dëshpërim për Gazën dhe i mbivlerësojnë sakrificat në njerëz, që janë duke bërë lëvizjet islame, ndërkohë që akoma nuk u është tharë boja e penës, ku ata ironizojnë me shpirtin e kulturës panislamike dhe përkushtimin ndaj problemeve të mbarë muslimanëve në botë, duke e konsideruar këtë si mbeturinë e Kalifatit të zhdukur. Unë habitem sesi sot, në ditën që erdhi fatkeqësia e Gazës, këta njerëz e kanë përthithur këtë shpirt solidariteti?!

Të dytët, janë ata që mendojnë se interesi islam e kërkon që të ndalet rezistenca ndaj pushtimit çifut, që njerëzit për pasojë të mos vriten nga këta njerëz kriminelë. Rezistenca palestineze nuk është e aftë t'i bëjë ballë Izraelit, ndaj ajo duhet të lëshojë armët për të mos u sjellë njerëzve shfarosjen. Këtyre njerëzve të nderuar dhe dashamirës unë ua drejtoj këtë shkrim.

Së pari, tekste fetare, të cilat janë gjykatësi ynë në çdo



mosmarrëveshje flasin qartë për domosdoshmërinë e xhihadit dhe zmbropsjen e pushtuesit, aty ku vendos fjala e Zotit, aty nuk ka vend për arsye njerëzore, argumentit duhet t'i bindemi ngado që të na vijë. Kjo nuk do të thotë se argumenti fetar e hedh tutje arsyen dhe opinionin njerëzor, përkundrazi ai e qetëson arsyen dhe e drejton atë drejt interesit nëpërmjet një rruge të qartë dhe të dukshme. Nëse do të mungonte teksti fetar edhe mendjet edhe opinionet nuk do të binin në një konkluzion të njëjtë, ndërsa nëse ka tekst që e ndan këtë çështje, atëherë ai kryen bashkimin dhe takimin e mendimeve.

Së dyti, nëse xhihadi në rrugë të Allahut nuk zhvillohet në një situatë të tillë, kur pushtohet vendi dhe cenohen gjërat e shenjta, atëherë ai nuk ka për t'u zhvilluar asnjëherë, pasi nuk është e mundur të gjendet ndonjë rast më i qartë në të cilin do të mund të zhvillohej xhihadi. Për rrjedhojë tekstet fetare, të cilat urdhërojnë xhihadin do të jenë pakuptim dhe pa vlerë argumenti. Rrethi më i ngushtë ku hyn xhihadi, më i qarti dhe më i pakontestueshmi është pikërisht rasti kur bëhet fjalë për zmbropsjen e pushtuesit nga tokat islame, nëse edhe në këtë rast nuk kemi xhihad, atëherë asnjëherë nuk ka për të pasur xhihad!

Së treti, rezistenca nuk mundet të veprojë pa pasur sakrificë dhe pa pësuar fatkeqësi, ky është ligji i luftës, Allahu thotë: **“Lufta është bërë detyrim për ju, ndonëse e urreni.”** Kush e mbështet rezistencën dhe kërkon që ajo të mos sjellë pasoja të rënda, bashkon në mes dy ideve të kundërta dhe imagjinojnë një utopi, dhe sidomos kur bëhet fjalë për zmbropsjen e pushtuesit nga tokat e muslimanëve. Natyrisht që kjo është një rezistencë me çmim të ulët, sepse ti ndodhesh para një armiku të fortë, që ka

“Katastrofa nuk erdhi sot për shkak të rezistencës, por pikërisht për shkak të braktisjes së rezistencës që në fillim...”

nën kontroll tokën, i cili nuk respekton, as parime, as vlera. Kështu ndaj çfarëdo rezistence që ti do të bësh kundrejt tij do të përplasesh me reprezalje në radhët e civilëve, të cilat synojnë të minojnë krahun e rezistencës. Nëse ky veprim i armikut do të jetë shkak për ndaljen e rezistencës, atëherë unë mendoj se kjo është “filozofia” më e madhe në histori, që do të lehtësonte pushtimin e vendeve. Nëse armiku pushton vendin, atëherë të gjithëve u duhet të dorëzohen para tij, ndryshe ai do të hakmerret, madje e kemi për detyrë t’ia dorëzojmë vendin që para se të na pushtojë tokën, sepse ai do të na masakrojë që para pushtimit, ndaj le të dorëzohemi, që të shpëtojmë jetët njerëzore! Jam plotësisht i bindur, se nëse kjo “filozofi” do të gjendej që herët në shpirtin islam, sot nuk kishte për të mbetur asnjë vend islam në sipërfaqe të tokës!

Së katërti, dëmet që vijnë nga braktisja e rezistencës janë shumë më të mëdha, sesa dëmet dhe të këqijat që sjell rezistenca. Përhapja e frymës së pesimizmit, e nënshtrimit dhe e përuljes në ndërgjegjen islame është më se e mjaftueshme për të shfarosur myslimanët dhe për të shkatërruar tokat e tyre dhe për të pushtuar vendet e tyre në çdo kohë. Ajo çka ndodh sot në vendet muslimane, si zhvatja e pasurisë, masakrat dhe zaptimi i tokës, nuk është gjë tjetër vetëm se pjesë e fryteve të kësaj fryme të përuljes, të cilën ne e kemi trashëguar dhe me të cilën ne i kemi edukuar fëmijët

tanë. E ndërsa rezistenca dhe forcimi i vlerave të burrnisë, krenarisë dhe shpirtit të sakrificës e heroizmit është pak gjak i derdhur, që jepet për të ruajtur trupin e umetit islam nga hemorragjia e vazhdueshme nga e cila ai vuan prej kohësh.

Së pesti, shkatërrimet dhe dëmtimet që po vuajnë sot vëllezërit tanë të pafuqishëm në Gaza, nuk erdhën brenda orës, ato janë fryti i mungesës dhe i neglizhencës ndaj detyrimit për t'u mbrojtur dhe për t'i bërë rezistencë këtij pushtimi. Nëse i gjithë umeti do të ishte çuar në këmbë për t'i ardhur në ndihmë vëllezërve të tyre që në fillim, nuk kishte për të ndodhur kjo që ndodhi. Katastrofa nuk erdhi sot për shkak të rezistencës, por pikërisht për shkak të braktisjes së rezistencës që në fillim. Kjo që ndodh sot është rezultat i përuljes së umetit arab dhe atij islam, për t'i ardhur në ndihmë vëllezërve të tyre muslimanë. Nëse umeti do të kishte bërë detyrën e tij, madje edhe sikur çifutët të ishin të bindur se umeti islam do të kryente detyrimin e tij, gjaku sot nuk do të derdhej dhe vendi nuk do të pushtohej, por për fat të keq umeti qëndron përkrash pushtimit ndërmjet atij që e ndihmon atë, atij që hesht dhe e aprovon, dhe atij që është i pafuqishëm për të bërë gjë. Kritika e vërtetë bie mbi ta dhe jo mbi ata që rezistojnë dhe luftojnë në llogore.

Së gjashti, nëse muslimanët para shtatëdhjetë vjetëve, që në fillimet e lindjes së këtij shteti gangrenë, sikur ata që në këtë kohë të kishin sakrifikuar me mijëra njerëz për ta groposur këtë pjellë të keqe, a do të ishte dukur kjo një aventurë dhe një papërgjegjshmëri për gjakun e njerëzve? Apo umeti që në atë kohë, kur u tregua i trembur dhe dorështrënguar për të sakrifikuar gjakun e tij, që të mbronte tokat e veta, që nga ajo kohë armiku u bë edhe më i fortë dhe më i qëndrueshëm në pozitat e tij? Po sot, sa gjak na duhet për të larguar

këtë armik? Nëse që në atë kohë do të kishte pasur rezistencë të mirëfilltë, sot nuk do të derdhej ky gjak që vazhdon të rrjedhë, që nga ajo kohë. Allahu e di sesa kohë do të na duhet, sa gjak dhe sa shkatërrime deri sa të ndalet kjo bela. O njerëz, a është rezistenca shkaktare e gjakrrjedhjes apo ajo është shkak, që do ta ndalë hemorragjinë e tij?

Së shtati, çlirimi i tokës dhe rikthimi i xhamisë Aksa është një nga qëllimet dhe përparësitë e domosdoshme, për të cilën nuk kundërshton asnjë –nuk e di nëse mendon kështu edhe grupi i parë- dhe nëse ne jemi të gjithë në një mendje për realizimin e këtij qëllimi duhet ta dimë se ekzistenca e një grupi besimtarësh, që luftojnë në llogoret e Gazës janë një hap drejt realizimit të këtij qëllimi. Unë e di mirë, se ky grup nuk ka mundësi ta shkatërrojë të gjithë Izraelin, madje as një pjesë të tij, por gjithsesi me ekzistencën e këtij grupi ne kemi bërë dhjetë hapa në një rrugë me njëmijë hapa dhe kemi sakrifikuar shumë edhe më shumë, derisa kemi arritur në këtë pikë. A është e arsyeshme dhe e pranueshme edhe fetarisht, që ta humbim dhe ta ndalim këtë rezistencë dhe të kthehemi njëqind hapa mbrapa, duke hamendësuar se ne do të mbrojmë gjakun e njerëzve, ndërkohë që ne po sakrifikojmë gjithë këtë gjak që është derdhur?! Nëse kthehemi mbrapsht do të detyrohemi për t'u kthyer edhe njëherë aty ku ishim, dhe do të shpenzojmë shumë herë më tepër, gjak sesa ai që po derdhet sot!

Së teti, ajo pak e drejtë që palestinezët arritën të merrnin nga të drejtat e tyre, erdhi pikërisht për shkak të forcës ushtarake, e cila i vuri në siklet çifutët, ndërkohë ata me intrigat e tyre i dhanë këto pak të drejta vetëm me kushtin për mbrojtjen e sigurisë sioniste, që në fakt do të thotë groposje e rezistencës dhe e mundësive të saj. Unë habitem se kush

mund të jetë ai mendjelehtë që e dorëzon armën, me të cilën ai arriti të marrë disa nga të drejtat e tij! Nëse ai ua dorëzon atë çifutëve, kush e siguron atë se ajo që çifutët i dhanë do të mbesë ashtu?

Kjo është veçoria e projektit të rezistencës, e cila e kupton se arma është gjuha e vetme që kuptojnë sionistët, dhe ata që e mbështesin në përfundim, dhe se siguria e vetme për të kuptuar kërkesat e palestinezëve është arma. Në dallim me projektin e atyre që pranojnë nënshtrimin; çifutët patën frikë nga arma e tyre ndaj u dhanë një mollë që ta ulin armën dhe ata e ulën, normalisht që sionistët kanë për t'ua marrë atë mollë përsëri! Veçori tjetër e rezistencës është fakti, se vullneti i palëkundur i saj përmbys balancat dhe bën çudira dhe me vendosmërinë e bindjen e saj ajo arrin shumë më larg sesa shpresohet, ndërsa vullneti i mundur dhe i thyer është i pafuqishëm të mbajë në duart e tij edhe atë që ka!

Së nënti, mjafton për rezistencën dhe popullin palestinez, që ai ka mbajtur gjallë çështjen palestineze nga braktisja, ajo ka mbetur e gjallë dhe e ndezur në ndërgjegjen e çdo njeriu, pavarësisht nga të gjitha intrigat, hilet, planet dhe potencialet, që mund të fshijnë malet. Nëse nuk do të kishte qenë vullneti i pathyeshëm i kësaj rezistence, Palestina do të ishte bërë si Spanja; a i shkon ndërmend ndonjërit tani të çlirojë Madridin, apo të kërkojë t'i kthejnë Barcelonën?

Së dhjeti, unë pyes deri në çfarë pike duhet të mbyllim sytë para këtij pushtimi dhe të mos e ngacmojmë atë, që ai të mos na derdhë gjakun? A duhet të heshtim para tij, deri sa ai të vrasë dhjetë, apo njëqind apo një mijë? Çfarëdo synimi që ata të vendosin do të bien në të njëjtin problem për të cilin edhe e kritikojnë rezistencën, sepse çdo lloj lëvizje do të sjellë demos shkatërrim dhe

vdekje, ndaj atyre nuk u ngelet gjë tjetër vetëm se të rrinë të heshtur, edhe nëse kjo do të shpjerë që armiku ta shfarosë të gjithë Gazën, sepse nëse ata lëvizin, atëherë ndoshta armiku do të inatoset dhe do ta djegë edhe Bregun Perëndimor!

Së njëmbëdhjeti, merr një libër çfarëdo të historisë islame dhe shfletoji faqet e tij, faqet e betejave dhe heroizmave në të cilat është derdhur gjak për të mbrojtur Islamit dhe tokat e tij. Filloje me periudhën profetike dhe vazhdo për gjashtë shekujt me radhë që erdhën më pas, në luftërat dhe betejat që kanë kaluar dhe do të habitesh kur të mësosh, se humbjet që kanë pasur muslimanët në të gjitha këto luftëra gjatë gjithë këtyre shekujve, nuk arrijnë asgjë nga ajo çka kanë humbur kur braktisën mbrojtjen e tokave të tyre, ata i përpiu cikloni mongol, që preu me miliona muslimanë.

Dhe së fundi, kur disa të nënshtruar justifikohen me pamundësinë e qëndresës përpara Izraelit dhe kërkojnë të vendoset armëpushimi, atëherë nëse ata me të vërtetë i besojnë armëpushimit, se ai është një hapësirë e lirë dhe mundësi veprimi, atëherë kjo do të thotë se pafuqia karshi armikut përkthehet në armëpushim, e ndërsa përulja dhe nënshtrimi i plotë dhe dorëzimi i çdo gjëje në duart e çifutëve kjo nuk ka lidhje më me pamundësinë për t'i bërë ballë Izraelit, por me pamundësinë për të t'i qëndruar përballë së vërtetës, nderit, burrnisë dhe fisnikërisë që jeton në shpirtin e çdo njeriu që i dhimbset feja dhe që e do atdheun e tij.

Tek rezistenca ju keni jetë o njerëz të mendjes, sikur ta dinit... ■

Përktheu: Justinian TOPULLI

OBAMA U BETUA NË BIBËL, A KA KUSH BETOHET NË KURAN?

Praninë e priftit në këtë proces ligjor dhe politik askush nuk e ka kundërshtuar, i cili sipas idesë së shekullarizimit të shtetit duhet të ndahet nga ritualët fetare. Kurse liderët arabë dhe ata shqiptarë frikësohen nga prania e ndonjë hoxhe ose dijetari në tubime të këtilla.

Kryetari i ri amerikan, Barak Obama, u betua mbi Bibël, gjatë ceremonisë së betimit solemn, si kryetar i dyzet e katërt i Shteteve të Bashkuara të Amerikës, duke vepruar kështu si kryetari të mëhershëm Abraham Linkoln, i cili u zgjodh kryetar i Amerikës në vitin 1861.

Ai mbajti fjalimin e rastit dhe citoi nga Bibla, kurse para fjalimit e vendosi dorën në Biblën, të cilën e kishte përdorur Abraham Linkoln, kur ishte zgjedhur si kryetar para dy shekujsh për të treguar se rruga që do të ndjekë është e njëjta dhe se burimi është i njëjtë, e ai është Bibla, në të cilën janë mbështetur të parët që themeluan ShBA-në. Ata këtë vend e konsideronin, si “toka e premtuar”, mu ashtu sikurse edhe toka palestineze konsiderohet tek hebrenjtë.

Para betimit dhe ligjërimit, prifti ungjillor i Kalifornisë, Rajk Varen, drejtoi një lutje, të cilën e përcollën me miliona të pranishëm dhe dhjetëra miliona të tjerë nëpërmjet ekraneve televizive. Ata të gjithë thanë amin pas këtij prifti me një përlujtje të madhe, kur ai u lut duke thënë: “Ruaje o Zot dhe bekoje atë, zëvendësin e tij dhe mbarë administratën e tij...” “e lusim Zotin që t’i japë urtësi, që të na udhëheqë mirë dhe me mëshirë” dhe që të “forcohet mbretëria e tij në tokë ashtu sikurse ka zënë vend në qiell”. Para gjithë kësaj ceremonie Obama dhe gruaja e tij Mishel, së bashku me zëvendësin e tij Xho Bajden dhe gruan e tij morën pjesë

në një meshë në kishën e Shën Palit në Uashington.

Mëngjesin e ditës së inaugurimit të presidentit të ri gazeta prestigjioze Uashington Post tregoi se Imijet Belivo, drejtuese e inaugurimit ka thënë: “Betimi i Obamës në këtë Bibël historike paraqet betimin për tërësinë territoriale të Amerikës dhe paraqet një pikëtakimi të fortë me të kaluarën dhe trashëgiminë tonë të përbashkët”.

Kështu rrodhi inaugurimi në shtetin e parë shekullar në botë, vend i cili është kible e shumë politikanëve të botës, në mesin e tyre janë edhe politikanët e botës arabe, të cilët turpërohen që ta imitojnë këtë manifestim edhe në shtetet e tyre islame?! Në mesin e këtyre politikanëve janë edhe politikanët tanë shqiptarë, me origjinë muslimane, të cilët flasin me admirim për kulturën perëndimore dhe katolike, ndërsa flasin me perversitet të madh ndaj kulturës autoktone islame, dhe çdo gjëje që ka të bëjë me muslimanët dhe kulturën islame e marrin me rezervë të madhe dhe kundërshtim!!

Kjo mburrje me Bibël karshi injorimit të Kuranit, të paprekshëm nga dora e njeriut, qoftë edhe në mënyrë sipërfaqësore dhe kjo ndërlihdje me të kaluarën dhe “etërit” themelues të shtetit, është krejt në kundërshtim me atë hasmëri, që e imponojnë elita politike në botën arabe

edhe në vendin tonë me të kaluarën islame të vendit dhe të popullit tonë.

Është një pamje shumë demoralizuese, kur krahasohen ndërmjet tyre këto gjëra. Lideri i ri amerikan mbajti një fjalim, ku kishte elemente të hidhëtisë, për shkak të dështimeve politike, ekonomike dhe ushtarake, mirëpo si zgjidhje të gjitha këtyre problemeve paraqiti kthimin në të kaluarën dhe rikthimin e lavdisë të etërve dhe dëshirës për ta përsëritur atë përvojë. Amerikanët e përcollën këtë fjalim me një duartrokitje frenetike dhe askush deri tashti nuk e ka akuzuar Obamën për regres e prapambetje dhe kjo nuk ka për të ndodhur. Prandinë e priftit në këtë proces ligjor dhe politik askush nuk e ka kundërshtuar, i cili sipas idesë së shekullarizimit të shtetit duhet të ndahet nga ritualet fetare. Kurse liderët arabë dhe ata shqiptarë frikësohen nga prania e ndonjë hoxhe ose dijetari në tubime të këtilla. Madje edhe në shkrimin e kushtetutës së re të Kosovës nuk figuron askund prania e Fesë Islame, si fe e shumicës dërmuese të popullit shqiptar në Kosovë, e mos të flasim për betim në Kuran gjatë fillimit të punës së deputetëve ose të ministrave të rinj, sepse ekspertët e kushtetutave do ta trajtonin si një veprim jokushtetues dhe antishekullar!

Në Amerikë mori pushtetin një “njeri regresiv” dhe i “prapambetur”, kurse në botën arabe dhe në vendin tonë kemi lider dhe politikan “përparimtarë”. ■

Marrë nga: www.almoslim.net
Përshtati: Bekir Halimi

HEBRENJTË E STALINIT

SEVER PLOCKER¹

Do të përmendim këtu një ditë të veçantë dhe shumë të mjeruar historike: Pothuajse 90 vjet më parë ndërmjet 19 dhe 20 dhjetorit 1917, mu në mes të revolucionit bolshevik dhe të luftës civile, Lenini nënshkroi një dekret, ku ai bënte thirrje për ngritjen e Komisionit të Jashtëzakonshëm të të gjithë Rusive për të Luftuar Sabotimet dhe Kundër-revolucionin, gjithashtu i njohur edhe si ÇEKA. Brenda një kohe të shkurtër ÇEKA u bë organizata më madhe dhe më mizore shtetërore. Struktura e saj organizative ka ndryshuar shpesh në disa vjet, po ashtu edhe emrat e saj: nga ÇEKA në GPU, më vonë në NKVD dhe më vonë në KGB.

Ne nuk mund ta dimë me siguri numrin e të vrarëve nga ÇEKA dhe për sa është përgjegjëse ajo apo pasardhëset e saj për krimet, por numri i të vdekurve është sigurisht jo më pak se 20 milionë të vdekur, duke përfshirë këtu viktimat e kolektivizimit të detyruar me forcë, uria, spastrimet politike, dëbimet, përjashtimet, ekzekutimet dhe vrasjet masive nëpër Gulage. Shtresa të tëra të popullsisë u zhdukën: fermerët e lirë, minoritetet etnike, borgjezia, oficerë të lartë, intelektualë, artistë, aktivistë të lëvizjes punëtore

¹ Autori është opinionist i faqes izraelite: ynetnews.com dhe është njëri nga ata hebrenj që mundohen t'i shohin gjërat ndryshe nga sa ofrohet në qëndrimet zyrtare izraelite. Në ditët e fundit janë shkruar me qindra e mijëra faqe kundër luftës së Izraelit në Gaza, ku autorët e tyre janë me origjinë jehudie. Redaksia e Albislamit e pa të arsyeshme ta botojë këtë për shkak të qëndrimit objektiv të këtij autori. Marrë nga faqja e internetit: <http://www.ynet.co.il/english/articles/0,7340,L-3342999,00.html>

Ne nuk duhet
që të harrojmë
se disa nga
vrasësit më të
mëdhenj të
kohëve tona
ishin Jehuditë.

dhe anëtarë të panumërt të vetë Partisë Komuniste. Në librin e tij të ri dhe shumë të lavdëruar **“Luftërat e Botës”**, historiani **Niall Ferguson** shkruan se asnjë revolucion në historinë e njerëzimit nuk i ka gllabëruar fëmijët e vet me të njëjtin oreks të shfrenuar, ashtu siç veproi revolucioni sovjetik.

Në librin e tij për spastrimet staliniste **dr. Igal Halfin** i Universitetit të Tel Avivit shkruan se dhuna staliniste ishte me të vërtetë unike, për atë që drejtohej vetëm brenda vendit. Lenini, Stalini dhe zëvendësuesit e tyre nuk do të kishin pasur mundësi t'i zbatonin bëmat e tyre pa bashkëpunimin e “zyrtarëve të terrorit”, hetuesve mizorë, spiunëve, ekzekutuesve, rojave, gjyqtarëve, të çoroditurve dhe shumë të tjerëve që ishin anëtarë të Krahut përparimtar Perëndimor, dhe që u mashtruan nga Regjimi Sovjetik i terrorit, dhe madje e pajisën atë me një certifikatë hallalli. Të gjitha këto gjëra janë të mirënjohura në shumë aspekte, megjithëse arkivat e ish-Bashkimit Sovjetik nuk janë hapur plotësisht për publikun. Por kush është ai që do t'ia dijë për këtë punë? Brenda vetë Rusisë shumë pak njerëz janë vënë para drejtësisë për krimet e kryera nga ata gjatë punës në NKVD apo në KGB. Debati publik në Rusi sot e ka injoruar krejtësisht pyetjen: “Si mund të na ketë ndodhur kjo neve”? Si opozitë e Vendeve Perëndimore Evropiane, Rusët nuk merren aspak me të shkuarën e tyre staliniste.

Po ne Jehuditë? Një student izraelit e

“Shumë jehudi e shitën shpirtin e tyre tek shejtani i Revolucionit Komunist dhe i lyen duart me gjak në përjetësi...”

mbaron shkollën e mesme pa e dëgjuar ndonjëherë emrin **“Genrih Jagoda”** vrasësi më i madh i shek. XX me origjinë jehudie, nënkryetar i GPU-së dhe themelues e kryetar i NKVD-së. Jagoda me shumë zgjuarsia zbatoi urdhrat e Stalinit për kolektivizimin dhe është përgjegjës për vdekjen e të paktën 10 milionë njerëzve. Zëvendësit e tij me origjinë jehudie ngritën dhe menaxhuan sistemin e Gulageve. Pasi e kishte humbur të qenit i favorizuar nga Stalini, Jagoda u degradua, u ekzekutua dhe u zëvendësua si kryexhelat në vitin 1936 nga Jekhovi, që thirrej “xhuxhi gjakatar”. Jekhovi nuk ishte jehudi, por ai ishte i pajisur me një grua shumë aktive hebreje. Në librin e tij: **“Stalini: Oborri i Yllit të Kuq”**, historiani jehudi Sebag Montefiore shkruan se gjatë periudhës së errët të terrorit të kuq, kur makina vrasëse komuniste punonte me fuqi të plotë, Stalini ishte i rrethuar nga vajza të reja shumë të bukura jehudie. Në shokët më të afërt dhe më besnikë të Stalinit përfshihet edhe anëtari i Komitetit Qendror e i Politbyrosë Lazar Kaganoviçi. Montefiore e karakterizon atë si “Stalinistin e parë” dhe shton se ata që po vdisnin nga uria në Ukrainë, një tragjedi e pashoqe në historinë njerëzore,

së bashku me terrorin nazist dhe terrorin maoist në Kinë, nuk e preknin fare Kaganoviçin.

Shumë jehudi e shitën shpirtin e tyre tek shejtani i Revolucionit Komunist dhe i lyen duart me gjak në përjetësi. Ne do të përmendim këtu edhe një tjetër: **Leonid Rajhman**, kreu i departamentit special të NKVD-së kreu i organizimit të hetuesve, i cili ishte një sadist shumë mizor. Në vitin 1934 sipas statistikave të publikuara 38,5% e atyre që mbanin postet më të larta në aparatit e sigurimit sovjetik ishin me origjinë jehudie. Natyrisht ata vetë gjithashtu u eliminuan në spastrimet që vijuan. Në një ligjëratë të mbajtur para pak kohësh në një takim në Universitetin e Tel Avivit nga dr. Halfin, valët e terrorit sovjetik u përshkruan si “karnavale të vrasjeve masive”, “fantazi spastrimesh” dhe “mesianizim i së keqes”. Na del kështu se edhe vetë hebrenjtë kur i skllavërohen një ideologjie të tillë mesianike kthehen në vrasës të mëdhenj, ndër më të mëdhenjtë që ka njohur historia moderne.

Jehuditë që ishin aktivë ne aparatit e terrorit komunist (në Bashkimin Sovjetik dhe jashtë tij) dhe ata që në atë kohë qenë drejtuesit e tyre, nuk e bënë këtë natyrisht si Jehudi, por si stalinistë, komunistë apo sovjetikë. Prandaj ne e gjejmë të kollajshme ta injorojmë origjinën e tyre dhe të luajmë rolin ‘e budallait’: Ne nuk kemi çfarë të bëjmë tashmë me ata? Por të paktën të mos i harrojmë ata. Këndvështrimi im është i ndryshëm. Unë e shoh si të papranueshme, që një person të konsiderohet si pjesëtar i popullit jehudi kur ai bën gjëra të mëdha, por nuk konsiderohet pjesë e popullit tonë, kur ai bën gjëra të çuditërisht të neveritshme. Edhe sikur ta mohonim këtë gjë ne nuk mund të shpëtojmë nga origjina jehudie e “xhelatëve tonë”, të cilët i shërbyen terrorit të kuq me besnikëri e përkushtim nga institucionet e tyre. Sidoqoftë të tjerët do të na e përkujtojnë gjithmonë neve origjinën e tyre. ■

Përktheu: R. A. Hysa

A DO T'I RIKTHEHET AMERIKËS UDHËHEQJA

Shpresat e shumicës së amerikanëve lidhen me Obamën, edhe pse disa shkrymtarë dhe mendimtarë amerikanë mendojnë se periudha e dominimit dhe e udhëheqjes amerikane iku pa kthim

XHAFAER SHEJH IDRIS

Dhe kështu Obama u zgjodh për kryetar të Amerikës. Kryetari i parë zezak, biri i një muslimani të Kenias. Premtimi i tij se do të bëj ndryshime pas viteve të “thata” të Bushit ishte shkaku kryesor për zgjedhjen e tij. A do të arrijë Obama ta përmirësojë atë që e prishi Bushi? Shpresat e shumicës së amerikanëve lidhen me Obamën, edhe pse disa shkrymtarë dhe mendimtarë amerikanë mendojnë se periudha e dominimit dhe e udhëheqjes amerikane iku pa kthim. Për këtë qëndrim ata sjellin prova që duken se janë bindëse.

Duke e argumentuar qëndrimin e tyre ata thonë, se periudha e udhëheqjes amerikane filloi pas Luftës së Dytë Botërore, në vitin 1945. Amerika së bashku me Kanadanë dhe Australinë ishin shtetet e vetme që dolën të



padëmtuara nga Lufta e Dytë Botërore, në një kohë që Britania, Gjermania, Franca, Rusia, Japonia dhe Kina nga kjo luftë dolën të rraskapitura, me shkallë të ndryshme të shkatërrimit. Si pasojë e kësaj gjendjeje ekonomia amerikane arriti në një shkallë të lartë të zhvillimit, që nuk e kishte arritur më parë. Gjysma e prodhimit global ishte e Amerikës. Amerika u bë shtet lider në botë. Sot realiteti ka ndryshuar. Shumë shtete në Evropë dhe Azi janë konkurrencte të Amerikës në prodhim. Ekonomia e Kinës dhe e Indisë rritet mesatarisht me 8% brenda vitit dhe dita ditës bëhen më moderne. Për shembull kompania kineze **China Mobile**, është kompania më e madhe në botë në fushën e telefonisë mobile. Për çdo muaj në rritjen e saj kyçen miliona shfrytëzues të shërbimeve të saj.

Zhvillimi ekonomik i Kinës dhe Indisë është i shoqëruar edhe me një element të rëndësishëm, ndjenja e krenarisë dhe vetëdija se e meritojnë respektin. Ata janë të vetëdijshëm se rruga e zhvillimit dhe e përparimit nuk nënkupton ndjekjen hap pas hapi të Amerikës. Kina arriti të zhvillohet

duke mos e ndryshuar sistemin e saj politik.

Pastaj ndodhi kriza ose po deshe thuaj katastrofa financiare dhe pozita e Amerikës u dobësua akoma më shumë. Na duhet të themi se kriza financiare ndikoi vetëm pjesërisht në dobësimin e dominimit amerikan. Në krijimin e këtij realiteti ndikuan edhe një sërë faktorësh. Me dobësimin e dominimit amerikan pajtohen shumë autorë amerikanë dhe evropianë në lojalitetin e të cilëve ndaj vendeve të tyre, si dhe ndaj qytetërimit të tyre nuk dyshojmë. **Fukujama** që u bë i famshëm me librin e tij “Fundit i historisë” në revistën “**Newsweek**” shkroi një tekst me titullin “Rënia e Amerikës”. Sipas tij dëmi më i madh i krizës financiare ishte dëmi që goditi modelin ekonomik dhe politik amerikan.

Fukujama thotë: “Zhvillimi i madh që përjetoj Amerika bëri që të injorojë kritikuesit e saj socialistë nga vendet e Amerikës Latine, dhe ndodhi që lokomotiva, e cila e lëvizi trenin e zhvillimit të dali nga shinat e Amerikës, dhe paralajmëron se dëshiron të lëvizë edhe zhvillimin e ekonomisë në të gjitha vendet e botës.”

Modeli të cilin Fukujama e quan model amerikan në fakt është modeli kapitalist dhe dëmi më i madh e goditi këtë model, model me të cilin Amerika krenohej duke e përkrahur filozofinë kapitaliste e cila nuk e lejon ndërhyrjen e shtetit në aktivitetin ekonomik. Amerika u detyrua të bëjë një gjë të cilën në dritën e filozofisë kapitaliste e mohonte, ndërhyri të shpëtojë disa banka duke i blerë ose duke i ndihmuar me paratë e tatimpaguesve.

Kriza financiare bashkëkohore e vërtetoi dështimin e teorisë kapitaliste. Filluan të dëgjohen zëra që thërrasin për ndryshime, të tilla që ndryshojnë thelbin e asaj teorie, të cilën ata akoma e quajnë kapitalizëm. Çdo treg në të cilin kanë ndodhur këto ndryshime thelbësore ata vazhdojnë t'i quajnë kapitaliste, sepse gabimisht besojnë se çdo treg në të cilin shitet lirshëm, blihet dhe tregtohet është sistem kapitalist. **E vërteta është se sistem kapitalist është vetëm një model tregu, ekziston edhe sistemi ekonomik që quhet sistem islam.**

Si shkaqe të rënies së Amerikës Fukujama përmend edhe deficitin e madh tregtar, i cili në vitin 2007 arriti shifrën 700 miliardë dollarë. Kjo gjendje nuk mundet të vazhdojë kështu, që më herët ose më vonë vendet e ndryshme do ta kuptojnë, se Amerika nuk është vend i mirë për t'i investuar paratë.

Në vargun e shkaqeve të dështimit amerikan ata përmendin se Amerika në fillim mendohej që me vendime t'i sjelli në bashkëpunim vendet mike "demokratike". Në mandatin e Bushit ata zgjodhën individualitetin dhe izolimin. Lufta në Irak për shembull filloi pa ndonjë rezolutë të Këshillit të Sigurimit pranë OKB-së, e cila do të lejonte përdorimin e forcës. Këtë gjë tani e pranojnë edhe Obama edhe Mekkejni. Mekkejni në një fjalim të tij thoshte: "në një botë si kjo forcat e ndryshme duhet të

“...Amerika u detyrua të bëjë një gjë të cilën në dritën e filozofisë kapitaliste e mohonte, ndërhyri të shpëtojë disa banka duke i blerë ose duke i ndihmuar me paratë e tatimpaguesve...”

shpërndahen gjerësisht dhe në pjesë të barabarta. SHBA-të nuk mundën të udhëheqin duke u mbështetur vetëm në forcën e saj”

Lufta në Irak nuk e dobësoi vetëm ekonomikisht Amerikën. Ajo u bë shkak që njerëzit të humbin besimin tek Amerika. Një shtet nuk mund të udhëheqë, nëse pasuesit e tij nuk i besojnë atij shteti. Askush nuk i beson më Amerikës, e cila me gënjeshtren e armëve për shkatërrim masiv që i “zotëronte” **Sadam Huseini**, justifikoi sulmin ndaj Irakut, vrasjet shkatërrimin dhe keqtrajtimin. Askush nuk beson në vlerat morale të Amerikës, meqë i panë me sytë e tyre pamjet e keqtrajtimit dhe dhunimeve në **Abu Grajib**. Edhe më të magjepsurit me sistemin demokratik amerikan filluan të dyshojnë, nëse Amerika për ta dëshiron atë që dëshiron për veten, meqë i panë arsyetimet e rreme, se qëllimi i luftës në Irak është demokratizimi i Irakut.

Pasi përmendëm provat e këtyre shkrimtarëve dhe mendimtarëve do të prezantojmë edhe mendimet e tyre pa koment.

Michael Elliot në tekstin e tij “Amerika lideri i humbur” në revistën **Time** thotë: “Anketat nuk gënjejnë. Amerika, edhe prej aleatëve të saj shikohet si rrezik që nuk duhet neglizhuar.” Ministri i jashtëm

francez, ministri i një vendi mik, si thotë edhe vetë Elioti, thotë: Kur bota sot e shikon Amerikën nuk mundet të përmbahet e të mos thotë: iku magjia. Në pyetjen: a do të arrijë Amerika ta rikthejë famën e saj, e cila tashmë është luhatur, si pasojë e politikës së saj disavjeçare, ministri u përgjigj: Asgjë nuk do të jetë si më parë.

Publicisti dhe analisti politik **Pat Buchanan**, ish-kandidat për president pas Bushit të parë në shkrimin e tij “Përfundoi ahengu i mbrëmjes” thotë: Kriza financiare ndoshta është fillimi i një periudhe të re në të cilën Amerika do të jetë më e dobët se më parë. Frazat si “fuqia e vetme” dhe “populli pa të cilin nuk mundet” do të iki nga analet e historisë. Pozita jonë pa dyshim do të ulet. **Atë që po shohim sot është shembulli se si përfundojnë perandoritë.**

Në revistën **The Observer** autori britanik, **John Grey** shkruan: Kriza financiare do t’i lëkundë Shtetet e Bashkuara ashtu siç u luhat Bashkimi Sovjetik pas rënies së murit në Berlin. Këto trazira që po shohim janë më të mëdha, se çdo krizë financiare, sado e madhe që të jetë ajo. Me këto ndryshime gjeo-politike ndryshon përfundimisht ekuilibri i forcave në botë. Përfundoi era e udhëheqjes amerikane, e cila filloi me përfundimin e Luftës së Dytë Botërore.

Pas këtyre zhvillimeve, pyetja: A do ta rikthejë Amerika pozitën e saj; duhet të ri-përkufizohet në formën vijuese: A ka forcë Amerika ta ruajë pozitën e saj që ka rënë dukshëm, apo do të vazhdojë rënia e saj? Allahu i Lartësuar thotë në Kuran: **“...Ne, këto ditë i ndërrojmë** (u japim në përdorim) **mes njerëzve...”** Ali Imran, 140. ■

Përktheu: Talha KURTISHI

SPROVA E GAZËS DHE ROLI I DIJETARËVE


Në kohën e Pejgamberit, salAllahu alejhi ue selem, kur njerëzit trishtoreshin ai i siguronte, kur ata shqetësoheshin ai i qetësonte dhe ua shpjegonte çështjet si janë në të vërtetë

PROF. DR. NASIR EL OMER

Lavd-falënderimi i takon Allahut, Zotit të botëve, ndërsa paqja dhe bekimet qofshin mbi të dërguarin, mëshira e botëve... pra:

Nuk ka asnjë dyshim se dijetarët kanë rol të madh në rrugëtimin e Umetit Islam, në të kaluarën, në të tashmen dhe në të ardhmen. Kjo vjen ngaqë ata janë trashëgimtarë të pejgamberit tonë, Muhamedit salAllahu alejhi ue selem, prej të cilit trashëguan dijen, që ai e kishte marrë nga Zoti i botëve. Muhamedi, salAllahu alejhi ue selem, ka thënë: *“Dijetarët janë trashëgimtarë të pejgamberëve, këta nuk lanë trashëgimi ndonjë dinar apo dërrhem, por lanë dijen, të cilën po e mori dikush ai ka marrë një hise të madhe”*.¹ Mbi supet e tyre bie barra më e madhe për

¹ Tirmidhiu 5/48 (2682). Albani i ka dhënë gradën sahih.



shpërndarjen e kësaj trashëgimie të Pejgamberit. Dijetarët janë ata, të cilëve u dedikohet ky hadith: *“Kumtoni nga unë goftë edhe një ajet”*.²

Muslimanët, që në brezat e parë u referoheshin dijetarëve dhe në këtë mënyrë respektonin ajetin: *“Pyetni ata që dinë nëse ju nuk dini”*. (Nahël 43). Shumë fitne dhe sprova që ndodhën tek

muslimanët, ndodhën për shkak të ftohjes me dijetarët dhe qortimit të metodës së tyre. Kush i analizon shumë prej ngjarjeve të historisë, si p.sh., fitneja e vrasjes së kalifit Osman, përhapja e havarixhëve, përhapja e kaderive etj., do ta kuptojë vërtetësinë e kësaj që neve po themi.

Në çastet e krizave dhe sprovave nevoja për dijetarët shtohet dhe më tepër, për arsye se nëpërmjet tyre dallohet e vërteta nga e kota dhe me ndihmën e tyre i kthehen Kuranit dhe Sunetit. Te këto të dyja gjendet shpëtimi nga çdo fitne dhe devijim, dhe me ato largohet çdo mospajtim. Allahu i Madhërishëm thotë: *“O ju që besuat, binduni Allahut, binduni Pejgamberit dhe atyre që drejtojnë punët tuaja. Nëse nuk pajtoheni në ndonjë gjë, drejtojeni Allahut dhe Pejgamberit, nëse besoni Allahun dhe Ditën e Kiametit. Kjo për ju është më e mira dhe shpjegimi më i bukur”*. (Nisa 59). Këtu Allahu urdhëron që t’i bindemi Allahut dhe Pejgamberit në çdo mënyrë, pastaj urdhëron që t’i bindemi atyre që drejtojnë punët tona – udhëheqësve dhe dijetarëve – varësisht se sa ata janë të bindur ndaj Allahut dhe Pejgamberit, salAllahu alejhi ue selem. Përndryshe në kundërshtim të Allahut apo në kundërshtim të Pejgamberit salAllahu alejhi ue selem, ata nuk respektohen. Por nëse ka mospajtim për ndonjë prej çështjeve, atëherë na udhëzon që t’i drejtohemi Kuranit dhe Sunetit, ndërsa dispozitat e tyre i njohin vetëm dijetarët, kjo d.m.th. se e përsëriti urdhrin që t’i bindemi dijetarëve në raste mospajtimi. Por njerëzit: a e bëjnë hapin e tyre realisht pasi marrin mendimin e dijetarëve? Përderisa nuk është ashtu, atëherë dijetarëve nuk u mbetet tjetër gjë përveç thirrjes, shpjegimit dhe stabilizimit të

² Sahihul Buhari 3/1275 (3274).

“Askush të mos mendojë se në këtë mënyrë ne po shfaqim idenë se ulematë nuk kanë asnjë gabim apo anashkalim, jo pasha Allahun...”³

njerëzve.

Në kohën e Pejgamberit, salAllahu alejhi ue seleme, kur njerëzit trishtoheshin ai i siguronte, kur ata shqetësoheshin ai i qetësonte dhe ua shpjegonte çështjet si janë në të vërtetë. Hadithet në këtë kontekst janë të shumta. Dijetarët e umetit akoma vazhdojnë të kenë të njëjtin rol edhe sot, duke u shpjeguar njerëzve çdo çështje se çfarë është ajo në të vërtetë dhe çfarë fshihet pas saj, i përkujtojnë njerëzit se çështjet e tokës janë të lidhura ngushtë me çështjet e qiellit, mirëpo këto ditë kemi dëgjuar shumë zëra që ngrihen aty-këtu: Çfarë bënë dijetarët për këtë sprovë (në Gaza)? Ku është roli i hoxhallarëve? Dijetarët u treguan të dobët! Dhe shumë shprehje të ngjashme.

Një pjesë e këtyre fjalëve del nga goja e disave, që synojnë cungimin e rolit të dijetarëve, rrëzimit të pozitës së tyre, madje edhe luftimit të tyre. Në ndodhitë e fundit ata gjetën rastin për të folur keq, mirëpo unë këtu nuk po u drejtohem atyre, por të tjerëve që thonë fjalë të ngjashme, ndërkohë që janë dashamirë dhe njerëz të mirë, për të cilët mendojmë se janë të sigurtë dhe kanë njet të mirë, kur i thonë ato fjalë. Për këta neve besojmë se fjalët që ata kanë shprehur, i kanë shprehur vetëm për shkak se zemrat e tyre janë të goditura fort nga ndodhitë e vendit të krenarisë,

Gazës. Atje ndodhën vrasje dhe masakra, që nuk burojnë përveçse nga kafshë të egra dhe shpirtra shejtanësh. Me këta vëllezër të nderuar, dua të ndalem pak çaste, sepse edhe nëse gjej shkaqet pse kanë folur ashtu, kjo nuk më lejon t'i arsyetoj akuzat që kanë shprehur ndaj dijetarëve dhe përcmimin e aktiviteteve të tyre.

Para së gjithash na duhet patjetër ta bëjmë të qartë një gjë, të cilën duhet ta kuptojë mirë gjithkush. Ajo është se çdo individ i këtij umeti ka rolin e tij, që duhet të luajë në këtë sprovë dhe në sprovë tjera. Ky rol është i lidhur ngushtë me mundësinë dhe forcën që ka individ. Allahu ka thënë: **“Allahu nuk e ngarkon asnjë shpirt përveç atë që ka mundësi”**. (Bekare 286). Ndaj qortimi, vërejtja dhe mëkati i takon vetëm atë që ka mundësi të takon forcën e tij. Pra, nëse ai ka mundësi të japë përkrahje materiale në çfarëdo lloj forme, por nuk e jep, atëherë ka anashkaluar dhe ndoshta ka bërë gjynah. Gjithashtu nëse një njeri ka mundësi të japë përkrahje morale në çfarëdo lloj forme, por nuk e jep, edhe ky ka anashkaluar dhe ndoshta ka bërë gjynah. Ndërsa ai që nuk ka mundësi të japë asnjë lloj përkrahje, ai sigurisht ka mundësi t'i ngrejë duart, të drejtojë zemrën nga Mbreti i Gjithësisë dhe të thotë: O Allahu im, jemi shtypur. Na ndihmo! Pejgamberi, salAllahu alejhi ue seleme, ka thënë: **“A mendoni se e arrini fitoren dhe riskun ndryshe, pa lutjet e të dobëtëve tuaj”**.³

Nëse kjo u mësua, atëherë medoemos duhet ta kuptojë secili prej jush, që nisja e ushtrive, luftimi i armiqve me armë, hapja e pikave kufitare, bojkotimi diplomatik dhe të ngjashme, të gjitha këto mjete sot nuk janë në duart të dijetarëve; ata nuk

³ Sahihul Buhari 3/1061 (2739)

zotërojnë më shumë se një fjalë këshilluese, udhëzuese, dashamirëse dhe qortuese. Ato fjalë ua thonë udhëheqësve dhe popullatës. Tani unë pyes: Dijetarët, a e kanë anashkalar këtë gjë?

Në shumë vende të muslimanëve dijetarët u prononcuan me deklarata dhe fetva, organizuan tubime dhe simpoziume, biseduan me udhëheqësit, shkruan tema, mbajtën ligjërata dhe hutbe. Me fjalët e tyre ata i drodhën foltoret, por nuk kishte ndikim te shumë njerëz! Dolën edhe nëpër kanalet satelitore për t'u shpjeguar njerëzve realitetin e këtij konflikti, se ai është konflikt për shkak të besimit në rend të parë dhe jo konflikt për tokë apo përfitime politike, sikurse pretendohet gjatë dhe sikurse janë shitur këto ide për shumë vite me radhë. Ata kërkuan gjithashtu prej të gjithëve të japin tërë mundin që kanë, sipas sqarimeve që ne i dhamë më lart, u shpjeguam gjykimin për atë që anashkalon, pra, përveç kësaj çfarë po kërkohet më shumë nga dijetarët, çfarë mundësie kanë ata më shumë se kjo?

Disa njerëz të mirë thonë: Po, folën dijetarët dhe dolën deklaratat, por shprehjet ishin të buta!

Këtu duhet ta bëjmë të qartë: Dijetarët, kur hartojnë deklarata kanë parasysh dobitë dhe dëmet. Për shumë deklarata njerëzit nuk e dinë si kanë dalë, sa herë janë lexuar, përmirësuar dhe rishkruar, sepse hartuesit e deklaratës marrin parasysh ca gjëra që nuk i kuptojnë disa lexues që pastaj të thonë: "të buta". Në anën tjetër, ka deklarata të tjera me një gjuhë të mprehtë dhe entuziaste, duke i marrë parasysh ca gjëra të tjera, ndërsa ne shohim se disa dijetarë kanë nënshkruar te këto dhe ato, por kjo është një divergjencë e lejuar dhe jo divergjencë për kundërshtim. Nuk duhet të jenë patjetër të

njëta, madje ndonjëherë urtësia kërkon që deklaratat të mos jenë në një metodë dhe në një shkallë të lartë mprehtësie dhe entuziazmi, si dhe t'u dedikohen një pale e tjetrës jo. Nuk kërkohet thjeshtë vetëm të nxjerrësh shprehje të forta dhe entuziaste për t'i kënaqur njerëzit e në anën tjetër të mos shikosh fundin, dobitë dhe dëmet.

Le të ketë frikë Allahun ai që i jep liri gjuhës së vet për t'i sharë ulematë, ndërsa nxënësit e dijes le të kenë mendim të mirë për hoxhallarët e tyre dhe vëllezërit e tyre, le të tregohen të butë me ta. Le të marrin parasysh presionet, akuzat dhe shpifjet e shekullarëve dhe liberalëve kundër ulemave, kështu që të mos bëhen ndihmëtarë të tyre kundër këtyre.

Askush të mos mendojë se në këtë mënyrë ne po shfaqim idenë se ulematë nuk kanë asnjë gabim apo anashkalim, jo pasha Allahun, ata nuk janë të pagabueshëm, mirëpo përderisa asnjëri prej tyre nuk ka shprehur të pavërtetën dhe secili u mundua të thotë të vërtetën, atëherë duhet ta arsyetojmë, të tregohemi më të butë me dijetarin dhe të shpresojmë se do të bëjë edhe më tepër. Sepse i gjithë aktiviteti i tyre kthehet në ixhtihadin dhe matjen e tyre për dobitë dhe dëmet, e në këtë mënyrë atij i qartësohet diçka, që tjetrit jo.

Nëse patjetër do të bëjë diçka, atëherë para se të flasë për një hoxhë, le të kontaktojë me të për t'i kërkuar shpjegime, ndoshta do të dëgjojë diçka për shkak të së cilës do ta arsyetojë, madje ndoshta do të ndërrojë mendimin që kishte dhe do të bindet se e vërteta paska qenë ashtu si ka vepruar ai hoxhë.

Allahu e di më së miri. ■

Përktheu: Omer Berisha

A JANË VEPRAT KUSHT I DOMOSDOSHËM PËR IMANIN, APO JANË VETËM KUSHT PLOTËSUES?

Tani, duhet dhënë përgjigje dy pyetjeve: 1. Jobesimtari (qafiri), që është i tillë që në origjinë, çfarë duhet të bëjë që të hyjë në Islam, e si pasojë edhe ai të gëzojë të drejtat e muslimanëve? 2. Çfarë e nxjerr muslimanin nga Islami, duke qenë zotërues i këtij statusi, e për rrjedhojë të konsiderohet jobesimtar (qafir)?

ABDURRAHMAN B. NASIR EL BERRAK

(Vijon nga numri i shkuar)

Tani, duhet dhënë përgjigje dy pyetjeve: 1. Jobesimtari (qafiri), që është i tillë që në origjinë, çfarë duhet të bëjë që të hyjë në Islam, e si pasojë edhe ai të gëzojë të drejtat e muslimanëve? 2. Çfarë e nxjerr muslimanin nga Islami, duke qenë zotërues i këtij statusi, e për rrjedhojë të konsiderohet jobesimtar (qafir)?

Le të fillojmë me pyetjen e parë, ku thuhet: Jobesimtari (qafiri), që është i tillë që në origjinë, çfarë duhet të bëjë që të hyjë në Islam, e si pasojë edhe ai të gëzojë të drejtat e muslimanëve?

Qafiri, pra jobesimtari futet në Islam dhe gëzon statusin e muslimanit duke pranuar dhe duke shprehur shehadetin “La ilahe il-Allah Muhamedun resulullah”. Ai që e shpreh me gojë, duke mos e pranuar dhe duke mos e pohuar me zemër, ai gëzon statusin e muslimanit në pamje të jashtme. Ndërsa kush e shpreh me gojë duke e pranuar dhe duke e pohuar në brendësinë e vet me zemër, ky konsiderohet musliman i vërtetë dhe gëzon statusin e muslimanit, dhe njëkohësisht ka realizuar esencën e

besimit. Ngaqë nuk mund të pranohet Islami (paraqitja e jashtme) përveçse me iman (besimin e brendshëm), sikundërse nuk mund të pranohet imani përveçse me Islam.

Pranimi ose pohimi, në varësi të të cilit gjykohet për ekzistencën ose jo të Islamit, përfshin tri gjëra: besimi me zemër, nënshtrimi i zemrës dhe të shprehurit me gjuhë.

Besimi dhe nënshtrimi i zemrës dhe shprehja me gjuhë mundëson pranimin e jashtëm dhe të brendshëm (të fesë). Të gjitha këto janë pjesë e asaj që të gjithë dijetarët e kanë emërtuar si: “t’i përmbahesh dispozitave të Islamit”; që do të thotë: të besosh në të Dërguarin, paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të, dhe në çdo gjë që i është shpallur atij nga Zoti dhe lidhja e besës me bindje të plotë ndaj tij. Kushdo që nuk i përmbahet kësaj të vërtete që u përmend, nuk është pohues i rregullt dhe i vërtetë.

E kundërta e togfjalëshit ‘besimi dhe pohimi me zemër’, manifestohet përmes përgënjeshtimit, dyshimit dhe refuzimit, prandaj duhet pasur kujdes.

Me fjalën ‘nënshtrim’ nënkuptohet përgjegjshmëria, bindja, dashuria, kënaqësia dhe pranimi. Ndërsa e kundërta

“Me fjalën ‘nënshtim’ nënkuptohet përgjegjshmëria, bindja, dashuria, kënaqësia dhe pranimi...”

e këtyre gjendjeve konsiderohet refuzimi, mendjemadhësia ndaj të vërtetës dhe ndaj besimit dhe mospëlqimi i asaj që përmban Shpallja, që iu zbulua të Dërguarit, paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të.

Ndërkaq ‘të shprehurit ose të shqiptuarit me gjuhë’, i kundërvihet përgënjeshtrimi dhe indiferentizmi.

Për këtë arsye kush beson me zemër dhe mohon me gojë ka mohuar me mohimin më skeptik, që quhet xhuhud, ‘mospranim’, dhe kush mohon me zemër dhe pohon me gojë si besimtar, mohimi i tij është i sojit të hipokrizisë.

Si rrjedhojë, dalim në përfundimin se llojet e kufrit, mohimit janë gjashtë dhe që të gjitha bien në kundërshtim me thelbin e Islamit. Ato janë:

1. Kufri i përgënjeshtimit (Tekdhib).
2. Kufri i dyshimit (Shek).
3. Kufri i indiferentizmit (I’rad).
4. Kufri i refuzimit dhe mendjemadhësisë (Iba) (Istikbar).
5. Kufri i mospranimit (Xhuhud).
6. Kufri i hipokrizisë (Nifak).

Sa i takon kufrit të refuzimit dhe mendjemadhësisë mund të përmendim se ai është: mospasimi i të Dërguarit, Muhamed paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të, dhe mospërgjigjja ndaj ftesës së bërë prej tij, pavarësisht faktit që e beson me zemër dhe e shpreh atë me gjuhë, siç ndodhi me Ebu Talibin.

Sa i përket pyetjes së dytë, në të cilën thuhet: Çfarë e nxjerr muslimanin nga Islami, duke qenë zotëruar i këtij statusi, e

për rrjedhojë të konsiderohet jobesimtar (qafir)?

Trajtesa e kësaj pyetjeje mund të reduktohet në tri çështje:

E para: Çdo gjë që bie ndesh me pranimin e shehadetit, siç është rasti me gjashtë llojet e kufrit që përmenda më lart. Nëse muslimani bie në ndonjërin prej tyre, ai konsiderohet i dalë nga feja.

E dyta: Çdo gjë që bie ndesh me domethënien e shehadetit “La ilahe il-lallah Muhamedun resulullah” (Nuk ka të adhuruar me të drejtë përveç Allahut dhe Muhamedi është i Dërguari i Allahut).

A. Domethënia e pjesës së parë “La ilahe il-lallah” (nuk ka të adhuruar me të drejtë përveç Allahut) **është: Mohimi i tagutit** (çdo lloj idhulli që adhurohet, që kërkon bindje dhe që pasohet përveç Allahut) **dhe besimi në Allahun**, gjë që përfshin teuhidin me tri kategoritë e tij.

1. Njësimi i Allahut në veprat e tij.
2. Njësimi i Allahut në adhurim me veprat tona.
3. Njësimi i Allahut në emrat dhe cilësitë e Tij.

E pra, kjo nënkupton se Allahu i Lartëmadhëruar është Zoti, Sunduesi dhe Pronari absolut i gjithçkaje. Çdo gjë që Ai ka dashur ka ndodhur, ndërsa çfarë nuk ka dashur është e pamundur të ndodhë. Ai është i adhuruar me të drejtë dhe çdo gjë që adhurohet përveç Tij nuk është e drejtë. Ai është i cilësuar me të gjitha cilësitë dhe virtytet më të larta të përsosmërisë; i dëlirë prej çdo të mete e mangësie, ashtu siç e ka përshkruar Vetën e Tij dhe siç e ka cilësuar i Dërguari i Tij, paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të, sigurisht përmes Shpalljes nga Zoti, pa hequr nga domethëniet e saj asnjë tekst dhe pa e ngjasuar me krijesat; çdo gjë në rrjedhën e asaj që Allahu vetë ka thënë: **“Asgjë nuk i shëmbëllen Atij. Ai i dëgjon të gjitha dhe i sheh të gjitha”**.

Shura; 11.

Njësimi i Tij në adhurim dhe shfajësimi prej çdokujt që adhurohet përveç Tij.

Për një sqarim më të imtësishëm themi:

Gjërat që e bëjnë të pavlefshëm teuhidin, pra, njësimin e Allahut janë:

1) Mohimi i ekzistencës së Allahut. Ky është lloji më i pështirë i mohimit, që njihet ndryshe edhe si ateizëm, i cili nuk ka asnjë të përbashkët me besimin. I ngjashëm me të është edhe panteizmi.

2) Besimi se krahas me Allahun ka ndonjë Krijues, Rregullues apo Ndikues tjetër, i cili ka ndikim të veçantë përveç atij të Zotit në çështjet që janë prej të madhit Zot.

3) Besimi se krahas Allahut ka ndonjë të ngjashëm nga krijesat; në veçoritë, cilësitë, përsosmërinë dhe përkujdesjen e Tij, si dija apo gjithëfuqia e Tij.

4) Përngjasimi i të Lartmadhëruarit me ndonjë prej krijesave të Tij, në vetë Qenien, Cilësitë, Veprat e Tij; siç kanë thënë Mushebihet (një nga grupet e humbura): “dëgjon siç dëgjojmë ne!”. Gjithashtu në këtë kategori përfshihet edhe të cilësuarit e Tij me të meta si varfëria, koprracia, pamundësia etj. Sikurse përfshihet bashkëvendosja e ndonjë të ngjashmi pranë Tij, e ndonjë fëmije apo bashkëshorteje.

5) Të besuarit se ndonjërit prej krijesave i takon adhurimi përveç Allahut; ky është mohim në çështjen e adhurimit, pavarësisht nga fakti, se a e praktikon këtë besim apo jo.

6) Të besuarit se ndonjë prej krijesave të Zotit meriton adhurim, qoftë veçmas apo me Zotin. Ky besim konsiderohet mohim, ose shirk në adhurim, ose t'i kushtohet ndonjë lloj adhurimi dikujt apo diçkaje, duke besuar se ka fuqi të bëjë dëm apo dobi, duke mos marrë parasysh se

beson që ky/kjo që po i përkushton adhurimin është ndërmjetësues ndërmjet tij dhe Zotit apo e meriton ai vetë, siç është sexhdja para idhujve (ose varret dhe tyrbet në vendin tonë). Dallimi mes dy llojeve të kufrit është se ky i fundit (i gjashti) është kufër që ka të bëjë me të vepruarin, që bie ndesh me teuhidin, ose e thënë ndryshe, që kundërshton njësimin e Allahut në adhurim. Ndërsa i pesti ka të bëjë me mohimin thjesht duke besuar se kjo gjë mundet ose lejohet në raport me atë që vetëm Zotit i takon: adhurimi dhe merita për t'u adhuruar.

Për vetë lidhjen e ngushtë të besimit me veprat njësohet emërtimi i këtij lloji të teuhidit me emrin Njësimi i të adhuruarit ose në adhurim, dhe për të kundërtën e tij me mohim i të adhuruarit ose në adhurim.

7) Mohimi i emrave dhe i cilësive të Allahut, sikur edhe i një emri apo cilësie të vetme.

8) Magjia, duke përfshirë:

a) Magjinë e llojit që bëhet shkak për ndarjen e burrit dhe gruas, siç bënin babilonasit e lashtë (ose e kundërta për t'i bashkuar).

b) Magjinë që ka të bëjë me fryrje nëpër nyje të lidhura, siç bënte Lebid el-Asami dhe bijat e tij. Shënon Buhariu.

c) Apo atë lloj magjie që ushtron hipnotizim, që i sheh gjërat jo siç janë në realitet, siç bënin magjistarët e Faraonit.

Të gjitha këto forma ekzistojnë në sajë të adhurimit të dikujt tjetër përveç Allahut, duke i bashkangjitur Atij ortak në adhurim, si, për shembull, xhindet, yjet etj.

Ndërsa për sa i takon magjisë, që ka të bëjë me lojëra shpejtësie, e cila është e lidhur me zgjuarsinë, mençurinë, lëvizjet e shpejta dhe fshehjen e veprimeve, apo magjia imagjinare, duke përzier disa elemente në momente të caktuara, sikur nuk janë të tilla; këto dy lloje konsiderohen

si mashtrime dhe gënjeshtër, por jo mohim (kufër).

B: **Domethënia e pjesës së dytë të dëshmisë: “Muhamedun Resulullah”** (Muhamedi është i Dërguari i Allahut), **është të besosh se Allahu e dërgoi Muhamedin** (paqja qoftë mbi të) **si profet për mbarë njerëzimin**, me udhëzim drejt fesë së vërtetë. Të besosh se ai është vula e profetëve. Të besosh dhe të pranosh çdo gjë që ai lajmëroi. Të besosh në vërtetësinë e kumtimit, dhe se udhëzimi e drejtimi i tij është më i miri, dhe më i përsosuri. Të besosh gjithashtu, se besimi, bindja dhe dashuria për të janë obligim dhe detyrim për këdo.

Gjërat që e bëjnë të pavlefshme pjesën e dytë të shehadetit: “Muhamedun Resulullah”.

1) Mohimi dhe mospranimi i Zbulesës (sqarimeve të Fesë) me të cilën erdhi; përgënjeshtrimi ose dyshimi në vërtetësinë dhe besueshmërinë e mbartësit të kësaj Zbulese.

2) Të besuarit dhe të deklaruarit se profetësia nuk është mbyllur me dërgimin e tij, pra të pohosh se pas tij ka akoma profetë. Ose t’u besosh atyre që pretendojnë se janë profetë pas vdekjes së tij dhe vënia në dyshim e gënjeshtërës së tyre, se mund të jetë e vërtetë.

3) Mohimi i faktit se shpallja që i erdhi Muhamedit, paqja qoftë mbi të, ishte për mbarë njerëzimin. I njëjti gjykim vlen për këdo që beson, se ai është i Dërguari i Allahut vetëm për arabët, qoftë edhe sikur të pretendohet një gjë e tillë. Po kështu besimi se çifutët dhe të krishterët nuk e kanë për detyrë ta pasojnë. Besimi se ndonjëri ka të drejtë të dalë prej fesë që ai solli, sikurse mendojnë disa filozofë dhe të vetëquajturit “Arifinë” në mesin e sufive.

4) Ulja e vlerave të Dërguarit, paqja qoftë me të, ose mvëshja e mangësive dhe

të metave në personalitetin e tij si profet, apo në udhëheqjen që ai përfaqëson për njerëzimin, apo në jetën e tij.

5) Tallja dhe përqeshja e tij, ose e diçkaje nga Shpallja që i zbriti prej Zotit, si në fushën e besimit po edhe në atë legislative.

6) Përgënjeshtrimi i ndonjë fakti që ai ka lajmëruar prej gajbit (nga bota e fshehtë), që ka të bëjë me Allahun, Melaiket (engjëjt), Librat, të Dërguarit, zanafillën e krijimit, përfundimin e krijimit, Ringjalljen, Xhenetin, Xhehenemin etj.

Gjërat që i zhvlehtësojnë dy dëshmitë

“La ilahe il-la Allah, Muhamedun Resulullah”:

1) Përgënjeshtrimi i faktit se Kurani është libri i Allahut. Mohimi i tij, ose mohimi i një sureje apo i një ajeti të caktuar, madje edhe mohimi i një shkronje të vetme. Këtu futet edhe besimi, se Kurani është i krijuar, apo se nuk është fjalë me të cilën ka folur vetë Allahu.

2) Dhënia e përparësisë ndaj ligjeve të tjera kundrejt ligjit të Allahut, duke përfshirë këtu çdo lloj kushtetute e çdo lloj legjislacioni, pa marrë parasysh se cili është ai, mjafton që nuk buron nga ligji i Allahut dhe i të Dërguarit të Tij, paqja qoftë me të. Apo të besohet se këto ligje janë të barabarta me ato të Allahut; apo se lejohet të gjykohet me këto ligje, pavarësisht se mund të besohet se ligji i Zotit është më i mirë.

3) Ta bësh haram atë gjë që Allahu e ka bërë hallall; ose ta bësh hallall atë që Allahu dhe i Dërguari i Tij, paqja qoftë me të, e kanë gjykuar si haram. Këtu bën pjesë edhe bindja ndaj atyre që veprojnë në këtë mënyrë. ■

Përktheu: Ahmed KALAJA

KRIZA BOTËRORE FINANCIARE

MËSIMET DHE PËRVOJA NGA EKONOMIA KAPITALISTE PA MORAL

Shtetet që promovonin komunizmin ranë dhe disa prej tyre u ndanë në shtete më të vogla. Kurse sot u vërtetua dështimi i sistemit kapitalist, të cilin e kanë përqaftuar një sërë shtetesh perëndimore. Ja se si po lëkundet ky sistem sot, para të gjithë botës, ku edhe ekonomia e shtetit më të fuqishëm të globit po ballafaqohet me rënien dhe orvatjet po vazhdojnë në ruajtjen e tij.

HETLAN B. ALIU EL HETLAN

Tregjet financiare në perëndim dhe në lindje, këto ditë po përjetojnë një gjendje lemerie dhe frike, si pasojë e kolapsit dhe e rënies me të cilin po ballafaqohen disa kompani dhe banka amerikane. Ky është një mësim për ata që janë verbuar pas civilizimit perëndimor dhe kanë kërkuar që kompanitë, bankat dhe tregjet e muslimanëve t'i kopjojnë ato perëndimoret. Ky është kapitalizmi perëndimor, që është përshkallëzuar në tregjet e tyre, duke u përballur ekonomia e tyre me krizën më të madhe financiare që po shohim në këtë kohë, madje ndoshta me baltën e kësaj krize janë përllaçur të gjitha kompanitë dhe bankat pjesëmarrëse në ato tregje në të gjithë botën në gjatësinë dhe gjerësinë e saj.

Mirëpo për të marrë mësim dhe përvojë nga ajo që ndodhi, duhet të sqarohet patjetër problemi që çoi deri te recesioni dhe kolapsi më i madh, që po përjeton ekonomia amerikane. Një përfundim i asaj që ndodhi mund të përmbledhet në faktin, se bankat u dhanë kredi klientëve, madje edhe atyre individëve që nuk arrinin të merrnin kredi për blerjen e banesave për shkak të pagave të kufizuara mujore që kishin, veprim ky që i shtyu njerëzit të orientoheshin drejt kredimarrjes me kamata të larta, duke i joshur klientët me mungesën e kamatës në fazën fillestare të kreditës.

Me ngritjen e vazhdueshme të çmimeve të

banesave, bankat filluan t'i joshin klientët e tyre kredimarrës, duke ua mundësuar që të arrinin fitime produktive pasi që objektet e tyre banesore i kaluan çmimet e blerjes dhe bankat u ofruan atyre kredi të reja duke kërkuar nga ata që të hipotekojnë një pjesë të vlerës së banesave.

Mirëpo klientët nuk arritën ta hetojnë rrezikun që përfshinin kontratat mashtruese dhe që ato përmbanin një padrejtësi të madhe, sepse çmimet e kamatës ishin të ndryshueshme kohë pas kohe dhe nuk ishin të qëndrueshme, ku në fillim jepeshin të ulëta, por me kalimin e kohës rriteshin. Në këto kontrata ekziston një nen ku thuhet: “Çmimet e kamatës do të rriten sa herë që ato i ngre Banka Qendrore”. Një nen tjetër thoshte: “Nëse klienti vonohet në pagesën e ndonjë rate, atëherë çmimi i kamatës do të trefishohet”. Por më interesante ndër të gjitha pikat ishte neni tjetër ku saktësohej: “Të gjitha këstet e paguara gjatë tri viteve të para të kontratës do të jenë pagesë e kamatës”, gjë që tregonte qartë se me ato pagesa trevjeçare nuk do ta kishe pronësinë e një pjese të objektit derisa të kalonin tri vite.

Pasi kaluan disa muaj, Banka Qendrore i rriti përqindjet e kamatës dhe njëkohësisht u ngritën edhe shumat e kësteve mujore. Pastaj, prapë pas një viti u rritën çmimet e interesit, ashtu siç thuhej në kontrata dhe shumica e klientëve e patën të pamundur t'i kryenin detyrimet e tyre, prandaj u vonuan. Atyre iu grumbulluan edhe penalitetet

kamatore shitesë, si rezultat i vonesës dhe filluan ta ndërpresin pagesën tërësisht, gjë që i çoi bankat deri te konfiskimi i atyre banesave dhe klienti u detyrua që ta shesë objektin e vet për t'i paguar këstet e paarrtshme. Kështu, problemi u përkeqësua edhe më shumë dhe u përhap derisa përfundoi me kolapsin e tregjeve banesore.

Në realitet fitimet e bankës që kreditonte për klientët e saj duhej të ndaleshin në kamatat e pastra që mblihdeshin prej kredive, mirëpo gjërat nuk u ndalën këtu. Bankat filluan t'ua shesin borxhet në formën e letrave me vlerë investitorëve nga e gjithë bota, disa madje nga vendet e Gjirit Persik derisa edhe disa qeveri të shteteve të ndryshme filluan të investojnë në ato letra me vlerë, morën komisione, taksa shërbyese prej tyre etj., çka do të thotë se banka përfitoi çdo gjë që ishte e mundur, si komisione etj. dhe rrezikun e mundshëm e transferoi tek investitorët.

Investitorët tani zotërojnë letra me vlerë të mbështetura me patundshmëri dhe arrijnë të fitojnë nga të ardhurat që burojnë nga pagesat mujore të kredimarrësve varfanjakë. Kjo do të thotë se nëse falimentojnë kredimarrësit – gjë që ka ndodhur – atëherë mund të merren patundshmëritë dhe të shiten për t'i mbështetur letrat me vlerë. Mirëpo ata investitorë i kanë hipotekuar ato letra me vlerë në cilësinë e aseteve në këmbim të borxheve të reja për të investuar në blerjen e letrave të tjera me vlerë. Po! I kanë shfrytëzuar borxhet për të përfituar borxhe të reja, saqë bankat e kanë anashkaluar aq shumë këtë çështje derisa mundësohej hyrja në borxhe në shuma për tridhjetëfish më të mëdha sesa vlera e hipotekave.

Banka ndërmoi shndërrimin e borxheve në letra me vlerë dhe ia shiti një banke investuese, e cila një pjesë të tyre i mbajti për vete, kurse pjesën e tjetër ua shiti fondeve

“I kanë lejuar ndërmarrjet bujqësore që t'i asgjësojnë begatitë bujqësore, t'i hedhin ato në bërlllok, t'i fusin në dhe’, e gjithë kjo për të ruajtur kërkesën në treg, edhe nëse fukarenjtë përpëliten nga uria..”

rezervë dhe fondeve të pavarura në të gjitha anët e botës. Në këtë mënyrë të gjithë mendonin se patundshmëria i takon atyre, duke filluar nga klienti, Banka Komerciale si dhe Banka Investuese, kurse vetë investitorët besonin se zotërojnë letra me vlerë, meqë diku gjendet një pasuri e patundshme që i stimulon këto letra.

Ngjarja ende nuk ka përfunduar. Meqë vlera tregtare e letrave me vlerë dhe përfitimet prej tyre mbështeteshin në vlerësimin e kompanive vlerësuese të letrave me vlerë, të cilat vlerësimin e tyre e bazonin në mundësinë e klientit për larjen e borxhit apo pamundësinë e tij dhe meqë klientët që kishin blerë objektet banesore nuk ishin të një kategorie financiare, atëherë doemos do të dallonin edhe vlerat e letrave me vlerë. Pra, letra me vlerë që ishte e sigurt se kredimarrësit do të kishin mundësi t'i paguajnë morën vlerësimin A, të tjera letra me vlerë morën vlerësimin B, kurse të tjera do të vlerësohen, se nuk kanë fare vlerë për shkak të pamundësisë së pagesës së tyre. Për ta shmangur këtë problem, bankat filluan t'i forconin qendrat e letrave me vlerë nëpërmjet shpikjes së mënyrave të reja të sigurimeve, duke qenë zotëruesi i letrave me vlerë i siguruar njëkohësisht me një pagesë mujore për sigurim, që në rast të falimentimit të bankës apo zotëruesit të patundshmërisë

kompania e sigurimit të paguajë vlerën e letrave me vlerë, që kishte në zotërim i siguruari. Natyrisht që kjo mënyrë e të siguruarit nxiti shumë investitorë nga mbarë bota, që të blejnë për të zotëruar edhe më shumë letra me vlerë, që më vonë do të quheshin si të “helmuara”.

Në fund, pasi kredimarrësit filluan të mos i paguajnë këstet mujore, për shkak të rritjes së çmimit të kamatës, letrat me vlerë e humbën vlerën e vet dhe falimentuan bankat investuese dhe fondet e ndryshme të investimit, kurse ata që i kishin siguruar letrat me vlerë, morën si kompensim tërë vlerën e letrave me vlerë dhe kjo shkaktoi falimentimin e kompanisë së sigurimit AIG.

Procesi i falimentimit i detyroi bankat që t'i zvogëlojnë rreziqet, duke i zbritur transaksionet kreditore, gjë kjo që ndikoi dukshëm tek ndërmarrjet prodhuese dhe të tjera, të cilat kanë nevojë për likuiditete për të plotësuar transaksionet ditore. Shenjat e recesionit të madh filluan të dalin në pah. Kjo gjë e detyroi qeverinë amerikane që t'i shtojë mjetet bazë nëpërmjet subvencionit të një sasive të madhe fondesh për ta rivitalizuar ekonominë, e cila filloi të lëkundet nën presionin e borxheve për të investuar në borxhe.

Për këtë arsye ndodhi rënia e madhe në ekonominë kapitaliste liberale dhe falimentuan më shumë se një mijë banka në Amerikë, në mesin e të cilave edhe dy banka nga katër bankat më të mëdha amerikane. Njëra është banka “Lehman Brothers”, me falimentimin e së cilës u regjistrua falimenti më i madh në historinë e Amerikës. Kjo bankë kishte më shumë se 160 vite jetë dhe ishte banka më e pasur në botë. Kështu ndodhi edhe me banka të tjera dhe me kompani shumë të mëdha sigurimesh, ku u nacionalizuan dy kompanitë më të mëdha të hipotekave të paluajtshme dhe qeveria amerikane i mori nën kontroll 80% të

kapitalit të kompanisë AIG, duke i kredituar 85 miliard dollarë, për ta ndihmuar kapitalin e kompanisë dhe pushuan nga puna më shumë se 159,000 punëtorë. Këtë rënie e pësuan shumica e shteteve të globit në proporcione të ndryshme, ku falimentuan banka të mëdha në Britani, Gjermani, Belgjikë, Holandë, Francë etj.

Më përpara një gjë të tillë e kishin kaluar shtetet me sistem socialist dhe marksist dhe kishin dështuar qartë. Shtetet që promovonin komunizmin ranë dhe disa prej tyre u ndanë në shtete më të vogla. Kurse sot u vërtetua dështimi i sistemit kapitalist, të cilin e kanë përqaftuar një sërë shtetesh perëndimore. Ja se si po lëkundet ky sistem sot, para të gjithë botës, ku edhe ekonomia e shtetit më të fuqishëm të globit po ballafaqohet me rënie dhe orvatjet po vazhdojnë në ruajtjen e tij.

Çdo ekonomi që ballafaqohet me kësi tronditjesh të vrullshme, bëhet shkak për të larguar me mijëra punëtorë nga puna, bëhet shkak për të falimentuar kompani dhe banka gjigante, është ekonomi e dështuar sado që shtyhet në kohë.

Perëndimorët kritikojnë kurse ata që humbën justifikojnë.

Për në muslimanët nuk është e papritur që të lëkundet një ekonomi, e cila mbështetet në liri të pakufizuara, që ushqehet me kamatë, mbështetet në letra me vlerë dhe në kredi, shet dhe blen me marginë (transaksione të shkurta), tregton me aksione pa i zotëruar, rrezikon edhe gjërat rezervë. Por ajo që ndodhi është e papritur për botën e civilizuar, e cila i beson vetëm vlerave kapitaliste, praktikon vetëm idetë e kapitalizmit, respekton vetëm parimet dhe etikën kapitaliste. Po ashtu ishte e papritur dhe telendisje për ata që janë orientuar nga perëndimorët, ose sillet në orbitën e tyre, ose bën jetën e tyre. Për këtë arsye ata që jetojnë me mentalitetin e tyre filluan të arsyetohen për tronditjen që pësoi sistemi kapitalist, të

cilit i prin Amerika, se kjo gjë nuk ka ndodhur për shkak të sistemit, i cili beson në liri të shfrenuar, por kjo ka ndodhur sipas supozimit të tyre, si pasojë e disa praktikave të gabuara në treg, në kohën kur disa gazeta të shteteve perëndimore kanë publikuar reagime të ashpra kundër kapitalizmit.

Sa i përket muslimanëve, ata qysh para 14 shekujve e kanë mësuar, se nuk ka në treg liri të pakufizuar. Kanë mësuar se kamata është një mëkat i madh dhe se nuk sjell tjetër gjë, përpos shkatërrimin dhe rrënimin e jetëve njerëzore, zjarr i mjerimeve dhe çrrënjosje e pasurisë dhe begative. Allahu ka thënë: **“Allahu ia heq çdo përfitim kamatës, kurse e rrit përfitimin e bamirësisë.”** (Bekare, 276)

Jo vetëm kaq, para tyre këto gjëra i kishin mësuar hebrenjtë dhe të krishterët nëpërmjet librave të shpallura nga Allahu, ashtu siç ka treguar Krijuesi i Madhërisëm në fjalën e Tij në Kuran: **“...për shkak se merrnin kamatë, megjithëse kjo ishte e ndaluar për ta dhe për shkak se përvetësonin padrejtësisht pasurinë e njerëzve.”** (Nisa', 161)

Po ashtu dijetarët tanë bashkëkohorë e kanë sqaruar mirë, se shumë mënyra të reja tregtimi janë të ndaluara, si shitblerja me margjinë, shitja dhe blerja e aksioneve pa i zotëruar, sigurimi komercial etj., dhe për këto gjëra janë dhënë vendime shariatike dhe vendime të asambleve të ndryshme të juristëve islamë prej vitesh.

Meqë tregjet perëndimore njohin vetëm kapitalizmin dhe pasi besojnë vetëm në sisteme që legjitimojnë fitimin e pasurisë pa farë morali, njeriu kjo krijesë e dobët i është shmangur Rrugës së Vërtetë dhe i ka kundërshtuar mësimet e Krijuesit. Allahu thotë: **“E si të mos dijë Ai që ka krijuar gjithçka, kur Ai njej çdo gjë me imtësi dhe është i Gjithëinformuari?!”** (Mulk, 14). Janë dhënë pas ligjeve të krijesave, të cilat kundërshtojnë ligjet e Allahut, dhe nxorën ligje, që e lejon kamatën dhe e legjitimon

fitimin e saj, kanë themeluar parime kapitaliste që e respektojnë kapitalin, aq sa nuk e respektojnë vetë njeriun. P.sh. i kanë lejuar ndërmarrjet bujqësore që t'i asgjësojnë begatitë bujqësore, t'i hedhin ato në bërlllok, t'i fusin në dhe', e gjithë kjo për të ruajtur kërkesën në treg, edhe nëse fukarenjtë përpëliten nga uria. Madje kanë hartuar ligje që janë në krahun e të pasurve e në kurriz të varfanjëve dhe nevojtarëve, që këto ligje t'i shkojnë për shtat biznesmenëve, edhe nëse të varfrit për shkak të tyre mbeten në punë të vështira.

Pasi këto parime kapitaliste janë prodhim i njeriut e jo i Krijuesit të tyre, propaganduesit dhe mbrojtësit e kapitalizmit janë kthyer tani nga ajo që e konsideronin të shenjtë më parë, ku prej vitesh kanë ngritur një sërë parullash lidhur me “tregun e lirë”. Ja, ata janë sot që e rrokullisin për tokë atë liri, për t'i shpëtuar tregjet e tyre financiare dhe ndërmarrjet e tyre kapitaliste, të cilat po lëkunden nën ndjenjën e falimentimit. Ky është Kongresi Amerikan që voton për propozimin e presidentit amerikan për subvencionimin e 700 miliardëve dollarëve që të shpëtojnë kompanitë e tyre prej falimentimit. Me këtë veprim ndërhyrja e Qeverisë për shpëtim do të ishte një gozhdë tjetër në arkivolin e kapitalizmit, duke e ndaluar sot atë që e kishin legjitimuar deri dje si shitblerjen e aksioneve pa i pasur në zotërim. Këtë e kanë ndaluar sot deri në ndonjë njoftim tjetër, pikërisht atëherë kur zbuluan ndikimin negativ dhe të rrezikshëm për tregjet dhe ndërmarrjet e tyre etj.

Islami ua ka tërhequr vërejtjen njerëzve për këtë problem qysh herët.

Nëse kthehemi mbrapa për 14 shekuj do të vërejmë se Islami e ka kufizuar atë liri, e cila nuk kultivon kujdes për të varfrin dhe të vobektin. ■

(Vijon në numrin e ardhshëm...)

Përktheu: Muhamed DËRMAKU



PLANI I PËRPARIMIT PERSONAL¹

Atyre që u mungon synimi në këtë jetë, u ngajnë të humburve, të cilët nuk e dinë rrugën e caktuar, që duhet ecur në të. Ajo çfarë duhet bëni fillimisht është t'i caktoni vetes ëndrra, ku më pas do t'i shndërroni ato në synime

PËRGATITI: AGRON TERZIQI

Plani është që të vendosësh paraprakisht lidhur me atë që duhet vepruar në të ardhmen për të realizuar ndonjë synim të caktuar. Fatkeqësisht shumica e njerëzve largohen sa herë që dikush flet rreth planifikimit, ngaqë është krijuar bindja se kjo është një çështje që me të nuk merren njerëzit e thjeshtë, por vetëm diçka e politikanëve, udhëheqësve apo e administratorëve. Kjo është edhe arsyeja

përse njerëzit nuk lexojnë për këtë temë, nuk flasin në mes vete, madje as nuk mendojnë për një gjë të tillë.

Përparimi është veprimi që ka si qëllim ndryshimin, përmirësimin dhe avancimin tek më e mira.

Personal nënkupton atë që është e veçantë dhe vetjake. Ka të bëjë me gjërat që lidhen posaçërisht me ty si njeri, e që përbëjnë dëshirat, veprimet, mendimet dhe veçoritë me të cilat karakterizohesh e dallohesh ti nga njerëzit e tjerë.

Prandaj edhe themi se plani i përparimit

¹ Marrë nga libri Sina'atu en-Nexhah të Abdullah Subej'i

“Bëhuni të kënaqur me veten dhe të tjerët duhet t’i pranoni ashtu siç janë...”

personal është: **Përgatitja paraprake për të vepruar diçka, me qëllimin e përmirësimit të një gjendje të caktuar, që ka të bëjë me vetë personin, brenda një periudhe të caktuar kohore.**

Po ju, keni plane për përparimin personal?

Pa dyshim që po! Ju në jetë keni arritur gjëra për të cilat mund të krenoheni, megjithëse meritoni edhe më shumë. Mirëpo, arritja juaj a është rezultat i ndonjë plani të organizuar dhe të përpiktë, i rastësisë së pastër apo është kombinim i këtyre të dyjave?

A jeni duke ecur tani konform atij plani praktik të veçantë, i cili ju siguron arritjen deri te objektivat, në bazë të një limiti të caktuar kohor? Apo i jeni dorëzuar shpresave të kota, shtyrjes, zvarritjes dhe vonesës, duke u preokupuar me problemet e jetës.

Hapa praktikë drejt përparimit personal

Ka njerëz që nuk kanë fare problem imagjinatën dhe përfytyrimin e qartë të së ardhmes, të cilën e ëndërrojnë në jetë, mirëpo ka edhe të atillë që vuajnë nga kjo. Grupi i fundit ka nevojë për diçka që ua pasuron imagjinatën dhe imazhin e asaj që dëshirojnë, duke ua afruar në mendje, me qëllim që këto dëshira dhe shpresa të shndërrohen në synime praktike, ku mund të lëvizin drejt tyre dhe t’iu afrohen.

Nëse takoni grupin e parë, atëherë dymbëdhjetë pyetjet e radhës do të mund t’ju ndihmojnë në përcaktimin e së ardhmes që ju dëshironi. Ndërsa, nëse jeni prej grupit të dytë, këto pyetje konsiderohen për ju të

domosdoshme, dhe me lejen e Zotit, do t’ju bëjnë të mundur të bëni atë që nuk keni bërë gjatë tërë jetës, si dhe ta orientoni veten nga rruga e suksesit hap pas hapi.

Këto janë:

- 1) Cilat janë synimet e juaja për të ardhmen?
- 2) Ku gjendeni ju tani?
- 3) Cilat janë ato botëkuptime, që ju kthejnë mbrapa?
- 4) Çfarë dëshironi që të realizoni në fillim?
- 5) Cilat janë ato ndryshime, që duhet t’i bëni në vetvete?
- 6) A është pozicioni juaj i favorshëm?
- 7) Sa kohë ju nevojitet, që të realizoni synimet tuaja?
- 8) Kur do të filloni me të vërtetë?
- 9) Nga jeni drejtuar?
- 10) Kush janë përgjegjësit?
- 11) A jeni fleksibël sa duhet?
- 12) Për atë që jeni duke bërë po mbështeteni tek vetvetja apo tek Allahu?

Cilat janë synimet e juaja në të ardhmen?

Allahu i Madhërishëm nuk e krijoi këtë gjithësi thjesht për lojë: **“Ne nuk e kemi krijuar qiellin dhe Tokën e ç’gjendet në mes tyre, për të luajtur** (pa qëllim).” Ai gjithashtu na bëri me dije se nuk na krijoi pa ndonjë qëllim të caktuar, prandaj në Kuranin Famëlartë thuhet: **“Xhindet dhe njerëzit i kam krijuar vetëm që të Më adhurojnë.”**

Meqë realiteti është i tillë, atëherë shtrohet pyetja: “Cili është synimi juaj në këtë jetë dhe çfarë dëshironi të arrini në këtë botë?”

Nëse nuk dini se çfarë dëshironi të arrini në këtë botë, atëherë nuk do të tregoni interesim për asgjë dhe se çdo gjë në sytë tuaj do të duket e parëndësishme. Nuk çuditëm po qe se tek ju shfaqen edhe

simptoma të depresionit.

Një fjalë e urtë popullore thotë: “Nëse nuk e dini se ku do të shkoni, atëherë të gjitha rrugët të çojnë deri atje.”

Atyre që u mungon synimi në këtë jetë, u ngjajnë të humburve, të cilët nuk e dinë rrugën e caktuar, që duhet ecur në të. Ajo çfarë duhet bëni fillimisht është t’i caktoni vetes ëndrra, ku më pas do t’i shndërroni ato në synime. Mirëpo, nuk ka dobi nga synimet nëse nuk përfitoni prej tyre që t’i ndryshoni rrethanat jetësore, dhe nëse ato nuk ju orientojnë në drejtimin e duhur, i cili ju sjell dobi në këtë botë dhe atë të ardhmen. Ashtu siç na mëson edhe Zoti i Gjithësisë në Librin e Tij: **“Kjo është rruga Ime e drejtë; prandaj ndiqeni e mos shkoni rrugëve të tjera, që t’ju shmangin nga rruga e Tij. Kjo është ajo që ju porositi Ai për t’ju ruajtur nga të këqijat.”** Duhet pasur parasysh se bazë për çdo vepër që bëjmë në këtë botë është adhurimi dhe respektimi i Allahut: **“Por përpiqu me atë që të ka dhënë Allahu të fitosh jetën e botës së ardhshme, duke mos harruar pjesën tënde në këtë botë.”**

Mos e lër veten në mëshirë të erës

Shumica e njerëzve nuk arrin të kuptojnë rëndësinë e përcaktimit të synimeve, duke e lënë jetën e tyre ta udhëheqin të tjerët, ashtu sikurse pupla në ajër të cilën e çon era nga të dojë.

Nëse i vini vetes synime, atëherë:

- Dilni nga errësira në rrugën e ndritshme
- Në vend që t’i lini ditët e jetës të humbasin, duke u bërë pre’ e rastësisë dhe spontanitetit, me lejen e Zotit, ju do të dirigjoni rrjedhën e jetës.

- Akordoni fjalët me veprat, duke realizuar atë që dëshironi e po ashtu duke arritur atë që shpresoni.

- Largohuni nga gjërat e parëndësishme dhe preokupohuni me ato që janë çështje madhore.

- Bëhuni të kënaqur me veten dhe të

“...Në fjalët e këqija nuk ka asgjë të mirë, ndërsa fjala e mirë, sado që të jetë e mirë është larg një veprimi të mirë...”

tjerët duhet t’i pranoni ashtu siç janë.

- Përfitoni përkrahjen e të tjerëve dhe bëhuni shembull për ta.

Mos u merr me ëndërrimtarët

Ajo çfarë i pengon disa njerëz në përcaktimin e synimeve të tyre është ikja nga kritika e të tjerëve, para se të marrë ndryshimi praktik pozitën vet. Duhet të jeni të gatshëm t’i mbartni përgjegjësitë e një fillimi të ri dhe t’i përshtatni vendimet dhe veprimet tuaja të këtij ndryshimi. Tani ju jeni të vetmit ata që vendosni për jetën tuaj, nuk do të keni mundësi të kënaqeni me sukseset tuaja të ardhshme, nëse luani rolin e viktimës, duke u mjaftuar me dorëzimin e situatës.

Njerëzit e suksesshëm i marrin vendimet e tyre shpejt dhe i ndryshojnë ngadalë, ndërsa ata të dështuarit i marrin vendimet ngadalë dhe i ndryshojnë shumë shpejt.

Kemi dy lloj njerëzish

Njëri lloj angazhohet, prodhon dhe arrin sukses pas suksesi, ndërsa lloji tjetër e vendos tërë veprimtarinë e vet vetëm mbi fjalë, duke përmendur gabimet dhe duke i kritikuar të suksesshmit. Ekziston një dallim i madh në mes të dy angazhimeve dhe të dy rezultateve. Në fjalët e këqija nuk ka asgjë të mirë, ndërsa fjala e mirë, sado që të jetë e mirë është larg një veprimi të mirë.

Ju duhet të kujtoni vazhdimisht, se kënaqësia më e madhe është ajo që ndjejmë

kur i realizojmë gjërat për të cilat të tjerët shpresojnë se nuk do t'i bëjmë. Është mirë që të këshillohesh me ata që i vlerësojnë hapat tuaj dhe ua dinë vlerën, me kusht që nëse ju u besoni këshillave të tyre dhe ata ua dëshirojnë të mirën. Mundohu të përfitosh nga këshillat e tyre, sepse ata që pranojnë këshilla janë të shumtë, ndërsa ata që me të vërtetë përfitojnë prej tyre për fat të keq janë të paktë.

Kur të vendosni për diçka, atëherë mbështetuni tek Allahu dhe praktikoni udhëzimet e të Dërguarit.

Çështja meriton rrezik

Ekziston një faktor i rëndësishëm që është pengesë në përcaktimin e synimeve dhe ai është frika nga dështimi. Shtrohet pyetja, kush është ai që nuk gabon? A nuk e di se e gjithë ajo që veprojmë në këtë botë është e ndërtuar vetëm në gjasat dhe në rrezik.

Është e rëndësishme të dini se aftësia juaj për të marrë vendimet e duhura do të përmirësohet me kohë, zell dhe përkushtim.

Nuk është fatkeqësi kur gabon, por e rëndësishme është të mësosh nga gabimet e tua, që ta ndërtosh përvojën tënde.

Përcaktoji synimet e tua me saktësi:

Që synimet tuaja të jenë të sakta duhet të praktikosh 5 standarde, ose përndryshe do të jenë vetëm iluzione. Synimi duhet të jetë:

- 1- Konkret
- 2- I mundshëm për t'u realizuar
- 3- I përcaktuar me afat.
- 4- Fleksibël
- 5- Të jetë në gjendje që të matet.

Nëse thua: "Dëshiroj të jem fetar i mirë" duhet të dish, se fetaria në Librin e Allahut dhe në Sunetin e të Dërguarit është synim i madh. Mirëpo është aq synim i ekzagjeruar dhe i përgjithshëm, saqë nuk ka mundësi të matet. Për këtë arsye për ta realizuar këtë

synim duhet ta ndani në synime më të vogla e të imta, që mund të maten dhe që bashkërisht përbëjnë këtë synim të madh. Le të marrim p.sh. mësimin e Kuranit përmendsh, i cili i përmbush kushtet për të qenë synim, i cili e plotëson fetarinë e kërkuar dhe njëkohësisht i përmbush 5 kriteret e lartpërmendura. Memorizimi i Kuranit është synim konkret dhe i mundshëm për t'u realizuar. Nëse e përcakton kohën e memorizimit, që ajo të jetë brenda dy viteve, atëherë të mundësohet njëkohësisht matja e përparimit dhe e ngecjes, e po ashtu edhe e afrimit dhe e largimit nga ky synim. Gjithashtu ky synim është fleksibël dhe në të cilin ke mundësi të shpejtosh dhe të ngadalësosh varësisht nga mundësitë dhe rrethanat.

Shembull tjetër është: **"Dëshiroj të bëhem dijetar"**.

Ky nuk konsiderohet synim, por është vetëm një iluzion, që nuk përshtatet me kriteret e lartpërmendura. Për këtë shkak patjetër të duhet një mekanizëm tjetër, që do ta shndërrojë iluzionin në synim dhe kështu që të arrihet ai, duke u shërbyer me pesë kriteret tona. E para është dija, dëshiroj të marr diplomën e doktoraturës nga filan universiteti në katedrën e ekonomisë islame përgjatë 6 vjetëve, këtu i ke përcaktuar vetes një synim, i cili ka mundësi të matet. Kështu nëse arrin ta marrësh diplomën, e ke lidhur veten me një afat të caktuar dhe të arsyeshëm, që ka mundësi të realizohet gjatë kësaj kohe.

Dhe shembulli i fundit: **"Dëshiroj të bëhem i pasur"**. Kjo gjithashtu nuk konsiderohet synim. Për t'u shndërruar ky iluzion në synim duhet të thuash: "Dëshiroj të zotëroj një firmë të pasurive të patundshme dhe për pesë vite do të fitoj një milion euro. Këtu i ke përcaktuar vetes një objektiv që ka mundësi ta realizosh, i është caktuar afati etj..."

Idetë tuaja janë të mira dhe mos lejo të fluturojnë në ajër

Kur të përfundoni përcaktimin e synimeve tuaja në mënyrë të prerë shkruajini ato në letër dhe kurrseji mos lejoni që të fluturojnë në ajër. Synimet e shkruara janë shumë më afër dorës se sa ato që i lë. Mbage letrën gjithmonë në xhep dhe mos ngurro ta përmirësosh dhe ta kontrollosh vazhdimisht. Kjo do të bëjë që t'i përmbaheni asaj sa më shumë, kur i keni ato gjithmonë para vetes. Kur synimet i keni të kristalizuara në mendje do të përfitoni shumë në kohë dhe do të jeni të shpejtë në realizimin e tyre.

Përqendroje shikimin tënd te shpërblimi

A keni mundësi të ecni mbi një urë me trashësi 2 metra, nëse ajo është e ngritur nga toka një metër? Sigurisht se mundeni. Mirëpo si do të ishte puna nëse kjo urë të vendosej ndërmjet dy ndërtesave dhjetëkatëshe? Kësaj radhe mund ta ndryshoni përgjigjen e të thoni: "jo". Pse ndodh ky ndryshim kur kemi të bëjmë me të njëjtën urë? Dallimi është se kur ura ishte e ngritur në lartësi prej një metër nga sipërfaqja e tokës, kur do të ecni e shikoni fundin e rrugëtimit, ndërsa kur është e ngritur në katin e dhjetë, atëherë shikimin do ta përqendroni poshtë në drejtim të tokës, për këtë arsye nuk mund të ecni.

Ajo që dëshirojmë të themi me këto fjalë është se njerëzit e suksesshëm e përqendrojnë shikimin e tyre tek arritja (shpërblimi), të cilin do ta fitojnë kur do t'i realizojnë synimet e tyre, ndërsa dështakët nuk e ngrenë kokën dhe shikojnë gjithmonë poshtë përtokë nga frika e dështimit. ■

PREZANTIM I LIBRIT:

“DITA E HIDHËRIMIT”

TË AUTORIT: DR. SEFER EL HAVALI



2012 FUNDI I IZRAELIT?

Ky libër përmban përgëzime për ato njerëz të shtypur në tokën e pushtuar të Palestinës dhe për mbarë muslimanët. Mirëpo, nuk është shkruar për të dhënë përgëzime, sepse Kurani dhe Suneti janë plot me përgëzime, kurse burime të tjera kanë kufi dhe rregulla.

SHKRUAN: SEDAT SHABANI

Okupimi i Gazës i këtyre ditëve, zullumi i pamëshirshëm çifut i ndihmuar nga ushtria e egër e shtetit hebre, ku me aeroplanë dhe tanke mbillnin gjak, frikë, tmerr edhe tek fëmijët e pafajshëm. Edhe njëherë u përsërit historia, edhe njëherë u vërtetuan ajetet kuranore, që na tregojnë për këtë popull zullumqar, popull narcizist, i cili nga interesat e ngushta materiale dhe botërore mori guximin dhe ndërroi Teuratin, por nuk u ndalën vetëm me këtë gjë, ata mbytën e masakruan më të zgjedhurit e tyre dhe Pejgambëret tanë, vetëm e vetëm se ata u tregonin atyre rrugën e shëndoshë dhe i thërrisnin në besimin e drejtë, për çka edhe Allahu i dënoi disa herë në tokë, duke i shndërruar në derra e majmunë. Prapë se prapë ata vazhduan edhe do të vazhdojnë deri në Afatin, të cilin Allahu ua ka caktuar, ku edhe guri dhe druri do t'i tregojë muslimanit: *“Eja, eja, o musliman, se mbrapa meje fshihet çifuti...”*

Lidhur me këto shejhu i mirënjohur nga Meka, dr. Sefer Havali bëri një punim të thuktë, ku me mjeshtërinë e dijes dhe largpamësinë, që i ka dhuruar Allahu këtij shehu ka bërë analizën e ideologjisë sioniste dhe asaj perëndimore amerikane, duke gërshetuar informacionet që i ka marrë nga burimet e tyre Tora (Teurati) e sotme dhe libra të ashtuquajtura përgëzuese. Të gjithë këto shejhu i përmend dhe u jep përgjigje. Shpeshherë edhe i këshillon dhe kërkon

nga hebrejtë t'i kthehen rrugës së drejtë, shpesh ua kthen përgjigjen me cinizëm për marrëzitë, që dora e tyre i ka thurur... E gjithë kjo e bën këtë libërth të qëlluar për lexuesin e rëndomtë, po edhe për studiuesit e posaçërisht politikanët, që të jenë syçelë në analizat e tyre për çështjen thelbësore të botës së sotme: Lindjen e Mesme dhe problemin palestinez.

Ky libër përmban përgëzime për ato njerëz të shtypur në tokën e pushtuar të Palestinës dhe për mbarë muslimanët. Mirëpo, nuk është shkruar për të dhënë përgëzime, sepse Kurani dhe Suneti janë plot me përgëzime, kurse burime të tjera kanë kufi dhe rregulla. Prandaj duhet ditur, se përmbajtja e librit nuk themelon çështje të besimit për muslimanët, siç mund ta kuptojnë disa lexues, qofshin ithtarë të Librit ose muslimanë, por është shkruar për të përvijuar metodën e përqaqjes ndaj parimeve ideologjike të armikut të përbetuar të njerëzimit: “Sionizmit”, me dy fytyrat e tij, atë çifute dhe fundamentaliste krishtere”. Ky armiku që e ka angazhuar botën dhe e ka mbushur hapësirën dhe letrat me fjalime rreth paralajmërimeve biblike, sidomos pas kësaj intifade të fundit.

Studimi i paralajmërimeve duhet të bëhet lëndë hulumtimi e studimit në të ardhmen. Mirëpo paralajmërimet janë sikurse edhe mendimet, disa prej tyre janë të shëndosha, disa prej tyre janë të rrejshme, prandaj është e drejtë e lexuesit të përbotshëm, që të lexojë edhe mendimin tjetër në këtë temë shumë të rrezikshme, kurse e drejta e lexuesit musliman është të kërkojë thirrje rezervë

në këtë betejë të gjatë dhe të egër. Thirrje rezervë është studimi konstruktiv i bazave akaidologjike të armikut, i psikologjisë dhe i sjelljes së tij nën prizmin e burimeve dhe të trashëgimisë së tij, që janë burim i shpirtit psikik dhe besimit ndaj çështjes së vet.

Intifada e muajit Rexhep

Autori në vazhdim përmend intifadën e muajit Rexhep, rasti i hyrjes së kryekriminelit Sharon në oborrin e xhamisë Aksa. Kjo intifadë filloi si shprehje e revoltës nga mosrespektimi i këtij zullumqari të shenjtërive të muslimanëve në këtë vend të bekuar. Autori tregon gjendjen në atë kohë dhe mllëfin që shprehën dijetarët, mendimtarët strategjikë, liderët popullorë, ligjëruesit dhe mbarë populli i thjeshtë, qofshin burra, gra ose fëmijë. Autori citon edhe fjalët e Shejhul Ez'herit, i cili në disa kanale satelitore bërtiti me të madhe: “Me çifutët nuk bën dobi asgjë përveç rregullit: *“dhe luftoni ata kudo që t'i zini...”*” (Bekare 191).

Po ashtu përmend marrëveshjet e Oslos, Madridit, Kamp Dejvidit të dytë dhe dështimet e tyre për të arritur paqen.

Pikëpamja akaidologjike

Metoda më e madhe e shpalosjes është shpallja dhe kjo është e veçantë për Pejgamberët, alejhimu selam. Ëndrrat i vijnë, edhe besimtarit, edhe jobesimtarit, edhe të mirit, edhe mëkatarit. Pastaj vijojejnë mjetet e tjera siç janë inspirimi, largpamësia etj.

Çdo lajm që flet për të ardhmen ka nevojë për dy gjëra:

1. vërtetësinë e lajmit

“Këshilloj çdo çifut që gjendet në tokën tonë të okupuar, që mos t’ua lerë Teuratin monopol rabinëve, të cilët janë të lirë nga shërbimi ushtarak, kurse ata të flijojnë jetën për ta...”

2. komentin e shëndoshë

Ithtarët e librit janë njerëzit që merren më shumë me studimin e historive, betejave dhe ngjarjeve, që do të ndodhin para Ditës së fundit. Edhe një pjesë e mirë e muslimanëve i kanë dhënë rëndësi kësaj teme qysh herët. Disa dijetarë kur flasin rreth transmetimit të hadithit thonë se banorët e Shamit dhe të Egjiptit kanë transmetuar më pak hadithe nga irakianët dhe hixhazitët, sepse ata kanë qenë të angazhuar me studimin e betejave dhe jetëpërshtimeve. Shpërndarja e çifutëve, robërimi dhe shtypja e tyre nga ana e romakëve të krishterë ishte një shkak shumë i madh që i nxiti Ithtarët e Librit të preokupohen me lajmet e shpëtimtarit, duke trilluar paralajmërime dhe duke komentuar të gjithë ato tekste, që aludonin për këtë gjë.

Qëndrimi ynë ndaj paralajmërimeve të Ithtarëve të Librit është:

1. Lajme që janë të kota njëqind për qind, si p.sh. pretendimi se Pejgamberi i

fundit do të jetë me prejardhje nga Davudi dhe Mesihu i premtuar është çifut. Shkurt çdo gjë që është në kundërshtim me Kuranin dhe Sunetin.

2. Lajme, të cilat janë me siguri të vërteta, si p.sh., dalja e Dexhallit, zbritja e Isait alejhi selam, beteja e Armagedonit etj.

3. Lajmet, të cilat as nuk i përgënjeshtrojmë e as nuk i besojmë. *“Mos i besoni ithtarët e Librit e as mos i përgënjeshtroji”* – Buhari.

Mesihu gënjeshtar

Amerika, siç thotë Eduard Saidi, është vendi që merret më shumë me fe. Në Amerikë ka rryma fundamentaliste fetare, fanatike deri në pikë të fundit, që besojnë në kthimin e Mesihut për një kohë shumë të shpejtë dhe janë të gatshëm që për hir të këtij synimi të bëjnë budallallëqe të ndryshme!

Fatkeqësia qëndron në faktin, se ata shtohen dhe nuk pakësohen, nuk kanë logjikë të shëndoshë, por mbështeten në iluzione, ëndrra dhe biseda të drejtuara nga djalli, kurse ata mendojnë se me ata është shpirti i shenjtë, madje një numër shumë i madh i tyre pretendon se është Mesihu, ose ai është mishëruar në atë person, ose i ka folur.

Prej besimeve të tyre është:

1. Themelimi i shtetit Izraelit, që është domosdoshmëri për zbritjen e Mesihut.

2. Procesi i paqes është vonim i premtimit të Zotit.

3. Kudsi (Jerusalemi) i tëri duhet të jetë nën pushtimin izraelit.

4. Izraeli është i bekuar dhe është i bekuar ai që e bekon dhe është i mallkuar

ai që e mallkon.

5. Palestinezët në veçanti, muslimanët në përgjithësi janë barinj, idhujtarë dhe parti e Jexhuxhit dhe e Mexhuxhit.

6. Njëmijë vjetori i lumtur do të vijë së shpejti, pas pritjes së besimtarëve për të takuar Zotin, kur do të zbresë dhe kur do të shkatërrohen të gjithë idhujtarët në betejën e Armagedonit (Hermexhdunit).

Këta njerëz nuk janë një grup i izoluar murgjish, siç kanë qenë në shekujt e parë, por këta janë njerëz që punojnë në vende të ndjeshme me ndikim të madh shoqëror, kanë makineri gjigante mediatike dhe poste të larta në qeveri. Profetizime nga Teurati, magjia, astrologjia dhe spiritualizmi janë ritet e tyre kryesore, dhe në bazë të tyre i ngrejnë teoritë e tyre në politikë e shoqëri, dhe në raportet e tyre me mbarë njerëzimin.

2012 Dita e Hidhërimit

Autori në vazhdim shtjellon në detaje platformën dhe ideologjinë e këtyre misionarëve duke u bazuar në librat, fjalimet dhe veprimet e tyre në rrafshin politik dhe atij ushtarak. E si përfundim nga “matematika” e shifrave të përmendura në dokumentet dhe librat e tyre veçon paralajmërimin e ardhjes së Ditës së Hidhërimit të Zotit dhe kur do ta shkatërrojë Allahu turpin shkatërrues, kur do të shpartallohen prangat e Kudsit dhe do t’i kthehen të drejtat e tij?

Përgjigja e kësaj pyetje është dhënë në vetë përmbajtjen e këtij libri. **Danieli** është një prej pejgamberëve të izraelitëve dhe në Bibël ka një libër të veçantë me emrin e tij, i cili dallohet nga përputhja e profecive të këtij libri me realitetin historik. Përmbajtja e profecive

të këtij libri, numra të caktuara, të cilët u bën bosht i studimit dhe i polemikave gjatë tërë historisë. Vetë Danieli i përngjan shumë Jusufit alejhi selam meqë është i huaj, i shtypur mirëpo Allahu e ngriti me dituri dhe aftësi për komentimin e ëndrrave. Danieli përcaktoi kohën mes vështirësisë dhe rrugëdaljes, mes epokës së ngushticës dhe epokës së mirëqenies dyzetepesë vjet! Sipas tij ngritja e shtetit të turpfit është viti 1967, gjë e cila edhe ka ndodhur. Në bazë të kësaj, fundi ose fillimi i fundit do të jetë:

1967+45=2012 ose sipas kalendarit të Hixhrit 1387+45=1433.

Shejh Sefer Havalı thotë: Ne shpresojmë se kjo gjë do të ndodhi në këtë vit, mirëpo nuk jemi kategorikë në këtë vlerësim, me përjashtim të rastit nëse përputhet me realitetin. Mirëpo po qe se fundamentalistët (çifutë dhe të tjerë) vendosin me ne një bast, ashtu siç vendosën kurejshitet me Ebu Bekrin r.a. rreth çështjes së romakëve, sigurisht dhe pa asnjë dyshim do të humbin!!!

Shejhu këshillon: nëse drejtësia e çështjes është thelbi i moralit të luftëtarit, atëherë duhet ditur se Teurati jo vetëm që tregon se çështja e ushtarit sionist nuk është e drejtë, por ajo madje tregon se obligimi i tij është të luftojë në anën e kundërt, pikërisht sikurse e detyron kolonialistin të dijë se hyrja e tij në këtë vend është për të ardhur momenti për zbritjen e dënimit të Zotit dhe zbritjen e mllefrit të Tij. Prandaj së paku le të shpërngulet! Edhe pse ne kemi më shumë dëshirë, që të udhëzohet me dritën e Zotit dhe të bëhet vëlla i yni në Islam, i cili është mileti i Ibrahimit alejhi selam dhe të na shoqërojë në dhuntinë e besimit, në të gjitha Librat dhe

Pejgamberët e Allahut pa kurrfarë dallimi.

Ata nuk duhet të presin Ditën e Hidhërimit, që të shpërngulen ose të besojnë, se ndoshta u kalon shansi i madh para kësaj ose gjatë kësaj dite.

Këshilloj çdo çifut që gjendet në tokën tonë të okupuar, që mos t'ua lerë Teuratin monopol rabinëve, të cilët janë të lirë nga shërbimi ushtarak, kurse ata të flijojnë jetën për ta. I këshilloj këta njerëz, që ta lexojnë me mendjen dhe perceptimin e vet, e jo me komentet dhe sqarimet e rabinëve, sepse vetëm atëherë do ta shohin të vërtetën, të cilën e mbarë bota do ta shohë shumë afër!

Le ta dijë ky njeri se sado që na sulmon, na i mbyt fëmijët, na i djeg arat, na e shkatërron jetën, ne do të sillemi me të, ashtu siç na mëson feja e Allahut, e jo sipas dëshirave tona, kurse atij dhe njerëzimit në përgjithësi i uroj të fitojë kënaqësinë e Allahut dhe lumturi në dynja e ahiret. Kurse llogaria e plotë dhe hakmarrja e drejtë do të ndodhë në Ditën e Kiametit, kur do të dalim para Allahut, që do të na llogarisë të gjithë neve për punët tona, qofshin të mira ose të këqija, e në këtë ditë nuk të bën dobi pretendimi:

“Nuk është (shpëtim) sipas shpresave tuaja e as sipas shpresave të ithtarëve të Librit (krishterë dhe hebre). Kushdo që bën keq do të ndëshkohet me të dhe pos Allahut nuk ka për të gjetur, as mbrojtës, as ndihmës”. (Nisa: 12).

Kjo është fjala e drejtë, së cilës i përmbahet pala jonë dhe shpresojmë që edhe pala tjetër do të ketë guxim që t'i përmbahet, ose së paku të përpiqet... ■

FËMIJËT TANË DHE ËNDRRAT PËR FITOREN E GAZËS

Pastaj fillova të mendoj, a është kjo gjë pozitive për fëmijët apo negative. A duhet që fëmijët tanë të mendojnë rreth lojërave e kënaqësive të kësaj bote, apo kush është më e mira për çështjen e Palestinës

SUMEJA RAMADAN

Para një jave na erdhi dhuratë një gotë me ujë Zemzemi. Çdonjëri nga ne pinte nga ai ujë dhe bënim dua atë që dëshironte, përveç bijës sime dhjetëvjeçare Sara, e cila nuk po bënte dua dhe po mendohej se për çfarë të lutej.

Çdo ditë ajo vjen tek unë dhe bisedon me mua për gjërat që shpreson t'i ketë gjatë jetës së saj. Ajo dëshiron që të ketë një pallat të madh, një park të mbushur me lojëra të ndryshme, të ketë aty një pishinë të mbushur me lojëra uji. Nganjëherë më drejtohet mua duke më thënë: Dëshiroj të kem një veturë të re dhe t'ia dhuroj babait tim, e t'ia zëvendësoj me veturën e vjetër që ka ai. Dua të kem edhe një vitrinë e aty të jenë treqind fustane, që çdo ditë të vesh nga një fustan të ri, si dhe të kem një shportë të mbushur me çokollata e karamele.

Ky interval zgjati plot pesë ditë. Ajo gjithnjë mendohej se për çfarë të lutet. Këtë lutje ne e pritnim nga ajo duke bërë shaka.

Dje në mëngjes u zgjua që të dalë e të luaj me shoqet e saj. Në fund të shkallëve të banesës dëgjonim një lutje nga ajo, duke thënë: **O zot ndihmoje Palestinën, o Zot ndihmoje Gazën, o zot ktheja Palestinën prapë muslimanëve.** Të gjithë fëmijët e

përsëritnin këtë dua dhe çdonjëri prej tyre pinte ujë Zemzemi.

Duke e parë këtë skenë filluan të më pikojnë lotët, por nuk e dija nëse ishin lot dhimbje për Palestinën, apo ishin nga gëzimi që po dëgjoj fëmijët duke bërë këtë dua.

Sara, një vajzë kaq e vogël, që ëndrra e saj e zakonshme është të ketë çokollata, fustane e lojëra të ndryshme u shndërrua me ëndrrën e Mesxhidul Aksasë. O Zot! Fëmija im ka ëndrrën e umetit. I thirra fëmijët dhe u shpreha atyre falënderimin tim për lutjen që bënë. Papritmas njëri më tha:

- E çfarë mund të bëj pos lutjes? -I thashë:

- Respektoji prindërit e mësuesin dhe është ndihmë për vëllezërit tanë në Palestinë, përsëriti mësimet në shkollë është ndihmë për vëllezërit tanë në Gaza, mëso çdo ditë diçka të re është ndihmë për vëllezërit tanë në Palestinë dhe Gaza, lexo dhe mëso Kuran është ndihmë për vëllezërit tanë në Palestinë dhe informoi shokët e tu, se çfarë po ndodh në Gaza. -Njëri nga ata ma ndërpreu fjalën duke më pyetur, se çfarë ka të bëjë mësimi i Kuranit me ndihmën?! I thash:

- A e njuh Salahudin Ejubin? -Ai më tha:

- Po, trimi i Hitinit. I thashë:

- Ai ecte nëpër çadrat e ushtarëve dhe

“... M’u kujtua edhe rasti i Muadhit dhe Meudhit radijallahu anhuma, që të dy fëmijë që e vranë Ebu Xhehlin në betejë...”

kur dëgjonte diku duke lexuar Kuran thoshte: Prej këtu fillon fitorja. Ne dëshirojmë që ju ta mësoni Kuranin dhe ta bëni atë program të jetës suaj, ju jeni shëmbëlltyra e umetit në dorë të të cilit do të jetë fitorja dhe krenaria, inshAllah.

Përnjëherë hyra brenda e emocionuar nga fjalët e fëmijëve dhe fillova të mendoj se si këta fëmijë të vegjël mbajnë një dert të madh, i cili është dert i umetit.

Pastaj fillova të mendoj, a është kjo gjë pozitive për fëmijët apo negative. A duhet që fëmijët tanë të mendojnë rreth lojërave e kënaqësive të kësaj bote, apo kush është më e mira për çështjen e Palestinës, gjë e cila i preokupon shumë fëmijët. Të gjithë këto ide më detyruan që të mendoj për historinë e kaluar të këtij umeti. M’u kujtua sakrifica e Aliut radijallahu anhu, kur e zëvendësoi Muhamedin salallahu alejhi ue selem në shtrat në çastin kur ai vendosi të shpërngulej për në Medine. M’u kujtua edhe rasti i Muadhit dhe Meudhit radijallahu anhuma, që të dy fëmijë që e vranë Ebu Xhehlin në betejë. M’u kujtua edhe rasti i Usame b. Zejdit që ishte komandant ushtarak, ku mosha e tij nuk i ishte kaluar të gjashtëmbëdhjetat. Ndërsa ndër ushtarët e tij ishte Ebu Bekri, Omeri si dhe shumë sahabë të mëdhenj radijallahu anhum. M’u kujtuan edhe Salahudin Ejubi radijallahu anhu dhe Muhamed Fatihu e shumë të tjerë.

Vallë! Me çfarë fryme u edukuan ata. A thua edukimi i tyre kishte kahje negative



dhe nuk u interesonte atyre asgjë, apo ata edukoheshin me frymën e shpresës dhe krenarisë qysh në fëmijëri. Këto njerëz janë rritur me frymën e besimit, krenarisë dhe sakrificës.

M'u kujtuan nënat që i lindën dhe i edukuan ata. Mos të kishin qenë këto nëna të edukuara, nuk do të dilnin këta persona të kësaj kategorie. Një poet thotë:

Nëna është një shkollë, kur e përgatit atë ke përgatitur një popull me vlerë.

Nga kjo mund të kuptojmë se nëna është ajo që përgatit breza të shëndoshë, të cilët shpresojnë dhe kanë ambicie për një të ardhme të shëndoshë. Kjo arrihet me edukim të shëndoshë, bazë e të cilit është shëmbëlltyra praktike. Pra, çdonjëri nga ne është i detyruar që të fillojë nga shtëpia e vet, duke mbjellë harmoni, dashuri dhe ndihmë të ndërsjellë mes anëtarëve të shtëpisë, që të krijohet një shtëpi me baza të shëndosha besimi dhe ky edukim të përcillet në brezat e ardhshëm, sepse gruaja është pjesë përbërëse e shoqërisë dhe elementi kyç i ndërtimit të shoqërisë.

Fitorja do të vijë. Nuk ka dyshim në te. Këtë shpresë na e jep i Dërguari i Allahut subhanehu ue teala kur thotë: *“Nuk do të bëhet Kiameti derisa muslimanët t'i mbysin çifutët dhe me ne do të luftojë guri dhe druri.”* Por për të qenë kjo ndihmë e pranishme duhet të marrim parasysh edhe shkaqet. Duke e mbjellë besimin në zemrat e fëmijëve dhe duke ua bërë me dije se besimtari i fortë është më i mirë tek Allahu se sa besimtari i dobët. Ne duhet t'ua bëjmë me dije, se fitorja arrihet duke qenë i përgatitur në sferën e zhvillimit, arsimit, teknologjisë e kështu me radhë.

Dikush mund të pyesë, se si mund t'i bëjmë të gjithë këto përgatitje.

Nuk është e pamundur. Është fakt se ka vështirësi, por kjo gjë kërkon një angazhim

dhe durim të madh.

Atëherë...

1- Kuran... Kuran... me atë rregullohet kjo dhe ajo botë.

2- Bëhuni shëmbëlltyrë praktike për fëmijët tuaj, sepse vepra e një njeriu ndërmjet njëmijë njerëzve është më e mirë se fjalët e njëmijë njerëzve tek një njeri.

3- Mësojini fëmijët që në fëmijëri të marrin ndonjë përgjegjësi në shtëpi, edhe nëse ajo është e vogël. Kjo gjë do t'i ndihmojë ata në të ardhmen.

4- Mësojini fëmijët që ta duan diturinë, sepse nuk përparohet me injorancë dhe prapambetje.

5- Mësojini fëmijët tuaj që të jenë pranë nevojtarëve në raste nevojë dhe të përzihen me njerëzit në gazmende e pikëllime, që ta dinë se çfarë haku i kanë të tjerëve.

6- Sqaroni fëmijët për disa çështje të nevojshme në jetën e tyre me një metodologji, e cila i përshtatet moshës së tyre.

7- Mësojini fëmijët tuaj, që mendimet e tyre mos t'i shprehin duke thyer apo duke shkatërruar diçka. Por ta paraqesin mendimin e tyre me zgjuarsi dhe pa dëmtuar dikë.

8- Kërkoni nga fëmijët tuaj, që në aktivitetet e tyre shkollorë ta kenë parasysh sa më shumë çështjen e Palestinës.

9- Caktoni një interval kohor për çdo ditë, që të tuboheni me fëmijët tuaj dhe të luteni për popullin e Palestinës.

10- Ndërtoni një kuti dhe titullojeni atë “Për Palestinën”, ku secili anëtar i familjes le të fusë ndonjë para dhe në fund të muajit hapeni dhe ato të holla dërgojini për në Palestinë. ■

Përktheu: Enver Azizi

A JAM I SJELLSHËM NDAJ PRINDËRVE?!

kujdes nga hidhërimi i nënave, sepse kënaqësia e Allahut është me kënaqësinë e prindërve, babait e nënës, ndërsa hidhërimi i Tij është me hidhërimin e tyre.

SHKRUAN: RESHAT IBISHI

Prindërit janë shkaktarë për ardhjen tonë në këtë botë. Ata gjithnjë kujdesen për ne, bile edhe atëherë kur rritemi dhe bëhemi të pavarur prej tyre. Fëmijët janë brenga dhe kënaqësia më e madhe për prindërit! Babai punon tërë jetën që fëmijëve të vet t'ua sigurojë ushqimin, veshjen, mjetet materiale dhe çdo gjë që u nevojitet. Nëna gjithnjë ka qëndruar pranë nesh, kur kemi qenë foshnje na ka ofruar përkujdesjen më të madhe, ndërsa kur u rritëm çdo sukses dhe gëzim yni e ka bërë atë të lumtur!

Gjykimi për shkallën e të mirës dhe shkëlqyeshmërinë e sjelljes i takon një peshoreje, e cila nuk gabon asnjëherë, e ato janë: vlerat morale të larta. Në këtë kontekst përcillet se një njeri i ka thënë Pejgamberit salAllahu alejhi ue selem,: “Filania përmendet se falet shumë, agjëron dhe jep lëmoshë, mirëpo ajo i dëmton me fjalë fqinjët e saj.” Pejgamberi salAllahu alejhi ue selem, tha: “Ajo është në zjarr.” Pastaj njeriu tha: “O Pejgamber i Allahut, filania përmendet se falet pak, agjëron dhe jep lëmoshë disa copa djathi, por nuk i dëmton fqinjët e saj.” Ai tha: “Ajo është në Xhenet.” E përcjell Ahmedi.



Ndoshta edhe fëmija i vogël mund t'i imitojë veprimet e namazit dhe përsërit fjalët që thuhet në të. Ndoshta edhe një artist mund të ekspozojë nënshtrimin dhe të aktrojë ceremonitë më të rëndësishme, mirëpo as kjo e as ajo e para nuk e ndihmojnë me asgjë besimin e shëndoshë dhe qëllimet fisnike.

Më poshtë do të përmendim vlerën e një pjese përbërëse të karakterit dhe vlerave të larta islame, e cila është mirësjellja ndaj familjes e sidomos ndaj prindërve, të cilët janë ata që kanë qenë shkaktarë kryesor i ardhjes sonë në këtë botë.

Përcillet se në kohën e Muhamedit salAllahu alejhi ue selem, një i ri, i cili quhej Alkame u sëmur dhe iu rëndua sëmurdja. Ai

ishte në prag të vdekjes prandaj i thanë atij: thuaj La ilahe il-la Allah, por gjuha e tij nuk e shqiptonte dot këtë fjali. Kur u informua për këtë rast Muhamedi salAllahu alejhi ue selem, tha: *A i ka prindërit gjallë?* Thanë (shokët tij): Babai i ka vdekur, ndërsa nënën e ka ende gjallë, por është e shtyrë në moshë. Muhamedi salAllahu alejhi ue selem, dha urdhër, që t'ia sjellin aty nënën e Alkames! Ajo erdhi. Muhamedi salAllahu alejhi ue selem, e pyeti rreth gjendjes së të birit të saj. Plaka (nëna e Alkames) i tha: Falej kaq e kaq, agjëronte kaq e kaq, jepte sadaka kaq e kaq dhe unë nuk e dija sa është pesha e as numri (sasia) i tyre. Muhamedi salAllahu alejhi ue selem, e pyeti: *si është gjendja (raportet) ndërmjet teje dhe atij?* Unë, -thotë plaka (nëna e Alkames) jam e hidhëruar me të. Muhamedi salAllahu alejhi ue selem, i tha asaj: *Vetëm kaq?* Plaka i tha: Ai e favorizonte gruan e tij ndaj meje. Muhamedi salAllahu alejhi ue selem, i tha: *Vërtet hidhërimi i nënës së tij ndaj tij ka bërë që t'i bllokohet gjuha për shqiptimin e shehadetit.* Pastaj Muhamedi salAllahu alejhi ue selem, e urdhëroi Bilalin: *Shko e mbli dh një tufë drush, që ta djegim në zjarr.* Nëna tha: O i Dërguar i Allahut, ai është biri im, fryt i zemrës sime e të digjet në zjarr para syve të mi? Si e lejon zemra ime këtë? Muhamedi salAllahu alejhi ue selem, i tha: *Nëse dëshiron të gëzosh që Allahu t'ia falë mëkatin, pajtohu me të, se pasha Atë, në dorën e Kujt është shpirti im, nuk do t'i bëjë dobi namazi, sadakaja e agjërimi askujt, deri sa nëna është e hidhëruar me birin ose bijën e saj.* Ngriti plaka dorën e saj e tha: E kam dëshmitar Allahun, të kam dëshmitar ty, o Resulullah salAllahu alejhi ue selem, dhe i kam dëshmitar të gjithë këta që janë të pranishëm, se unë jam i kënaqur me të. Muhamedi alejhi selam i tha: *O Bilal, nisu të shohësh se a po e shqipton Alkameja shehadetin, sepse nëna e tij nga turpi prej*

meje ndoshta ka folur atë që nuk e ndien me zemër. Bilali shkoi dhe kur arriti tek dera dëgjoi zërin e Alkames duke thënë: La ilahe il-la Allah. Alkameja vdiq. Muhamedi salAllahu alejhi ue selem, dha urdhër t'ia përgatisin xhenazen dhe ta qefinosin. Pastaj ia fali xhenazen dhe e varrosi. Pas varrimit ai i mbajti një fjalim muslimanëve dhe i porositi që të kenë kujdes nga hidhërimi i nënave, sepse kënaqësia e Allahut është me kënaqësinë e prindërve, babait e nënës, ndërsa hidhërimi i Tij është me hidhërimin e tyre.

Allahu i Madhërishëm në Kuranin Famëlartë thotë: ***“Ne e kemi porositur njeriun që të sillet mirë ndaj prindërve të vet!”*** (Kuran, 29: 8). Po ashtu Allahu i Lartësuar në Kuran thotë: ***“Zoti yt ka përcaktuar që të mos adhuronit tjetër përveç Atij dhe të silleni mirë me prindërit! Nëse njëri prej tyre ose të dy përjetojnë pleqëri te ti, mos u thuaj “of” e as mos u fol me zë të lartë, por drejtoju me fjalë respekti të plotë. Shtriji përpara tyre krahët e përuljes dhe thuaj: “O Zoti im! Ki mëshirë ndaj tyre, siç kanë pasur kujdes ata ndaj meje në vegjëli!”*** Kuran, 17: 23-24.

Një as'hab i quajtur Burejde përcjell se: “Erdhi dikush te Muhamedi salAllahu alejhi ue selem, dhe e pyeti: “O i Dërguari i Zotit, unë e kam mbajtur në qafë nënën time katër kilometra nëpër zall të nxehtë, ku piqet mishi, a i kam dalë borxhit me këtë?”, ndërsa Pejgamberi salAllahu alejhi ue selem, ia ktheu: *“Ndoshta me këtë ti ke treguar vetëm kujdesin më të thjeshtë (e jo t'i dalësh hakut)!”. Për ata që nuk kujdesen për prindërit dhe nuk e kanë fituar Xhenetin me anë të prindërve, Pejgamberi alejhi selam në një hadith ka thënë: “I përbuzur është, i përbuzur është, i përbuzur është ai që e arrin pleqërinë e njërit apo të dy prindërve të tij dhe nuk arrin ta fitojë xhenetin!”* (E përcjell Muslimi).

“...Me sjelljen tonë të mirë ndaj prindërve do të meritojmë që edhe fëmijët tanë të sillen mirë ndaj neve...”

Nga kjo që përmendëm, duam të përkujtojmë se muslimani ndaj njerëzve, individi ndaj Allahut të Madhëruar, fëmija ndaj prindit, të gjithë këta kanë detyra ndaj njëri-tjetrit e më poshtë do t'i përmendim shkurt disa prej detyrave tona ndaj prindërve:

- Të mos i thërrasim ata me emrat e tyre, por me “Babë, Nënë”, madje edhe nëse janë jobesimtarë. Ibrahim i alejhi selam e thërriste babanë e tij kështu: **“O babai im, pse adhuron atë që, as nuk dëgjon, as nuk sheh...”**. (Merjem 42)

- Duhet t'i respektojmë përherë, përveç kur na urdhërojnë të shkelim ligjet e Allahut: **“Nuk respektohet krijesa për t'i bërë mëkat Krijuesit”**. (Sahihul Xhami - 7520)

- Duhet të jemi bamirës ndaj tyre. Allahu i Madhërishëm thotë: **“Ne e urdhëruam njeriun t'u bëjë mirë prindërve të vet...”**. (Ahkaf 15)

- Duhet të flasim mirë me ta. Allahu i Madhërishëm thotë: **“...po atyre thuaju fjalë të mira (të buta respektuese)”**. (Isra 23)

- Shpenzimi për ta sidomos në pleqëri, çdoherë që ai të ketë një nevojë duhet fëmija i tij të jetë pranë në plotësimin e kompletimin e kërkesave të tija.

- T'u japim dhurata. Pejgamberi, salallahu alejhi ue selem, thotë **“Shkëmbeni dhurata që të duheni”**. (Sahihul Xhami 3004)

- Mosngritja e zërit në prezencë të tyre. Allahu i Madhërishëm thotë: **“...mos u thuaj atyre as “uf - oh” ...”**. (Isra 23)

- Shërbeju atyre me çfarë të kesh

mundësi. Allahu thotë **“...po në çështjet e jetës së kësaj bote të kesh mirëkuptim ndaj tyre...”**. (Llukman 15)

- Vizita e shpeshtë e tyre, nëse nuk banon me ta, e jo të mendohet që pleqtë t'i dërgojmë nëpër shtëpitë e pleqve.

- Nëse vdesin, të lutemi për ta, të japim sadaka për ta, të zbatojmë porositë e tyre, të mbajmë lidhjet me dashamirët, shokët dhe farefisin e tyre.

- Heshtja dhe dëgjimi me vëmendje kur ata flasin.

- Konsultimi dhe marrja e opinionit të tyre në çështje të rëndësishme.

- Nëse ti sheh diçka të keqe tek ata, le të mos shtyjë dashuria për mohimin e të keqes ta braktisësh urtësinë dhe butësinë në këshillë. Allahu i Madhërishëm thotë: **“... e sikur të ishe i vrazhdë e zemërfortë, ata do shkapërderdheshin prej teje...”**. (Ali Imran 159).

- Shakaja e mirë dhe futja e lumturisë dhe gëzimit në zemrat e tyre është prej formave më të shkëlqyera të respektit ndaj tyre.

- Mosrënia në pesimizëm nga përmirësimi i tyre (nëse janë jobesimtar), por çdoherë mendo mirë për ta dhe lute Allahun e Madhërishëm t'i udhëzojë ata, nëse janë në gjendje mosbesimi.

- Mësimi i çështjeve që iu bëjnë dobi në fe dhe që i afrojnë tek Allahu i Madhërishëm, si: namazi, agjërimi, sadakaja, leximi i Kuranit, etj.

- Mos ha para se të hanë ata, mos ec para tyre dhe mos u ul para se të ulen.

- Mos dil prej shtëpie përveç pasi je bindur, se ata gjatë mungesës sate nuk kanë nevojë për ty.

-Kujdes nga kundërshtimi në gjëra që nuk meritojnë kundërshtim.

Me sjelljen tonë të mirë ndaj prindërve do të meritojmë që edhe fëmijët tanë të sillen mirë ndaj neve. ■

FITORJA E SIGURT ËSHTË PËRKRAHJA E ALLAHUT

(FITORJA NË UHUD DHE FITORJA NË GAZA)

Allahu i Madhërishtëm thotë: *“Asnjë shpirti (njeriu) nuk i takon të vdesë veçse me lejen e Allahut, të shkruar në afatin e caktuar. Kush e dëshiron shpërblimin e kësaj bote, Ne i japim atij prej saj dhe kush dëshiron shpërblimin e botës tjetër, edhe atij do t’ia japim atë, kurse mirënjohësit Ne do t’i shpërblejmë. Sa e sa peygamberë ka pasur, që së bashku me ata kanë luftuar turma të mëdha besimtarësh dhe për atë që i goditi në rrugën e Allahut, ata nuk u dobësuan dhe nuk u përlën. Allahu i do durimtarët. Fjala e tyre nuk ishte tjetër veçse: “Zoti ynë, na i fal mëkatet tona dhe lëshimet në punët tona, na forco këmbët tona (në luftë) dhe ndihmona kundër popullit jobesimtar! Ndaj Allahua dha atyre shpërblimin e kësaj bote dhe shpërblimin më të mirë të botës tjetër. Allahu i do punëmirët. O ju që keni besuar! Nëse u bindeni atyre që nuk kanë besuar, ata do t’ju kthejnë prapa aty ku ishit (në kufër) dhe atëherë do të jeni të humbur. Vetëm Allahu është Mbështetësi juaj dhe Ai është Ndihmësi më i mirë.”* (Ali Imran 145-150).

SHKRUAN: GENC PLUMBI

Ibën Kethiri thotë: “Kur u mundën ata muslimanë që u luftuan në betejën e Bedrit dhe kur u vra kush u vra prej tyre, Shejtani thirri: “Muhamedi u vra”. Kështu Ibën Kemiati u kthye tek idhujtarët dhe u tha: “Unë e vrava Muhamedin.” Në të vërtetë i Dërguari i Allahut kishte marrë një goditje në kokë dhe kishte pësuar një çarje. Kjo i preku shumë njerëzit, sa që një pjesë prej tyre menduan se i Dërguari i Allahut salAllahu alejhi ue selem, ishte vrarë dhe e konsideruan këtë si një dukuri të pranueshme për profetët, nisur edhe nga historitë e vërteta rreth vrasjes së profetëve. Si rrjedhojë u shkaktua një vonesë dhe dobësi në betejë. Për këtë Allahu i Madhërishtëm zbriti ajetin: *“Muhamedi nuk është tjetër veçse një Profet,*

para të cilit kanë ardhur profetë të tjerë”, që do të thotë se profetët e tjerë kanë shërbyer si shembull për të dhe kjo do të thotë se edhe vdekja mund t’i ndodhë atij.”

Më tej Allahu i Madhërishtëm thotë: *“Asnjë shpirti nuk i takon të vdesë vetëm se me lejen e Allahut, të shkruar në afatin e caktuar”*. (Ali Imran 145.)

Ibën Kethiri në Tefsirin e tij thotë: “Kjo do të thotë se çdo njeri do të vdesë vetëm me lejen e Allahut, derisa të konsumojë atë periudhë që Allahu i Madhërishtëm i ka lënë në dispozicion atij. Për këtë arsye Ai i Madhërishtëm thotë: *“...të shkruar në afatin e caktuar”*, apo: *“Askujt nuk i jepet jetë apo i pakësohet, që ajo të mos jetë e shkruar”*, apo: *“Ai ju krijoi juve prej balte, pastaj ju caktoi një afat dhe një afat është i përcaktuar tek Ai.”* Ky ajet i nxiti frikacakët dhe u jep atyre guxim për të hyrë në betejë, sepse lufta dhe beteja

“...” Ky ajet i nxit frikacakët dhe u jep atyre guxim për të hyrë në betejë, sepse lufta dhe beteja nuk ia pakësojnë askujt jetën dhe as nuk ia shtojnë atë...”

nuk ia pakësojnë askujt jetën dhe as nuk ia shtojnë atë.

Më tej Allahu i Madhërishtëm thotë: **“Kush e dëshiron shpërblimin e kësaj bote, Ne i japim atij prej saj dhe kush dëshiron shpërblimin e botës tjetër, edhe atij do t’ia japim atë, kurse mirënjohësit Ne do t’i shpërblejmë.”** (Ali Imran 145.)

Ibën Kethiri thotë: “Kjo do të thotë se ai që punon për dynjanë, e ka arritur atë që Allahu kishte caktuar për të dhe në botën tjetër nuk do të meritojë asgjë, ndërsa ai që ka synuar botën tjetër me veprat e tij, Allahu do t’ia japë atë që meriton, duke shtuar këtu edhe shpërblimin e tij në dynja, siç thotë në suren Shura, ajeti 20: **“Kush dëshiron fitimin e botës**

tjetër (ahiretin), **Ne do t’ia shtojmë fitimin e tij dhe kush dëshiron vetëm fitimin e kësaj bote, Ne do t’ia japim, po në botën tjetër ai nuk do të ketë pjesë.”**

Më tej Allahu i Madhërishtëm vazhdon duke i qetësuar besimtarët, pas ngushtimit të zemrës që u ndodhi në betejën e Uhudit: **“Sa e sa peygamberë ka pasur, që së bashku me ata kanë luftuan turma të mëdha besimtarësh dhe për atë që i goditi në rrugën e Allahut, ata nuk u dobësuan dhe nuk u përulën. Allahu i do durimtarët”** (Ali Imran; 146), që do të thotë: sa e sa profetë janë vrrarë dhe bashkë me ta janë vrrarë shumë besimtarë nga mesi i shokëve të tij.

Taberaniu thotë: “Ata janë njerëzit e virtyteve dhe të dijes, të cilëve nëse u vritej profeti i tyre, ata vazhdonin rrugën e tij, duke luftuar në rrugën e fesë së tij dhe duke vrrarë armiqtë e fesë së Allahut, ashtu siç vepronin kur ishin së bashku me profetin e tyre, pa u dobësuar dhe pa u përulur, ashtu siç nuk u dobësuan njerëzit e dijes dhe largpamës, që nëse vritej profeti i tyre, ata tregoheshin të duruar para armikut të tyre, derisa Allahu gjykoj mes të dy palëve.

Më tej Allahu i Madhërishtëm thotë: **“Fjala e tyre nuk ishte tjetër veçse: “Zoti ynë, na i fal**



mëkatet tona dhe lëshimet në punët tona, na forco këmbët tona (në luftë) ***dhe ndihmona kundër popullit jobesimtar!***" (Ali Imran; 147.)

Sheukani thotë: "Kur u vranë profetët e tyre, nuk u mbeti të thoshin tjetër veçse ***"Zot ynë, na i fal mëkatet tona"***, pra gjynahet e vogla dhe ***"lëshimet në punët tona"*** pra, gjynahet e mëdha. Duket se gjynahet përfshijnë gjithçka përmbledhet nën emrin e gjynahut, qoftë ky i madh apo i vogël, ndërsa teprimi apo lëshimi do të thotë tejkalim i kufirit. Ata i thanë këto fjalë pavarësisht se ishin besimtarë të mirë, për t'u treguar të thjeshtë me veten e tyre. Më tej Allahu i Madhërishëm thotë: ***"...na forco këmbët tona*** (në luftë)" pra, në pozicionet e betejës."

Taberiu thotë: "Kjo do të thotë: O Allah, na bëj prej atyre që qëndrojnë fort në luftën kundër armiqve të Tu dhe mos na bëj prej atyre që humbasin dhe largohen prej frikës dhe këmbët nuk u qëndrojnë në një vend gjatë betejës, si dhe "ndihmona kundër popullit jobesimtar" pra, kundër atyre që kanë mohuar se Ti je një i vetëm dhe profetësinë e të dërguarit Tënd."

Ebu Xhaferi thotë: "Kjo është një formë edukimi prej Allahut ndaj atyre që u larguan prej frikës së armikut në betejën e Uhudit dhe braktisën luftimin. Me një fjalë, përse nuk vepruat si shokët besimtarë të profetëve të mëparshëm, të cilët kur u thuhej, se profeti juaj është vranë, duronin dhe nuk përkuleshin? Edhe ju të duronit si ata ndaj armikut tuaj dhe t'i luteshit Zotit tuaj për fitore, ashtu siç iu lutën ata dhe Ai t'ju ndihmonte juve, ashtu siç i ndihmoi ata?"

Më tej Allahu i Madhërishëm thotë: ***"Ndaj Allahu ua dha atyre shpërblimin e kësaj bote dhe shpërblimin më të mirë të botës tjetër. Allahu i do punëmirët."*** (Ali Imran; 148)

Taberiu thotë: "Ebu Xhaferi është shprehur, se ata që Ai i përshkroi më parë ashtu siç i përshkroi, me durim në adhurimet e tyre karshi Allahut pas vrasjes së profetit të

tyre, me luftimin kundër armiqve të tyre, me kërkimin e ndihmës së Allahut në çështjet e tyre dhe me ndjekjen e rrugës së imamit të tyre në fatkeqësinë që u zbriti Allahu, Allahu u dha ***"shpërblimin e kësaj bote"*** pra, fitoren ndaj armikut të tyre dhe armikut të Allahut, triumfin, çlirimin dhe zotërimin e atyre vendeve. Gjithashtu Ai i Madhërishëm u dha atyre ***"shpërblimin më të mirë të botës tjetër"*** pra, shpërblimin e botës tjetër për veprat e mira që bënë në dynja dhe ky është Xheneti dhe kënaqësitë e tij."

El-Katani thotë në Tefsirin e tij: "Allahu ia lexon profetit të Tij këto ajete për të na mësuar neve me shembullin e popujve të mëparshëm, na edukon me sjelljen e besimtarëve karshi Zotit të tyre dhe na bën të kuptojmë, se nëse do të tregohemi të sinqertë, do të këmbëngulin në parimet tona dhe pastaj do të kërkojmë prej Tij ndihmën, Ai do të na përgjigjet dhe do të na ndihmojë me ndihmën, bujarinë dhe mirësinë e Tij."

El-Xhezairi thotë: "Punëmirët janë ata që janë të sinqertë në qëllimet e tyre dhe ia përkushtojnë vetëm Allahut veprat e tyre dhe janë ata që i kryejnë siç duhet detyrimet e veta, i kryejnë ato në përputhje të plotë me mënyrën, numrin dhe kohën që Ai u ka ligjëruar."

Allahu thotë: ***"O ju që keni besuar! Nëse u bindeni atyre që nuk kanë besuar, ata do t'ju kthejnë prapa aty ku ishit*** (në kufër) ***dhe atëherë do të jeni të humbur."*** (Ali Imran; 149).

Ibën Kethiri thotë: "Allahu i Madhërishëm i tërheq vëmendjen robërve të Tij besimtarë për bindjen ndaj jobesimtarëve dhe hipokritëve, sepse bindja ndaj tyre shkakton kthimin prapa në dynja dhe në botën tjetër. Pastaj i urdhëron ata që t'i binden Atij, të kërkojnë përkrahjen, ndihmën dhe mbështetjen e Tij, siç thotë në ajetin tjetër: ***"Vetëm Allahu është Mbështetësi juaj dhe Ai është Ndihmësi më i mirë."***

Taberiu thotë: “Ebu Xhaferi thotë: “O ju që keni besuar tek Allahu dhe i Dërguari i Tij, tek premtimi dhe kërcënimi i tij, tek urdhëresat dhe ndalesat e Tij, nëse i bindeni atyre që nuk kanë besuar, pra, atyre që mohojnë profetësinë e të Dërguarit tuaj, Muhamedit salAllahu alejhi ue selem, qofshin këta të krishterë apo çifutë, në lidhje me atë që ju urdhërojnë apo ju ndalojnë, që të pranoni dhe veproni pretendimin e tyre se ata gjoja po ju këshillojnë, atëherë ata do t’ju kthejnë prapa dhe do t’ju nxisin që të braktisni Islamin pasi keni besuar më parë, të mohoni Allahun, ajetet e Tij dhe të Dërguarin e Tij pasi të keni përqaftuar Islamin. Nëse ndodh kështu, **“atëherë do të jeni të humbur”** dhe do të ktheheni nga besimi dhe feja në të cilën ju udhëzoi Allahu.”

Ibën Sadiu thotë: “Allahu i ndalon këtu besimtarët që t’i binden mohuesve, hipokritëve dhe idhujtarëve, sepse nëse ndodh kjo, ata do t’u sjellin atyre vetëm të këqija dhe do t’i kthejnë ata drejt kufrit, i cili ka një fund të shëmtuar dhe është humbje. Më tej Allahu i Madhërishëm u bën atyre me dije se vetëm Ai është Ndihmëtari dhe Përkrahësi i tyre. Ai i përgëzon besimtarët, se do të marrë përsipër çështjet e tyre me butësinë e Tij dhe do t’i mbrojë ata nga çdo e keqe. Në këtë kontekst Ai i nxit besimtarët që ta bëjnë Allahun Ndihmësin dhe Përkrahësin e tyre të vetëm, ku në ndihmën dhe përkrahjen e Tij bën pjesë premtimi, se Ai do të hedhë frikë në zemrat e armiqve të tyre jobesimtarë, e cila i ndalon ata që të realizojnë shumë prej qëllimeve të tyre dhe kështu ka bërë në të vërtetë- i Lartësuar qoftë. Idhujtarët – pasi u larguan nga beteja e Uhudit- u këshilluan mes tyre dhe thanë: “Si të largohemi kur kemi vrarë shumë prej tyre, kur i kemi mundur dhe ende nuk i kemi zhdukur?!” Por Allahu hodhi frikën në zemra dhe u larguan të poshtëruar. Nuk ka dyshim se kjo është fitorja më e madhe, sepse u

përmend më parë që ndihma e Tij nuk del jashtë dy drejtimeve; ose do të vriten një pjesë e atyre që kanë mohuar, ose Allahu do t’i befasojë dhe ata do të kthehen të zhgënjyer. Kjo që përmendëm bën pjesë në të dytën.”

Ebu Hajani thotë: “Ligjërata i drejtohet luftëtarëve të Uhudit dhe të tjerëve përveç tyre. Jobesimtarët këmbëngulin vazhdimisht për t’i kthyer besimtarët nga feja e tyre **“Ata dëshirojnë sikur të mohonit, ashtu siç mohuan dhe kështu të jeni të njëjtë.”** Ata dëshirojnë që ju të jeni jobesimtarë dhe kjo nuk ju bën dobi: **“Shumë prej ithtarëve të librit dëshirojnë që t’ju kthejnë pas besimit tuaj në jobesimtarë”** dhe: **“Një grup prej ithtarëve të librit dëshironte që t’ju çonte në humbje.”**

Një mendim tjetër është se ligjërata është e veçantë për ata besimtarë, që ishin së bashku me të Dërguarin e Allahut salAllahu alejhi ue selem, në betejën e Uhudit.

El-Bukaiu thotë: “Allahu i Madhërishëm nuk i ka ndaluar ata (besimtarët) që të ruajnë lidhjet e tyre farefisnore me jobesimtarët dhe as që të kenë marrëdhënie me njëri-tjetrin në çështjet e dynjasë, siç është shitblerja, ndërsa në fe të duan njerëzit e fesë dhe nuk i dëmton sjellja e mirë me ata jobesimtarë që nuk i kanë luftuar.”

Allahu i Madhërishëm thotë: **“Vetëm Allahu është Mbështetësi juaj dhe Ai është Ndihmësi më i mirë.”** (Ali Imran; 150)

Ebu Hajani thotë: “Kjo do të thotë se jobesimtarët nuk janë përkrahësit tuaj, kështu që mos iu bindni atyre për asgjë, përkundrazi Allahu është Mbështetësi juaj, sepse **“Ai është Ndihmësi më i mirë”** dhe nuk ia keni nevojën dikujt tjetër që t’ju ndihmojë apo t’ju përkrahë. Ky është një argument, se kush lufton për të ndihmuar luftën e Allahut, nuk do të zhgënjehet dhe nuk do të mundet, sepse Allahu është Përkrahësi i tij. Allahu i Madhërishëm thotë: **“Nëse e ndihmoni**

Allahun, Ai do t'ju ndihmojë juve" dhe "Do të hedhim frikën në zemrat e atyre që mohuan" pra, në zemrat e këtyre jobesimtarëve, të cilët edhe nëse dolën fitimtarë në betejën e Uhudit, Ne do t'i zhgënjejme duke hedhur frikë në zemrat e tyre dhe kështu ndodhi në të vërtetë. Allahu i Madhërishtëm hodhi frikë në zemrat e tyre në ditën e betejës së Uhudit dhe ata humbën duke u larguar për në Mekë pa asnjë përpjekje nga ana e muslimanëve, pavarësisht se jobesimtarët në ato çaste gëzonin fuqi dhe forcë. Dikush është shprehur se: "Kur jobesimtarët u kthyen për në Mekë dhe kishin përshkruar një farë rruge thanë: "Ne nuk realizuam asgjë; vramë disa prej tyre, pastaj i lamë dhe u kthyem të humbur. (kjo ndodhi edhe tani në Gaza, O. B.) Kthehuni edhe një herë dhe zhdukini që të gjithë. Por kur u bënë gati për t'u kthyer, Allahu i Madhërishtëm u hodhi frikë në zemra dhe kështu mbetën nëpër vendet e tyre."

Ibn Kethiri thotë: "Allahu i përgëzon në vijim besimtarët se do të hedhë në zemrat e armiqve të tyre frikën dhe poshtërimin për shkak të kufrit dhe idhujtarisë së tyre, duke shtuar këtu edhe ndëshkimin që Ai ka përgatitur për ta në botën tjetër."

Ibën Kethiri vijon: "Përcillet në të dy Sahihët nga Xhabir b. Abdullahi, se i Dërguari i Allahut salAllahu alejhi ue selem, ka thënë: "Më janë dhënë pesë gjëra, që nuk i janë dhënë profetëve para meje: Jam ndihmuar me frikën (në zemrat e armikut) një muaj larg, toka më është kthyer në xhami dhe vend të pastër, më është lejuar plaçka e luftës, më është dhënë ndërmjetësimi, një profet dërgohej veçanërisht tek populli i tij, ndërsa unë jam dërguar për të gjithë njerëzit." ■

MUSLIMANËT, PËRÇMIMI DHE KRENARIA

I Dërguari, salallahu alejhi ue selem, thotë: "Nëse bëni tregti me kamatë, i pasoni bishtat e lopëve dhe e lini xhihadin (luftën) në rrugë të Allahut, Ai do t'iu përçmojë dhe s'ka për ta larguar atë përçmim nga ju, derisa të ktheheni në fenë tuaj."

SHKRUAN: LULZIM SUSURI

I Dërguari, salallahu alejhi ue selem, thotë: "Nëse bëni tregti me kamatë, i pasoni bishtat e lopëve dhe e lini xhihadin (luftën) në rrugë të Allahut, Ai do t'iu përçmojë dhe s'ka për ta larguar atë përçmim nga ju, derisa të ktheheni në fenë tuaj."

Hadithin e përçjell Abdullah b. Omeri, Allahu qoftë i kënaqur me të dy, dhe e shënon Imam Ahmedi në "Musnedin" e tij me nr. 5007, 5562 dhe Ebu Davudi në "Sunen" me nr. 3462. Ky hadith nga dijetarët e kësaj shkence konsiderohet i saktë.

Rëndësia e hadithit:

Shumë besimtarë, por edhe qafirë, disa të mërzitur dhe me pesimizëm e të tjerë të gëzuar dhe me qëllim sfide apo përçmimi na pyesin: "Përse muslimanët sot janë aq të dobët kudo në botë, pse ata në çdo aspekt janë

mbrapa të tjerëve, përse shumica e luftërave dhe e zullumit bëhet zakonisht në vendet ku jetojnë ata?” Këtë pyetje e pason pyetja tjetër shumë më e rëndësishme se e para, që është: “Si mund të dalin nga kriza që po e përjetojnë muslimanët” ?

Hadithi në fjalë na tregon për disa nga shkaqet kyçe (e nuk do të thotë që nuk ka edhe të tjera), të cilat janë shkak i këtij përcmimi mbarëbotëror i pasuesve të Muhamedit, salallahu alejhi ue selem.

Komentimi i hadithit:

Fjala e të Dërguarit, salallahu alejhi ue selem: “Nëse bëni tregti me kamatë”

I Dërguari i Zotit përmes kësaj fjale fillon të sqarojë një nga një shkaqet e përcmimit të muslimanëve, të parin ai përmend kamatën, e cila është një prej mëkateve më të mëdha dhe arsye për të shkaktuar hidhërimin e Zotit, bile vetë Allahu tregon në Kuran, se atij që punon me kamatë Ai i ka shpallur luftë derisa të mos pendohet dhe nuk largohet përfundimisht prej këtij

“...Hadithi na tregon se na mjafton të kthehemi në fenë tonë e çdo gjë pastaj rregullohet, përmes saj arrihet përgatitja e nevojshme si dhe fitorja e sigurt...”

harami.

Prandaj nuk është për t'u habitur pse bota Islame sot është në një gjendje të tillë, duke e ditur faktin se shumica e vendeve islame, si qeveri, popuj, shoqëri, pasanikë dhe firma aksionare, përveç një pjese të vogël të tyre janë të futur në një mëkat të tillë. Pra, si pritët për atë popull dita e fitores dhe e krenarisë, si mund t'i ngrënë duart e lutjeve kah qielli për ndihmë, kur barqet e tyre janë mbushur me ushqime dhe pije haram, rrobat i kanë të blera nga



harami dhe është i tëri i zhytur në haram?!)

Fillimi i këtij hadithi me përmendjen e kamatës nënkupton më shumë atë që mund të ndikojë në prishjen e njerëzve dhe të shteteve, pra, edhe në prishjen e muslimanëve dhe largimin e tyre nga feja dhe ajo është dhënia pas dynjasë, apo interesimi maksimal pas kushteve ekonomike. Mënyra më e mirë dhe më e shpejtë e njerëzve, që të arrijnë çdo dëshirë është të fitojnë para, e në anën tjetër mënyra më e lehtë sipas tyre për të arritur deri tek kjo pasuri është kamata, duke mos u interesuar aspak, se a është e lejuar kjo mënyrë përfitimi apo jo.

Fjala e të Dërguarit, salallahu alejhi ue selem: *“I pasoni bishtat e lopëve”*

Me fjalën *“Pasim i bishtave të lopëve”* ka si qëllim dhënien pas bujqësisë dhe blegtorisë, aq sa njeriu nuk mendon të merret me diçka tjetër. Por edhe pse në hadith është përmendur pasimi i kafshëve me të cilat punohet dhe mbillet toka, por nuk ka dyshim se me të ka si qëllim çdo mjet apo mënyrë përmes së cilës muslimanët e harrojnë Allahun dhe fenë e tyre dhe mendojnë, se ajo mënyrë është e duhura për të arritur kënaqësi dhe rehati apo ndoshta edhe krenari. Mendojnë se me dhënien pas puseve të naftës, pas ndërtimit të hoteleve luksoze, sallave të skive nëpër shkretëtira, ndreqja e ishujve në forma të ndryshme dhe sipas dëshirës, praktikimi i ligjeve dhe sistemeve komuniste, socialiste apo çfarëdo tjetër pos ligjit të Zotit, pra, me këto arrihet krenaria dhe rehatia, fitorja dhe autoriteti. Kjo gjë është vetëm ëndërr e porealizuar, një ëndërr e cila është mëkat jo vetëm që e bën të vrapojë njeriun pas realizimit të saj, por është mëkat edhe ta ëndërrojë, sepse është në kundërshtim me urdhrat e Allahut dhe me mënyrën e saktë dhe formulën e sigurt islame përmes së cilës arrihet fitorja.

Fjala e të Dërguarit, salallahu alejhi ue

selem: *“dhe e lini xhihadin (luftën) në rrugë të Allahut”*

Fjala xhihad nënkupton luftën, por edhe përpjekjen, pra, prej shkaqeve të këtij përçmimi është lënia e luftës e përpjekjeve apo e sakrificave dhe dhënia pas kënaqësive të dunjasë.

Umeti ynë përderisa nuk fillon së pari ta dojë luftën e pastaj edhe të merr pjesë në të, atëherë nuk do të ketë kurrfarë rezultati. Para se të flasim për luftën kundër armikut dua të theksoj disa çështje, që kurrsesi nuk duhen anashkaluar, e ato janë:

-Xhihadi më i rëndësishëm është ai që bën njeriu me veten e vet. Me xhihad të vetvetes kuptojmë sakrificën që besimtari duhet ta bëjë në vetvete, duke e mposhtur së pari të keqen në veten e vet, e keqe kjo që largohet duke e lodhur veten me mësimet fetare, pra duke marrë dituri, pastaj me atë dituri t'i luftojmë të gjitha dyshimet dhe epshet, të cilat mund t'i kemi në vetvete.

-Pas xhihadit të vetvetes apo pas luftimit të së keqes në vete dhe përmirësimit të saj, atëherë pason lloji i dytë i xhihadit, ai i armikut apo shfarosja e së keqes nga apo tek të tjerët.

-Ata që mundohen ta luftojnë armikun duke mos e plotësuar kushtin e parë, pra, luftimin dhe mundjen e vetes së tyre, ndoshta do të arrijnë të luftojnë, por nuk do të arrijnë të fitojnë, sepse nuk e kanë plotësuar kushtin paraprak. Këtë që thamë e vërteton më së miri edhe praktika e historisë islame e sidomos ajo e njëqind viteve të fundit.

-Thirrjet emergjente për xhihad nga disa persona është një thirrje, nëse nuk mund ta quajmë e gabuar do ta quanim të ngutshme. Kjo për arsye se umeti ynë në kohën që po jeton ka nevojë për thirrje dhe mësimet urgjente për çështjet e fesë e sidomos ato të akides-besimit, sepse si umet jemi zhytur në besëtytni, shirk, bidate dhe mëkate.

-Për këtë shkak zakonisht hoxhallarët, në këto kohë, kudo në botë thërrasin për xhihad të vetvetes e jo të armikut menjëherë, sepse si pasojë e saj mund të jetë mossuksesi.

-Çdo thirrje e muslimanëve për ndihmë, që i drejtohet shteteve apo organizatave botërore, sado e fuqishme të jetë ajo nuk do të ketë dobi dhe përmes thirrjeve nuk do të fitojnë betejat apo luftërat. Fshehtësia e fitores së tyre dhe formula e asaj fitore është kthimi në fe apo xhihadi me mënyrat e tij, të cilat i përmendëm më sipër.

Fjala e të Dërguarit, salallahu alejhi ue selem: *Ai do t'iu përçmojë dhe s'ka për ta larguar atë përçmim nga ju, derisa të ktheheni në fenë tuaj.*"

Hadithi, si pasojë të këtyre mëkateve përmend përçmimin e muslimanëve. Ky është turpi më i madh, pasojë e të cilit është humbja e vetëbesimit dhe humbja e luftës psikike. Njeriun mund ta vrasësh, t'i bësh padrejtësi, ta mundosh, mirëpo nëse ai është krenar, atëherë nuk i ke bërë asgjë. Muslimanët sot, si pasojë e mëkateve në të cilat janë zhytur, Allahu i ka sprovuar me të keqen më të madhe, që është përçmimi dhe përbuzja, nga të mallkuarit prej Zotit, vëllezërit e derrave dhe majmunëve dhe nga ata që kanë devijuar nga rruga e vërtetë.

Omeri, Allahu qoftë i kënaqur me të, në një fjalë të tij madhështore thotë: "Ne (myslimanët) jemi një popull që Allahu e krenoi me Islam e në momentin që krenarinë e kërkojmë me diçka tjetër pos tij Allahu do të na përçmojë". A thua sot myslimanët me çfarë janë duke e kërkuar krenarinë? S'ka dyshim se me çdo gjë tjetër përveç Islamit. E kërkojnë atë përmes parave, makinave apo shtëpive luksoze, përmes futbollit apo sporteve të tjera etj., por a thua arritën të jenë të parët dhe të bëhen krenarë me gjëra të tilla? Kurrë jo. Pse? Sepse e kërkojnë krenarinë në mënyrë

të gabuar, ku si pasojë Allahu i përçmon, qofshin nëpër lojëra të caktuara, gara të ndryshme, ligje që e sfidojnë shariatit, rregulla jetësore, pushtete, udhëheqje, etj.

Prandaj në bazë të asaj që na mëson feja jam më gjendje ta sfidoj çdo musliman, apo çdo shtet islam, bile edhe tërë umetin, se nuk mund ta arrijnë krenarinë me diçka tjetër pos fesë së tyre, e nëse ndodh të mendojnë se kanë arritur diçka nga ajo, atëherë le të presin ca kohë e do ta shohin fundin e vet.

Lind pyetja: **"Çfarë na mbetet neve të bëjmë"**? Ia lëmë të Dërguarit, salallahu alejhi ue selem, të na e tregojë me një fjalë më të shkurtër, por gjithë-përmbledhëse. Ai thotë: *"s'ka për ta larguar atë përçmim nga ju derisa të ktheheni në fenë tuaj"*.

Pra, mënyra e vetme për fitore është kthimi në fe, kthimi në mësimet e Kuranit dhe të Sunetit, të cilat janë e vetmja garanci për fitore. Në një transmetim që e shënon imam Ahmedi përmendet edhe: "Pendimi". Pra, të pendohemi dhe të kthehemi në fenë tonë, në mësimet e saj burimore. Është për t'u habitur, se i Dërguari, salallahu alejhi ue selem, në këtë hadith përmend vetëm kthimin në fe për të arritur fitoren dhe për ta kthyer krenarinë, që ne e meritojmë, duke mos e kushtëzuar atë më luftë. Hadithi na tregon se na mjafton të kthehemi në fenë tonë e çdo gjë pastaj rregullohet, përmes saj arrihet përgatitja e nevojshme si dhe fitorja e sigurt. Jam i bindur, se në shumicën e rasteve muslimanët nëse do të ktheheshin në fenë e vet për të fituar ndaj armiqve, nuk do të kishin nevojë të luftonin. E gjitha kjo sepse armiqët e Allahut frikësohen vetëm nga emri besimtar dhe vetëm nga ky pasim i fesë do të shpartallohen. Shpartallimi i tyre është i lehtë, sepse ata kurrë nuk janë të bashkuar, edhe pse thërrasin në një filozofi të tillë dhe nga ana e jashtme duken të bashkuar, por në realitet zemrat i kanë të

përçara.

Përfundim: Do të përmendja disa rezultate dhe disa dobi, të cilat në mënyrë të drejtëpërdrejtë apo tërthorazi i përfitojmë nga ky koment:

- Mëkatet janë shkak i përçmimit dhe i humbjes së betejave nga muslimanët. Mëkatet kryesore janë largimi nga feja, dashuria e kësaj bote dhe urrejtja e vdekjes.

-Allahu i ka shpallur luftë atyre që luftojnë evliatë (të dashurit) e Tij, mirëpo në anën tjetër i ka shpallur luftë edhe atyre që tregtinë e vet e përziejnë me kamatë, e këtë të fundit shumica e botës islame dhe e muslimanëve nuk e shohin si gjë të ndaluar, përkundrazi nuk e luftojnë atë, por prej saj edhe përfitojnë.

- Me gjithë sprovat dhe padrejtësitë nëpër të cilat është duke kaluar umeti i Islamit prapë kjo nuk po arrin që jomuslimanët t'i largojë nga interesimi për këtë fe, përkundrazi me gjithë shpifjet dhe intrigat të cilat qëndisen dhe gatuhën kundër Islamit shumë nga jomuslimanët e pranojnë Fenë Islame. Është e vërtetë se feja që luftohet më shumë sot në botë dhe në mënyrë të organizuar është Islami, por në të kundërtën është edhe feja që përhapet më shumë. Vallahi, betohem në Allahun, sikur ndonjë fe tjetër do të luftohej kaq shumë dhe do të shpifej ndaj saj, jo vetëm që nuk do të kishte të interesuar të konvertoheshin njerëz të rinj në të, por edhe ata besimtarë që kanë lindur në atë fe do ta tradhtonin duke shkuar tek më i forti. Por kjo nuk ndodh me fenë e Zotit, sepse nëse muslimanët janë të përçmuar, kjo kurrsesi nuk nënkupton se feja e tyre, e cila është feja e Zotit, edhe ajo të jetë e tillë.

- Islami ka dy veçori, të cilat vërtetojnë se ajo është fe e Allahut. Ato janë:

a: Sa më shumë që të luftohet feja dhe të shpifet ndaj saj, aq më shumë të tjerët e pranojnë.

b: Sa më shumë që luftohen muslimanët, aq më shumë këta të fundit kthehen tek feja e vet.

- Muslimanët në Gaza dhe kudo në botë, të cilët janë duke u torturuar nën thundrën e armikut nuk kanë nevojë për mjekimet tona, aq sa kanë nevojë si ata ashtu edhe ne për t'u kthyer nga feja, për thirrje në pendim dhe përmirësim të bindjeve, fjalëve dhe punëve. Dërgimi i ndihmave është vetëm një ndihmë momentale, e cila nuk u garanton aspak atyre e as neve fitoren ndaj armiqve. Ata që i vrasin muslimanët para ndihmave, mundet t'i vrasin edhe gjatë tyre dhe pas tyre, kurse kthimi i ynë në fe dhe i muslimanëve të persekutuar nënkupton një fitore të sigurt. Prandaj të drejtohem tek më e mira dhe më e sigurta për veten tonë dhe vëllezërit muslimanë e mos t'i mashtrojmë vetëm me disa mjekime qetësuese momentale, duke i lënë me plagë të hapura me dhjetëra vite.

- Lind pyetja çfarë duhet të bëj unë, për t'ia kthyer krenarinë, fitoren dhe nderin umetit islam?

Përgjigja është e thjeshtë: Mos akuzo askënd, duke ua hedhur fajin atyre, por vrapo ti vetë tek ndihma, e cila në këtë rast është kthimi yt në fenë e Zotit, praktikimi i saj dhe thirrja në të, e nëse secili prej nesh fillon nga vetja e vet, që të përmirësohet, duke mos ndenjtur duarkryq apo duke mos i kritikuar të tjerët, atëherë përgëzohu, merr myzhde, se vetëm atëherë mund ta presësh i gëzuar agimin e fitores, i cili ka perënduar para shumë vitesh.

Nga ky çast vëlla i dashur ndihmoje Palestinën dhe muslimanët e persekutuar kudo në botë, ndihmoje edhe veten duke u penduar dhe duke u kthyer tek Allahu. Umeti pret nga ti, mos rri duarkryq sepse e ke në duart e tua mundësinë për ndryshim. ■

PALESTINA

SHKRUAN: DRITON LEKAJ

Të dhëna gjeografike: Kur flasim për shtetin e Palestinës kemi si qëllim Palestinën si një tërësi territoriale, duke mos pasur parasysh pushtimin izraelit. Përndryshe palestinezët tashmë administrojnë vetëm 23 % të territorit të tyre dhe shteti i tyre ende nuk e ka parë dritën. Palestina kufizohet me detin Mesdhe dhe Egjiptin në perëndim, me Libanin në veri, me Sirinë dhe Jordaninë në Lindje dhe me Detin e Kuq në Jug. Palestina zotëron një pozitë tepër strategjike, e cila i mundëson asaj të jetë pikë takimi mes tri kontinenteve: Evropës, Azisë dhe Afrikës. Kjo e ka bërë këtë vend të synuar që nga kohët e lashta dhe ka përfituar kështu një rëndësi të veçantë.

Kronologji Historike¹

Këtë kronologji do ta fillojmë nga epoka Islame, meqë për epokën para-islame kemi folur në numrat e kaluar të AlbIslamit, gjegjësisht në rubrikën e historisë.

Palestina gjatë epokës islame.

13 h. – 634 g. Shënon fillimin e historisë së re dhe epokës islame për Shamin (krahinën që përfshin Palestinën në veçanti, si dhe shtetin e Libanit, Sirisë dhe Jordanisë). Në këtë vit në periudhën e Ebu Bekër Sidikut ushtritë morën urdhrin të drejtohen drejt Shamit. Aty u zhvillua beteja “Exhnadin”, e cila u zhvillua në jugperëndim të Kudsit

Të dhëna të përgjithshme:

Emri i plotë: Shteti i Palestinës
 Kryeqyteti: Kuds (Jerusalemi)
 Sipërfaqja: 22. 770 km
 Banorët deri më 2008: 4.148.000 banorë¹.
 Përqindja vjetore e rritjes së banorëve (2000 - 2005): 3.6 %
 Përqindja e myslimanëve: 85 %
 Gjuha: Arabe
 Monedha: Xhunejhu Palestinez, (si dhe monedhat egjiptase dhe Izraelite)
 Pavarësia: Ende vazhdon të jetë e okupuar nga Izraeli.
 Anëtar i Kombeve të Bashkuara: 1974 (statusin e vëzhguesit)
 Anëtar i Konferencës Islamike: 1969



(Jerusalemit), si dhe beteja e Jermukut, që shënon çlirimin e Damaskut dhe më pas të qyteteve të tjera të rëndësishme në Sham.

15 h. – 636 g. Shënon çlirimin e Kudsit me ushtrinë muslimane. Të Krishterët ia dorëzojnë çelësat e qytetit Halifes së muslimanëve Omerit radijAllahu anhu.

169 h. – 786 g. Këtë vit Harun Reshidi vendosi që t'i lejojë Perandorit romak t'i merremetojë kishat në Kuds. Gjithashtu ka marrë vendim, që të ruhen të gjithë vizitorët e krishterë, që vizitojnë vendet e shenjta të krishtere në Kuds. A njeh historia ndonjë çlirues më të madh se muslimanët?

480 h – 1088 g. Ky vit shënon fillimin e kryqëzatave ku Papa Urbani II shpall kryqëzatat për kthimin e Tokave të Shenjta, të Krishterëve.

¹Brenda territoreve të kontrolluara nga administrata palestineze, ndërsa për numrin e tyre jashtë këtyre territoreve sipas Qendrës Zyrtare Palestineze për Statistikë paramendohet të jetë rreth 10.000.000 mil.

² Marrë nga libri i Dr. Tarik Suvejdanit, “Palestina - Histori e dëshmuar me fotografi”. Si dhe te dhent e tjera në kete artikull janë marre nga: Wikipedia.com, Cnнарabic.com dhe Atlasi i shteteve Islame i Dr. Shevki Bu Halil.



492 h. – 1099 g. Ra Kuds në dorë të kryqtarëve. Aty ndodhi një kasaphane e madhe, duke mos bërë dallime mes njerëzve të thjeshtë dhe luftëtarëve.

583 h. – 1187 g. Ndodhi beteja e Hitinit, e cila shënon kthesë historike dhe ndryshoi peshoren mes forcave.

583 h. – 1187 g. Po në të njëjtin vit kanë hyrë muslimanët në Kuds nën udhëheqjen e Salahudin Ejubit pas 91 vitesh. U thirr ezani në xhaminë Aksa pas një shekull pushimi. Salahudini nuk e hapi Kuds në dhunë që të ruajë derdhjen e gjakut nga të dyja palët si dhe nuk i rrënoi e as nuk i shkatërroi kishat.

Epoka e Osmanllive dhe sundimi anglez.

943 h. – 1537 g. Ishte viti i përzgjedhjes halife të Sulejman Kanunit, i cili e rrethoi me mure të forta Kuds dhe meremtoi Kubetus-Sahre (Kubeja e Shkëmbit), dhe vazhdoi ndalesën e qëndrimit të Jehudive në Kuds.

1214 h. – 1799 g. Shënon datën kur

Napoleon Bonaparti vërsulet me ushtrinë e vet drejt Palestinës dhe pushton një territor të madh të saj, mirëpo në fund detyrohet të tërhiqet në Egjipt dhe nuk ia arrin qëllimit. Në këtë luftë ai u mbështet fuqimisht nga Jehudët.

1305 h. – 1888 g. Sulltan Abdulhamidi mori vendim të mos lejonte shpërnguljen e Jehudive në tokat e Perandorisë.

1315 h. – 1897 g. Jehuditë i propozuan Sulltan Abdulhamidit shuma të mëdha, me qëllim që t'i lejonte ata të shpërnguleshin në Palestinë e ai ua ktheu: **“Unë nuk mundem të lëshoj asnjë pëllëmbë të tokës së Palestinës, ngase nuk është prona ime, por pronë e popullit tim. Populli im ka luftuar gjatë për këtë tokë dhe e ka ujitur atë me gjakun e tij”.**

1335 h. – 1917 g. Britania u premton Jehudive se do të ndihmojë në themelimin e shtetit të tyre nëpërmjet Ministrisë të Punëve të Jashtme **Balfur** më 2/11/1917.

1346 h. – 1935 g. Filloi revolucioni i udhëhequr nga **Izudin Kassami**, i cili ishte përgatitur shumë mirë, por britanikët arritën ta shuajnë atë.

1945 Përfundon Lufta II Botërore me humbjen e gjermanëve dhe aleatëve të tyre dhe me këtë u shuan aspiratat e ushtrive arabe të atëhershme për luftimin e Jehudive në Palestinë.

29.11.1947 – Kombet e Bashkuara nxorën vendimin e saj numër **“181”** për ndarjen e Palestinës në dy shtete. Harta e ndarjes u rregullua në atë mënyrë që Jehudive iu dha 54% e tokës, ndërsa Palestinezëve 46%, edhe pse Palestinezët përbënin 68% të banorëve dhe kishin nën zotërim më tepër se 93,5% të tokës së Palestinës.

Palestina nën Okupimin Izraelit.

9.4.1948 – Ndodhi masakra e Dir Jasinit nga grupi **Hagana**, të cilin e udhëhiqte **Begini** (më pas kryeministër i Izraelit), ku u vranë tërë banorët e fshatit. Kjo shkaktoi një

shpërngulje të madhe të palestinezëve për shkak të tmerrit dhe egërsisë së përdorur në këtë masakër.

15.5.1948 – Parlamenti nacional i Jehudive shpalli vendimin për themelimin e shtetit çifut sovran në Palestinë d.m.th., në ditën e dytë të tërheqjes së prituri britanike.

15.5.1948 – Ushtritë arabe filluan luftën kundër Jehudive, por më 17/5 pas dy ditësh luftimi, për shkak të presionit nga Këshilli i Sigurimit e ndalën luftën duke filluar bisedimet.

9.7.1948 – Fillon lufta përsëri, por Jehuditë ishin më të organizuar dhe e shfrytëzuan këtë kohë për të shtuar arsenalin e tyre luftarak, prandaj filloi një luftë e rreptë rezultat i së cilës ishte tërheqja e ushtrive arabe.

15.7.1948 – Këshilli i Sigurimit vendosi armëpushim të përhershëm dhe këtë e pranuan shtetet arabe pasi shpallën se i kanë ndërprerë operacionet ushtarake e kësaj ndodhi **“katastrofa”** dhe kjo quhet shitja e Palestinës. Jehuditë e shtrinë pushtetin e tyre në mbi 78% të Palestinës, kurse vendimi i OKB-së iu jepte atyre vetëm 54%.

1950, është viti kur Bregu Perëndimor iu bashkëngjiti Jordanisë, ndërsa Egjipti shpalli se e fuste nën administrimin e saj Rripin e Gazës.

1956, ishte viti kur Abdu Naseri vendosi të fuste nën administrimin shtetëror Kanalin e Suezit. Ky hap e nxiti luftën kundër Egjiptit nga ana e Britanisë së Madhe, Francës dhe Izraelit. Kështu Izraeli fillon luftën dhe me një lehtësi të madhe arriti të merrte Gazën, shkretëtirën e Sinait dhe Kanalin e Suezit. Më **6.3.1957** nën presionin e SHBA-ve dhe shteteve të tjera këto tri shtete u tërhoqën nga Sinai dhe Gaza.

1962, Shënon vitin ku **lëvizja Fatah** bashkohet nën një udhëheqje të vetme nën drejtimin e **Jaser Arafatit**.

28.5.1964 – Shënon vitin kur të gjithë organizatat palestineze bashkohen në një

organizatë të vetme, që do t'i përfaqësonte interesat palestineze dhe u emërtua si: **OÇP** (Organizata për Çlirimin e Palestinës).

5.6.1967 – Filloi lufta mes shteteve të “Rrethimit” e që janë: Egjipti, Libani, Siria dhe Jordania e që më vonë u quajt “Katastrofa e madhe”. Kjo luftë u quajt edhe lufta e gjashtë ditëve. Kjo luftë pati rezultate të tmerrshme për çështjen palestineze dhe shtetet që morën pjesë në të. Izraeli pas kësaj lufte doli të kishte okupuar edhe pjesën që kishte mbetur prej Palestinës d.m.th. 23%, si dhe e pushtoi Sinain dhe Lartësitë Golan, që përbën lartësi të mëdha e që konsiderohen shumë të rrezikshme në rrafshin strategjik për Izraelin. Po ashtu Izraeli hyri në Kuds dhe ndërmori një hap të guximshëm më 27/6 kur e bashkoi Kudsin përëndimor me atë lindor dhe e shpalli si kryeqytet të saj.

21.8.1969 – Disa jehudi ekstremistë e dogjën xhaminë Aksa dhe kjo u bë shkak i thirrjes së një kongresi arabo-islam dhe prej vendimeve më të rëndësishme të tij ishte formimi i **Organizatës së Konferencës Islamike**.

1970, Në këtë vit shteti i Jordanisë, për shkak të operacioneve ushtarake të lëvizjeve palestineze në një anë dhe kërcënimeve izraelite ndaj tij vendosi të ndalë praninë ushtarake palestineze, kështu që ndodhën ngjarjet e **“Shtatorit të Zi”**, ku pati përleshje mes forcave jordaneze dhe atyre palestineze. Rezultat i kësaj ishin më se 3000 viktima, shkatërrimi i kampeve palestineze e sidomos kampeve të flijuesve.

6.10.1973 – Egjipti dhe Siria u morën vesh për fillimin e luftës, kështu që lufta filloi më 10 Ramazan dhe u quajt lufta e 10 Ramazanit apo **lufta e tetorit**.

17.10.1973 – Arabët vendosën ta përdorin armën e naftës, kështu që vendosën ta ulin prodhimin e naftës, si dhe ta ndalin atë për shtetet që përkrahin Izraelin. Ai që e inicioi këtë vendim ishte mbreti Fejsal i Arabisë

Saudite.

14.1.1976 – Me këtë datë filluan të sulmohen kampet palestineze në Liban, sidomos nga forcat krishtere.

1.9.1978–Sadati, presidenti i Egjiptit nënshkroi me **Menahim Beginin** në SHBA marrëveshjen e njohur të **Kamp Dejvidit**. Sipas kësaj marrëveshjeje Izraeli hyn në paqe me Egjiptin dhe Egjiptit i kthehet Sinai. Shtetet arabe e kundërshtuan këtë vendim të Egjiptit.

1982, Shënon vitin kur OÇP dhe lëvizja Fatah filluan të kthehen dhe të pranojnë zgjidhjet paqësore për çështjen palestineze.

6.6.1982 – Izraeli e sulmon Libanin, me qëllim që t'i ndalë sulmet palestineze prej aty, si dhe largimin e OÇP-së. Pas kësaj lufte, e cila ishte shumë e ashpër dhe dëmtoi rëndë Libanin dhe sidomos palestinezët në të, Jaser Arafati më 25/7 shpalli se i pranonte vendimet e KS të OKB-së dhe se ishte i gatshëm t'i fillonte bisedimet.

16.9.1982 – Ndodhi masakra e Sabras dhe Shatilas, dy kampeve palestinezeve në Liban, ku viktimat sipas disa statistikave arrijnë deri në 3.500 njerëz të pafajshëm. Autor i kësaj masakre ishte **Ariel Sharon**, më vonë kryeministër i Izraelit.

1985 – 1988, ishin vitet kur lëvizja shiite **“Emel”** i rrethoi kampet palestineze

El Intifada (kryengritja, revolta) dhe Paqja.

9.12.1987 – Shënon fillimin e Intifadas. Arma e vetme, e cila u përdor përballë dhunës dhe terrorit të Izraelit ishin gurët. Palestinezët lanë mbrapa dyzet vitet e përçmimit e të qetësisë dhe filluan rezistencën. Kjo rezistencë filloi të marrë përmasa të ndryshme dhe u rrit një brez i tërë i edukuar me frymën e rezistencës. Gjithashtu vlen të përmendet se Intifada shënon themelimin e Lëvizjes Islame Hamas.

31.7.1988 – OÇP fillon bisedimet me Izraelin, por për fillimin e bisedimeve Izraeli kushtëzoi ndarjen e Bregut Perëndimor nga

Jordania. Shteti i Jordanisë e pranoi kërkesën e OÇP-së dhe kështu filluan bisedimet.

9.12.1992 – Hamasi me këtë datë themeloi krahun e tij luftarak dhe e emërton si **“Çetat e Izudin Kasamit”**. Me këtë Hamasi fillon operacionet ushtarake kundër Izraelit dhe ndërton legjendën e operacioneve vetëflijuese.

13.9.1993 – U nënshkrua marrëveshja e Oslos, sipas së cilës OÇP e pranon Izraelin përballë një autonomie mbi Bregun Perëndimor dhe Gazën që i jepet OÇP-së. Lëvizjet e tjera palestineze e kundërshtuan këtë marrëveshje.

28.9.2000 – Shënon datën kur Sharoni-udhëheqësi i partisë **“Likud”** hyn në xhaminë Aksa nën mbrojtjen e 3.000 ushtarëve. Muslimanët e konsideruan këtë si një ofendim të rëndë të xhamisë së shenjtë, prandaj u ngritën në demonstrata të mëdha.

27.3.2002 – U mbajt kongresi i shteteve arabe në Bejrut me mungesën e pranisë të gjysmës së shteteve arabe, megjithatë në këtë takim u vendos për iniciativën arabe për paqe me të cilin doli mbreti Abdullah i Arabisë Saudite dhe kjo initiative më vonë u njoh si **“Iniciativa Arabe për Paqe”**.

5.1.2004 – Pas kësaj, Izraeli fillon ndërtimin e murit ndarës mes tokave palestineze dhe kolonive izraelite. Asambleja e Përgjithshme e OKB-së kërkoi nga Izraeli ta rrëronte, megjithatë ky vendim nuk u zbatua kurrë. Ky mur arrin gjatësinë prej 720 km. dhe merr nga vetja tokat më pjellore të Palestinës.

2006, zhvillohen zgjedhjet parlamentare. Në këto zgjedhje parlamentare mori pjesë lëvizja islame Hamas, e cila i fitoi ato bindshëm, duke i mundësuar asaj themelimin e qeverisë nën udhëheqjen e **Ismail Henijes**.

2008, shënon fillimin e ofensivës izraelite të quajtur **“Plumbat vërshues”**, e cila kishte si qëllim shuarjen e administrimit të Hamasit në Rripin e Gazës, gjë që nuk u arrit me gjithë arsenalin dhe egërsinë e sulmeve çifute.

GAZA REALITETI I HIDHUR



SHKRUAN: DRITON LEKAJ

Rripi i Gazës është një shirit i ngushtë toke. Përkufizohet në veri dhe lindje me Izraelin, në jug me Egjiptin ndërsa Deti Mesdhe e përkufizon atë nga perëndimi. Gjatësia e tij arrin deri në 45 km., ndërsa gjerësia ndryshon nga 6 deri në 10 km. Rripi i Gazës konsiderohet si një prej vendeve më të dendura me banorë, aty banojnë rreth 1.5 milion banorë në një hapësirë prej 365 km².

Rripi i Gazës është formuar sipas marrëveshjes së armëpushimit mes ushtrive arabe dhe asaj izraelite në vitin 1949 dhe është emërtuar sipas qytetit më të madh në të. Që prej asaj kohe Rripi i Gazës iu nënshtrua udhëheqjes egjiptiane derisa e okupuan atë forcat izraelite në vitin 1967. Që nga viti 2006

Rripi i Gazës iu nënshtrua një izolimi total rajonal dhe ndërkombëtar pas fitores së Hamasit në zgjedhjet parlamentare dhe themelimit të qeverisë prej tyre. Krahas izolimit ajo iu nënshtrua edhe një embargoje ngulfatëse, pasi Hamasi e kishte nënshtruar tërësisht Gazën. Kjo embargo merr kuptimin e vet më tepër, kur na bëhet e ditur se Izraeli edhe pas tërheqjes nga Rripi i Gazës është përgjegjës për furnizimin e banorëve të Gazës me ujë të pijshëm, rrymë dhe derivate. Banorët e Gazës kanë vuajtur shumë për shkak të mungesës së këtyre nevojave themelore, për shkak se Izraeli e ka kufizuar futjen e tyre përgjatë këtyre dy viteve të fundit. Në vijim do të përmendim disa të dhëna rreth dëmeve të shkaktuara nga sulmi i fundit i Izraelit.

Kohëzgjatja e sulmit	22 ditë
Numri i të vrarëve	1.315 (nuk është final)
Numri i të plagosurve	5.400
Të plagosurit rëndë	400
Invalidët mes të plagosurve	10 %
Të vrarët nga Hamasi	48
Refugjatët	80.000 - 90.000
Të humburit	115
Shtëpi të shkatërruara	22.000
Dëmi në infrastrukturë	1.9 miliardë dollarë

FETVA, KËSHILLA DHE UDHËZIME RRETH BIDATIT

PËRGATITI: ALI SHABANI

Pyetje 1: Çfarë do të thotë bidat dhe si e trajton sheriati bidatin?

Përgjigje: Fjala apo nocioni bidat në domethënien etimologjike do të thotë shpikje apo risi.

Në terminologjinë e shariatit bidat do të thotë metodë e shpikur në fe, që nuk është e njëjtë me sheriatin, nëpërmjet të cilit synojmë afrimin tek Allahu.

Sheriati Islam e ka gjykuar rreptë bidatin dhe i thërret besimtarët të pasojnë rrugën e drejtë, gjegjësisht Sunetin e Pejgamberit salallAllahu alejhi ue selem. Allahu i Madhëruar ka thënë: *“... le të ruhen ata që kundërshtojnë rrugën e tij (të të dërguarit), se ata do t'i zërë ndonjë telash, ose do t'i godasë dënim i hidhët.”* Nur 63

Pejgamberi, salallAllahu alejhi ue selem, ka thënë: *“Kush shpikë nj vepër që nuk është pjesë e fesë sonë, ajo është e refuzuar.”* d.m.th. e pa pranuar. (Buhariu dhe Muslimi.)

Pyetje 2: Cilat vepra llogariten bidat?

Përgjigje: Çdo vepër me të cilën synohet afrim tek Allahu, e cila nuk ka mbështetje në bazat e shariatit, llogaritet si bidat. Feja është përfunduar në kohën e Pejgamberit salallAllahu alejhi ue selem, kur ka zbritur ajeti 3 në suren Maide: *“...Sot përsosa për ju fenë tuaj, plotësova ndaj jush dhuntinë Time,*

zgjedha për ju Islamin fe...”. Pejgamberi salallAllahu alejhi ue selem nuk ka lënë gjë pa treguar në lidhje me Fenë, për këtë shkak nuk ka nevojë që dikush të thotë nga mendja e vet se kështu e kështu duhet të bëhet në fe, por i mjafton atij që ta mësojë Kuranin dhe hadithin e Pejgamberit salallAllahu alejhi ue selem e t'i zbatojë ato në jetën e vet, se Allahu nuk ka harruar gjë, sepse Ai nuk harron: *“... Zoti im nuk gabon e as nuk harron”*. Ta-Ha 52

Abdullah b. Mesudi ka thënë: *Ajo që ka qenë fe në kohën e Pejgamberit salallAllahu alejhi ue selem është edhe sot fe, e ajo që nuk ka qenë fe në kohën e Pejgamberit salallAllahu alejhi ue selem edhe sot nuk është fe.*

Pyetje 3: A ka bidat të mirë?

Përgjigje: Bidatet, risitë që kanë të bëjnë me fenë, të gjitha janë dalalet, devijim. Pejgamberi salallAllahu alejhi ue selem ka thënë: Çdo bidat është devijim dhe çdo devijim është në zjarr. Abdullah b. Omeri ka thënë: Çdo bidat është delalet (devijim), edhe nëse e shohin njerëzit si të mirë.

Pyetje 4: Cilat janë shkaqet që e bëjnë personin të bjeri në bidate?

Përgjigje: Shkaqet që e bëjnë personin të bjeri në bidat mund të jenë të shumta dhe të ndryshme. Ato mund t'i përmbledhim në disa pika me të cilat mund të bëhen krahasime. Prej atyre shkaqeve veçojmë:

1 - Xhehli - padituria. Padituria është

Në këtë rubrikë mirëpresim të gjitha pyetjet e juaja, ndërsa ato më interesante do të botohen.
Pyetjet mund t'i dërgoni në revista@albislam.com

armiku më i madh i njeriut. Kur njeriu nuk e njih Sunetin e Mustafasë salallAllahu alejhi ue selem, nuk i njih parimet e fesë dhe as metodologjinë e të parëve tanë të mirë, bie shumë lehtë në bidat.

2 – Të konsideruarit e disa figurave fetare të paditur për prijës. Këta persona kanë veshur petkun e dijetarëve, por janë xhahila, japin fetva, merren me arsim në institute fetare dhe japin për fe thënie të tëra sipas epsheve dhe hamendjeve të tyre, pa u mbështetur në dituri dhe argumente të vërteta. Kështu ata shpikin në fe gjëra që nuk janë nga feja, gjegjësisht bidate ndërsa njerëzit i pasojnë. Pejgamberi salallAllahu alejhi ue selem ka thënë: *“Do të dalin në umetin tim njerëz që llastohen me epshet e tyre, ashtu si llastohet qeni pas të zotit të vet. Nuk i mbetet nga venat (damarët) dhe as nyje pa iu futur në te”*. (Sahih Tergib 49) Po ashtu Pejgamberi, salallahu alejhi ue selem, ka

thënë: *“Allahu nuk e merr diturinë me rrëmbim duke e rrëmbyer nga robërit e vet, por e rrëmben diturinë duke marrë dijetarët derisa të mos mbetet asnjë dijetar, e pastaj njerëzit fillojnë t'i konsiderojnë dijetarë të paditurit. I pyesin dhe japin fetva pa dituri dhe kështu devijojnë vetë, por edhe të tjerët i largojnë nga rruga e drejtë”* (Buhariu).

3 – Teklidi i verbër. Teklid i verbër d.m.th., imitimi i të tjerëve pa kërkuar argument. Kjo nuk lejohet meqë, askush nuk është i pagabueshëm. Atë imunitet e ka pasur vetëm Pejgamberi salallAllahu alejhi ue selem. Pra, ata prijës-imamë dikur kanë rënë në gabim dhe të tjerët i kanë pasuar, po më e keqja është se edhe sot, kur e vërteta është bërë e qartë dhe janë verifikuar e dokumentuar burimet e sheriatit, ata vazhdojnë t'i pasojnë imamët e tyre në gabimet që kanë rënë ata më parë, gjë të cilën as imamët e tyre nuk janë në pajtim me të.



4 – Adetet dhe besëtytnitë

5 – Interesi pas dynjasë. Interesi pas dynjasë ndahet:

- a) për ruajtjen e pozitës
- b) frika nga risku

Pyetje 5: Hoxhë i nderuar, në një polemikë me një besimtar u konfrontuam në çështjen për pasimin e imamit. Ai pretendon se duhet pasuar imami edhe në namaz varësisht atij medhhebi që i takon dhe siç falet ai duhet pasur krejtësisht. A është kjo thënie me vend, apo jo; na tregoni dhe ju faleminderit paraprakisht.

Përgjigje: Në emër të Allahut, paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi pejgamberin tonë. Format e namazeve që demonstrojnë imamët e medhhebeve përkatëse, në përgjithësi pa dyshim janë në rregull, edhe pse kanë disa dallime mes njëra-tjetrës. Megjithatë pa marrë parasysh se në bazë të cilit medhhebi falet imami, nuk është e kushtëzuar që me të njëjtën formë të falet edhe muktediu (xhemati). Muktediut i kushtëzohet, që të mos e parakalojë imamin në ndërrimin e tekbireve, gjegjësisht kur shkon në ruku, kur kthehet prej rukusë, e kështu me radhë. E gjitha kjo pasi Pejgamberi salallAllahu alejhi ue selem ka thënë: *“A nuk frikësohet ai që parakalon imamin me ruku, apo sexhde, që Allahu t’ia bëjë fytyrën si të gomarit, apo t’ia bëjë fizionominë si të gomarit.”*

E sa i përket pasimit të imamit, Pejgamberi është falur para sahabëve dhe u ka thënë: *“Faluni ashtu siç më shihni mua duke u falur.”* Ky hadith është për të gjithë muslimanët dhe Pejgamberi salallAllahu alejhi ue selem është imami i të gjithë imamëve dhe xhemateve muslimane.

Pyetje6: Të shprehurit e nijetit: a është bidat?

Përgjigje: Të shprehurit e nijetit në disa ibadete është bidat e në disa jo. Në ato ibadete, nëse bëhet ashtu siç e ka përmendur

Pejgamberi salallAllahu alejhi ue selem, atëherë është në rregull, si për shembull thënia e besmeles në fillim të abdesit. I Dërguari i Allahut ka thënë: *“Merrni abdest duke thënë bismilah”*. Kur fillonte haxhillëkun thoshte: *Lebbejke Allahumme haxhen* (Të përgjigjem o Allah, duke bërë haxhin). Mirëpo sa i përket namazit, Pejgamberi salallAllahu alejhi ue selem nuk ka shprehur asgjë tjetër kur ka hyrë në namaz përveç *“Allahu ekber”*, për këtë shkak nijetet e shpikura, që i kanë shpikur të mëvonshmit, në lidhje me namazin, nuk kanë bazë në Sheriatin Islam. Dijetarët që kanë bërë vërejtje në këtë çështje kanë thënë, se nëse dikush pretendon se duhet të thuhet nijeti për hyrjen në namaz, apo të thotë se është mustehab, këtë gjë nuk e ka bërë e as nuk e ka porositur Pejgamberi salallAllahu alejhi ue selem. Kjo është njësoj sikur të ketë thënë për Pejgamberin salallAllahu alejhi ue selem, se ai paska harruar ta thotë këtë gjë – Allahu na ruajt.

Këshillë

Duke u nisur nga hadithi, se feja është këshillë, e këshilloj veten dhe besimtarët muslimanë, se në sprovat që po përjetojmë në jetën e përditshme, ato janë një rutinë e në jetën e përditshme besimtari duhet të bëjë sabër dhe të përqendrohet në këtë fe. Njeriu sprovohet me sprova të ngjyrave të ndryshme, me ndërrimin e fesë, me gra, me pasuri, me bidate etj. Pejgamberi salallAllahu alejhi ue selem ka thënë: *“Pas jush do të vijojnë ditë të sabrit (ditë të vështira), ku njeriu ka nevojë për sabër. Për atë që i përmbahet fesë do të ketë shpërblim sa për pesëdhjetë prej jush. Të pranishmit i thanë: O Pejgamber i Allahut, a pesëdhjetë prej tyre? Ai tha: Jo, por prej jush.”* (Ibën Nasër në “Sunne” dhe Shejh Albani e ka vlerësuar shih). ■

TRIMAT LEGJENDARË DHE MASHTRIMI I UMETIT

Përpjekjet për t'i përgatitur fjalimet e “udhëheqësit të shkëlqyer”, pastaj lëshimi i tyre në veshët e masës i morën shumë kohë umetit, shumë pasuri për të reklamuar, madje edhe më shumë se sa pasuria që u harxhua për armë për një ditë, e cila do të përsëritet shpesh në jetën e arabëve përderisa çifutët të mbajnë Palestinën të okupuar.

MERVAN KUXHUK

Mashtrimi i umetit nuk është ndonjë gjë e re pavarësisht se në kohët moderne shfaqet në mënyra nga më dhelparaket. Hilja dhe mashtrimi i njerëzve, madje edhe i atyre që u jepën attribute të mendjemprehtësisë, kulturës së lartë, aftësisë për të kuptuar dhe për të njohur realitetin. Gjithashtu nuk është diçka e re sidomos kur bëhet fjalë për gjoja ndihmesën që i ofrohet umetit nga ndonjë i përshkruar si gjeni, edhe pse në fakt ai shkakton një përçarje dhe plagë të rëndë në shtatin e umetit.

MASHTRIMI I ATATURKUT:

Njëri prej atyre që u paraqitën si heronj, shpëtimtarë dhe luftëtarë të ashpër të armikut ishte **Mustafa Kemal Ataturku**. Këto attribute që iu dhanë e ndihmuan atë të rrenojë hilafetin islam. Pas këtij mashtrimi u ngjiten edhe ata që nuk priteshin më së paku të bien në këtë grackë, gjersa edhe kryepoeti **Ahmed Sheuki** u mashtrua nga kjo lojë dhe thuri vargjet:

*Allahu Ekber sa çudira ndodhin gjatë
çlirimeve*

*O Halid i turqve ripërtërije Halidin e
arabëve.*

Koha ka vërtetuar se ajo që bëri Ataturku,

kursesi nuk ishte çlirim, porse mbyllje e dyerve të krenarisë. Turqia për shkak tij, për shkak të trimit legjendar e tradhtar u kthye në një grimcë të parëndësishme, e cila rrotullohej nën hijen e armiqtve të saj, kurse popujt e tjerë të umetit u lanë si qengji në kujdesin e ujkut. Më pas erdhën thikat, të cilat e prenë trupin e umetit, ashtu siç deshën shpëtimtarët e rremë nga loja e të cilëve u mashtruan edhe disa intelektualë.

TRAGJEDI E JO MOSSUKSES:

Mashtrim është dështimi fatal i arabëve, që ndodhi në qershor të vitit 1967 e që u quajt mossukses. Dallimi është shumë i madh mes dështimit fatal dhe mossuksesit. **Bathistët** e Sirisë atëbotë pretenduan, se nuk ka dështim por fitore vetëm për një arsye, sepse partia Bathiste mbeti gjallë, për të ngulfatur popullin e saj, edhe pse kodrat e **Xheulanit** me rëndësi tejet strategjike nëpërmjet forcave ndërkombëtare ranë në duart e çifutëve. Ky vend kaq i rëndësishëm vazhdon të jetë i okupuar. Nga ana tjetër, kur pritej nga Siria të përgatitet për çlirimin e Xheulanit, ata nxituan të marrin pjesë në çlirimin e Kuvajtit nga okupatori irakian nën udhëheqjen amerikane.

A PAT FITORE NË LUFTËN E TETORIT?

Në Tetor të vitit 1973 filloi një luftë e re mes arabëve dhe çifutëve me iniciativën e

Egjiptit dhe Sirisë. Shumë njerëz akoma krenohen me këtë luftë, edhe pse çifutët si rezultat i kësaj lufte arritën në Suez duke kapërcyer **Sinain**, gjithashtu Siria humbi edhe disa fshatra të tjera. Prej fryteve të kësaj lufte ishte marrëveshja e **Kemp Dejvidit** me Sadatin, e cila ndryshoi shumë politika ndërkombëtare, kurse arabët i zhyti në baltën e përçarjes dhe luftërave donkishotiane mes udhëheqësve të tyre. Qytetari arab u shndërrua në një papagall, i cili përsërit fjalët dhe kënaqet me muzikalitetin e tyre kundër armikut çifut, mirëpo pa kuptuar dhe pa perceptuar thellësinë e tyre. Masa e gjerë nuk fitoi gjë tjetër prej pushtetarëve të saj, në veçanti prej revolucionarëve, veçse disa mënyra të kërcënimit dhe të talljes, kurse e ushtri vetveten me gënjeshtër të përsosura përballë pushtetarëve, me qëllim që ta shpëtojë vetveten nga torturat e tyre, si dhe për t'u mbrojtur nga raportet e spiunëve të vet.

Pas vitit 1967 na dolën në shesh pushtetarët shakaxhinj me përkufizime të reja për humbjet duke na thënë se ato në fakt janë fitore e jo humbje. Armiqësia trepalëshe kundër Egjiptit dhe qëndresa e qytetit Burseid përballë çifutëve, kjo e fundit po na paraqitet si fitorja e një udhëheqësi të frymëzuar. Tregime të ndryshme u thurën për heroizmat e banorëve të qytetit që qarkullojnë kudo në tokat arabe! Është e vërtetë se banorët e Burseidit patën trima dhe ngjarje heroike që meritojnë të studiohen dhe t'u shërbehen fëmijëve për t'i lexuar dhe për të marrë mësim, mirëpo ushtria egjiptiane u thye për shkak të udhëheqjes, e cila di vetëm të luftojë me fjalë dhe të udhëheqë një politikë të ulët, mirëpo jo edhe të ndalë armiqtë. E gjitha kjo ishte e natyrshme përballë armiqtësisë trepalëshe, dy prej tyre botërore: Britania dhe Franca, plus toka e arabëve e vjedhur nga çifutët ose shteti i Izraelit.

Megjithatë parullat tingëlluese, që i paraprinë armiqtësisë e të cilat u lëshuan nga udhëheqja naseriane, atëkohë futi qetësinë, madje edhe mendjemadhësinë jo vetëm në zemrën e çdo egjiptiani, por në zemrën e çdo arabi dhe muslimani. Realiteti ishte ndryshe. Ishte një fatkeqësi për të mençurit ajo që po i ndodhte umetit, i cili punët i peshoi me qëllime dhe me parakushte para se t'i peshojë me rezultate dhe përfundime. Mendjelehtit mbetën edhe më tej lëndë për të lozur me ndjenjat e tyre dhe bindja e tyre se heroizmat e banorëve të Burseidit janë të padiskutueshme dhe udhëheqja e shkëlqyer vazhdoi të jetë në pushtet, sepse ajo u dha arabëve një fitore të pritur kah moti nga forca më e madhe e Lindjes së Mesme, siç quhej atëbotë Egjipti.

Përpjekjet për t'i përgatitur fjalimet e "udhëheqësit të shkëlqyer", pastaj lëshimi i tyre në veshët e masës i morën shumë kohë umetit, shumë pasuri për të reklamuar, madje edhe më shumë se sa pasuria që u harxhua për armë për një ditë, e cila do të përsëritet shpesh në jetën e arabëve përdërisa çifutët të mbajnë Palestinën të okupuar.

Mes luftës së vitit 1982 dhe asaj të 2006 -ës kundër Libanit ka shumë ngjashmëri. Të dyja kanë pasur heroizma që nuk mohohen, mirëpo që të dyja nuk korrën fitore në kuptimin e drejtë të fjalës, edhe pse e pretendojnë një gjë të tillë:

*Çdonjëri pretendon se ka lidhje me Lejlën
Mirëpo Lejla nuk ua pranon një gjë të tillë*

GADAFI NË MAJË TË SKENËS:

Kur Gadafi u paraqit në skenë pasi kishte bërë thirrjen për revolucionin çlirimtar kundër mbretit të fundit të Libisë Idris Senus. Ai erdhi në fuqi me një grusht shteti ushtarak në shtator të vitit 1969, duke mbyllur bazën ajrore amerikane në Libi dhe duke treguar nuancë të animimit nga Islami dhe arabizmi. Kjo

“...Me vonë gjithçka doli në shesh se “i Çmenduri i Libisë” ishte një budalla, i cili notonte me shkathtësi revolucionare sipas bekimit amerikan...”

bëri që shumë të rinj arabë, ndërmjet tyre edhe shkruesi i këtyre rreshtave, të varnin shpresa të mëdha për këtë udhëheqës të ri, i cili erdhi i panjohur. Ishte e veçantë përkrahja e Xhemal Abdunaserit, i cili i tha Gadafit: “Tek ty shoh rininë time”, fjalë me të cilën ai ndezi fitilin e vetëmashtimit dhe të mendjemadhësisë, sa që i lavdëruari në fjalë e mendoi veten të aftë në fushën e mendimit dhe të besimit, prandaj shkroi një libër, të cilin ai e titulloi “Libri i Gjelbër”. Pas vdekjes së Abdunaserit ai filloi të flasë sikur të ishte udhëheqësi i të gjithë arabëve. Më vonë shkoi dhe i ngatërroi brirët me Sadatin. Ky i fundit e emërtoi “I çmenduri i Libisë”. Kur iu shtua Sadatit mërzia nga “i Çmenduri i Libisë”, ai vendosi ta likuiojë atë me çdo mënyrë. Mirëpo Sadati nuk ishte nga ata njerëz, që bënte ndonjë punë pa u këshilluar me Amerikën. Ai u tregoi për nijetin e tij, që të çlirohet nga fqinji i çmendur, mirëpo nuk iu dha leje për një gjë të tillë, por iu tha: “Gadafi është element stabilizues në Lindjen e Mesme”, kurse në fuqinë e Sadatit dhe shumicës së sadatëve të tjerë, nuk kishte gjë tjetër veç të dëgjojnë fjalët dhe të pasojnë më të këqijat e tyre.

Me vonë gjithçka doli në shesh se “i Çmenduri i Libisë” ishte një budalla, i cili notonte me shkathtësi revolucionare sipas bekimit amerikan.

LEGJENDA E SADAMIT DHE E BATHIZMIT:

Më pas erdhi Sadam Husejni, si gjahtar i titullit “trimi legjendar” kjo edhe nëpërmjet

disa raketave, që ua drejtoi sionistëve, raketa këto me të cilat e pat sulmuar më parë edhe Riadin e Saudisë. Publiku që ishte plotësisht i gatshëm për t’u mashtruar i dha një duartrokitje të fortë, duke u zhytur me admirim në simfoninë e bombardimit qesharak drejtuar çifutëve, si edhe në bombardimin tejet serioz kundër Saudisë. Në atë kohë Sadami ishte i zhytur në “idealin” e **Bathizmit Socialist Arab**, duke harruar vargjet e Mukanna Kindiut, të cilat i recitonin shpesh nga nacionalistët arabë:

Zënkat mes meje dhe fëmijëve të babait tim

Si dhe ato mes meje dhe djemve të xhaxhait tim, janë të ndryshme

Nëse ma hanë mishin, unë së paku ua lë mishin e trupave të tyre

Nëse shkelin lavdinë time, unë ndërtoj një lavdi për ta

Mllefën e vjetër që kam pas ndaj tyre e kam harruar

Nuk është fisnik ai që gjithmonë e mban mllefën

Mirëpo ne nuk kemi në dorë asgjë më tepër veçse të themi për të (Sadamin): Allahu e mëshiroftë dhe ia faltë gabimet, sepse para se të likuiohet nga neosafevitët fjalën e fundit që tha në këtë botë ishte: “Dëshmoj se nuk ka zot që meriton të adhurohet përveç Allahut dhe se Muhamedi është rob dhe i Dërguar i Tij”

LEGJENDA E HEZBOLLAHUT:

Më në fund vjen Hasen Nasrullahi, prodhim i vitit 2006 për të përvetësuar namin e trimit legjendar madje edhe në botën e Ehli Sunetit. Ky person nuk e fsheh lidhjen e tij ideologjike dhe organizative me “Pushtetin e Fekihut-velajeti fakih”, e cila me të drejtë i paraqet neosafevitët. Disa njerëz të thjeshtë nuk shohin problem në këtë gjë. Disa prej tyre që e quajnë veten si intelektualë, madje edhe akademikë Hasen Nasrullahun e quajnë “Salahudin”. Naiviteti i disa të tjerëve shkon

edhe më larg, saqë e quajtnë “halife i muslimanëve” për shkak të pluhurit që ai shkaktoi në betejën e tij e që nuk ishte e qartë për shumë njerëz atëbotë dhe që nëpërmjet medieive ndezi fitilin e fitnes dhe ju mundësoi sionistëve të shfaqin artet e dhunës së tyre.

Arsyeja pse rrëmbyen dy ushtarë sionistë sipas Hasen Nasrallahut ishte se shteti izraelit kishte vendosur për të sulmuar Libanin në Tetor të vitit 2006. Kjo do të thotë se Hezbollahu gjoja e parandaloi këtë sulm. Mirëpo më parë ai kishte deklaruar se qëllimi i rrëmbimit kishte qenë ndërrimi i të rrëmbyerve me tre libanezë robër të sionistëve. Parashtrohet pyetja: për cilin prej këtyre dy shkaqeve u nis lufta? Ngjarjet nuk e vërtetojnë ndonjërin prej tyre, sepse për shkak të shkathtësisë së Hasenit dhe ushtrisë safevite numri i libanezëve të robëruar arriti në 13. Tani pyetja për Hasenin është: a do t'i përfshijë lirimimin e të gjithë robërve në bisedime apo nevoja kërkon që të rrëmbehen akoma çifutë të tjerë?

Hezbollahu para kësaj aventure refuzonte që ushtria libaneze të hyjë në pjesën jugore të vendit. Ushtria libaneze hyri më vonë së bashku me forcat ndërkombëtare dhe kështu siguruan kufirin për t'iu dhënë çifutëve më tepër siguri. Nga ana tjetër Hasen Nasrullahu nën zë pranoi, se sikur ta dinte që puna do të shkonte deri këtu nuk do të hynte në këtë aventura. Pas një farë kohe, pasi e kishte harruar këtë deklaratë, aventurën e tij e quajti “fitore hyjnore” dhe “premtim i sinqertë”.

Më vonë u lirua libanezi i robëruar Semir Kintari pas një marrëveshjeje mes çifutëve dhe Hezbollahut nëpërmjet gjermanëve. Në këtë marrëveshje nuk u përmend pala çifute, kurse armët mbetën edhe më tej në dorë të Hezbollahut.

Atë që bota e pa me 7/5/2008 në Bejrut kur Hasen Nasrullahu urdhëroi shkatërrimin e lagjeve sunite në Bejrut na shtyn që të pyesim: a thua vallë ngjarjet e 7/5/2008 janë

shpërblim i “fitores hyjnore”?

Tërë ajo që fitoi Hasen Nasrullahu ishte reklamimi nëpër media dhe asgjë tjetër. Kur zhurma shuhet, njerëzit qetësohen dhe kur fillojnë llogaritjet për atë se çfarë është fituar dhe ç'është humbur, të vërtetat dhe gënjeshttrat, atëherë fillon vetëdijesimi. Një fjalë e urtë thotë: një i marrë hedh gurin në lumë, kurse një mijë të mençur nuk e nxjerrin dot. Kështu edhe fitnet, i fillojnë njerëzit e këqij dhe mendjelehtë, kurse pas tyre qëndrojnë forcat keqdashëse. Dikush fjalët i fthillon mirë, por në fakt është munafik. Munafiku nuk e ka problem të thotë një fjalë të vërtetë dhe të ketë si qëllim një të kotë, për këtë gjë aludon fjala e Allahut: **“Ka ndonjë nga njerëzit që fjala e tij të mahnit, por vetëm në këtë botë (meqë në botën tjetër gjykon Ai që i di të fshehtat), dhe për atë që ka në zemrën e tij, e paraqet Allahun dëshmues, e në realitet ai është kundërshtari më i rreptë. E posa të kthehet ai në tokë, vazhdon të bëjë shkatërrim në të, të asgjësojë të korrat (mbjelljet) dhe gjallesat. E Allahu nuk e do çrregullimin (fesadin). Dhe kur i thuhet atij: “Ki frikë Allahun”, atë e kap euforia për punë mëkati. Shtrat i shëmtuar është ai që i takon atij (xhehenemit).”** (Bekare: 204-206).

Si përfundim: Muslimanët që janë umeti i senedit (zinxhiri i njerëzve që transmetojnë një thënie) dhe i shkencës së vlerësimit të njerëzve (Ilmu-rrixhal), që e vlerëson çdonjërin ashtu siç është, e njëjta gjë vlen edhe për thashethemet që fliten aty këtu, njerëzit patjetër duhet të kthehen në burimet dhe themelet e tyre, të mos i cilësojmë të sipërpërmendurit dhe të tjerët si ata: si trima legjendarë, kur ata në fakt mohojnë të vërtetën dhe i vrasin ithtarët e së vërtetës, kurse ne u dhurojmë duartrokkitje. ■

Përktheu: Agim BEKIRI